



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SHA KURBIN

RAPORT PËRFUNDIMTAR
I AUDITIMIT MBI PËRPUTHSHMËRINË
EKONOMIKO-FINANCIARE
NË
UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA KURBIN

TETOR 2021

Përmbajtja	faqe
Kontrolli i Lartë i Shtetit	1
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	14
HYRJA	17
1. Objekti i auditimit	17
2. Qëllimi i auditimit	17
3. Identifikimi i çështjes.....	17
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim	17
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	18
6. Kriteret e vlerësimit	18
7. Standardet e auditimit	18
8. Metodatat e auditimit	19
9. Dokumentimi i auditimit.....	19
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	20
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.....	20
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	20
1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. 20	
2. Mbi hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij.	23
3. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.....	39
4. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.....	49
5. Mbatja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitet e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit).	57
6. Evidentimi, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të realizuara nga shitja e ujit dhe nga shërbimet e tjera.	66
7. Mbi Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;.....	75
8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	105
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	112

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 20.05.2021 deri me datë 16.07.2021 kreu auditimin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Ujësjetës Kanalizime Kurbin SHA për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2018 deri më 30.04.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, Këshillit të Administrimit; planifikimin, hartimin dhe realizimin e planit vjetor financiar dhe të biznesit të UKK dhe njësisë përbërëse, si dhe raportimi i tyre; zbatimin e strukturës organizative; auditimin me zgjedhje të shpenzimeve; zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit të kontratave; mbajtjen e evidencës kontabël; zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe auditit të brendshëm; administrimin e pronës; etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit dhe të mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të UKK për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 30.04.2021, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të pamodifikuar të përputhshmërisë, për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të këtij subjekti.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi u konstatua se për sa i përket financimit nga buxheti i shtetit, nga ana e UK Kurbin për periudhën nën auditim nuk rezultoi të jenë përcjellë pranë institucioneve eprore projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime periodike me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (kryesisht për investime). -Drejtorja e Thesarit pranë MFE ka raportuar	24 në 40	E lartë	Organet Drejtuese të UK Kurbin, duke përfshirë Administratorin, Këshillin e Administrimit, Asamblenë e Përgjithshme, etj të ngrënë grupe punë për analizimin e detyrimeve të prapambetura; përcjelljen e një informacioni real të vlerës së tyre me qëllim

	pagesa për detyrime të prapambetura nga UK Kurbin në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara otë paguara gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr.50, datë 05.02.2014 óPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitó, në një kohë ku nga ana e shoqërisë <u>nuk rezultojnë të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE</u>; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UK Kurbin paraqiten në vlerën 0. Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, dhe raportit vjetor për stokun e detyrimeve të prapambetura të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, UK Kurbin në vitin 2019 rezultojnë ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën 13,986,204 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësllës Kurbin ato rezultojnë në vlerën 435,508,393lekë ; dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësllës Kurbin në vlerë 612,388,769lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat sikundër vërehet paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë K.A, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese.			raportimin real të tyre në raportin vjetor të hartuar nga MSHMS për stokun e detyrimeve të prapambetura, dhe hartimin e një plani veprimi dhe shlyerjeje për reduktimin e tyre.
2	Bazuar në Ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Administratori i UK Kurbin ka lidhur Kontratë Pune me nr. 513, datë 03.10.2019, me znj. Sh.G., në pozicionin Mjeke e Përgjithshme. Për këtë emërim nuk ka pasur as procedurë rekrutimi dhe as miratim të Këshillit Administrativ për përcaktimin e nivelit të pagës.	40 ñ 50	E lartë	Administratori i UK Kurbin të marrë masa për propozimin për miratim pranë Këshillit Administrativ të nevojës së punësimit të mjekut të ndërmarrjes dhe përcaktimin e nivelit të pagës dhe në vijim të ndjekë të gjitha hapat e duhura për njoftimin dhe rekrutimin për këtë pozicion.
3	Nga auditimi konstatohet që në listë-pagesat dhe listë-prezencat e UK Kurbin për periudhën objekt auditimi merret gjithmonë si referencë 21 ditë pune në muaj dhe jo 22 ditë. Ky veprim nuk ka efekt financiar gjatë përlogaritjes së pagës mujore me përjashtim kur pagesa për një punonjës nuk bëhet për ditët e plota të muajit (p.sh. punonjësi merr	40 ñ 50	E lartë	Spektori i financës të marrë masa që në përlogaritjen e pagave në rastet e mos pagesës së plotë mujore, të zbatojë përcaktimet ligjore për numrin mesatar të ditëve të punës prej 22 ditë. Ky përcaktim të zbatohet

	raport mjekësor, fillon punë në një ditë të caktuar të muajit, etj.) dhe si pasojë përpjesëtimi i ditëve të punës nuk bëhet i saktë.			edhe nga personat përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e listë-prezencave pranë sektorit të financës.
4	Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm për punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UK Kurbin, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë.	40 ñ 50	E lartë	Sektori i financës të marrë masa për përfshirjen e vjetërsisë për secilin punonjës në përlogaritjen e pagave.
5	Për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 objekt auditimi janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029.	40 ñ 50	E lartë	UK Kurbin të marrë masa për kryerjen me prioritet të pagesave nga transaksione që gjenerojnë gjoba për shkak të vonesave, si dhe të planifikojë saktë në buxhete apo nevoja për subvencione vlerat sa i takon këtyre transaksioneve.
6	Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka patur 6 procese gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënive të punës me punonjësit. Nga këto procese gjyqësore janë gjeneruar detyrime në vlerën 1.601.527 lekë nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor.	40 ñ 50	E lartë	UK Kurbin të marrë masa që largimet nga puna të jenë konform Kodit të punës dhe Kontratës dy palëshe të punës dhe të mos shkelet asnjë e drejtë e punonjësit për asnjë rast. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që Vendimet e Gjykatës të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.
7	Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit për periudhën objekt auditimi për punonjës të cilët janë larguar pa shkaqe të përligjura, duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur UKK në Gjykatë. Nga paditë e punonjësve kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë duke e detyruar UKK të paguajë shumën 5,292,924 lekë, për të cilat nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar edhe detyrimet përmbarimore. Për veprime të tilla Uj-sjell-s Kanalizime SHA Kurbin ka dëmshtëpërblyer për periudhën objekt auditimi, konkretisht: 9 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2018 në shumën 2,990,097 lekë;	50 ñ 59	E lartë	Nga shoqëria të merren masa që në vazhdimësi, për marrëdhëniet me punonjësit e shoqërisë të zbatohen kushtet e vendosura në kontratat individuale dhe kolektive, largimet të jenë për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara, duke zbatuar afatet kohore përkatëse të njoftimit, gjithashtu të merren në konsideratë shmangia e shpenzimeve për detyrimet përmbarimore.

	7 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2019 në shumën 2,027,527 lekë, 4 punonjës dhe zyrat përmbarimore për vitin 2020 në shumën 225,300 lekë; 4 punonjës dhe zyrat përmbarimore deri në 01.04.2021 në shumën 50,000 lekë			
8	Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për karburantin e automjeteve të Ujësjiellës Kanalizime Kurbin SH.A, rezultoi se ka në përdorim 4 automjete nga të cilat 1 automjet tip Mercedes Benz 2.0TDI me targa TR 53.9 J është në pronësi të shitësit të automjetit Ferdinand Ilir Hoxhallari prej datës 12.11.2014 dhe nuk janë bërë ndryshimet e pronësisë përkatëse. Për 4 automjetet në përdorim nga UKK sha nga Drejtoria Tregtare dhe Dega Teknike nuk janë mbajtur kartelat përkatëse për secilin automjet, ku të jenë të evidentuara qartësisht të dhënat teknike të mjeteve, shpenzimet e kryera periodike për mirëmbajtjen e tyre dhe kolaudimet, kilometrazhi sipas muajve dhe viteve mbi të cilin të bëhen dhe llogaritjet e orëve të punëve, sasitë e furnizimit me karburant si dhe programet e respektive të punës dhe itineraret përkatëse të përshkruara nga secili mjet. Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti UKK SHA rezultoi se nga Drejtoria Tregtare, Zyra e Financës dhe Dega Teknike nuk ka evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të çdo të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për zërin e karburantit. Nga dokumentacioni i daljeve të karburantit nga magazina e Shoqërisë rezultoi se: Për vitin 2018 janë përdorur 15,206 litra naftë me vlerë 2,587,257 lekë; Për vitin 2019 janë përdorur 16,063 litra naftë me vlerë 2,663,264 lekë; Për vitin 2020 janë përdorur 16,270 litra naftë me vlerë 2,116,947 lekë; për të cilat për grupin e auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion argumentues dhe justifikues si Urdhrin e Administratorit për miratimin e programeve të punës, Programet individuale të punës në të cilat të përshkruhet itinerari i lëvizjeve të automjetit, motivacioni i lëvizjes. Mungonin të dhënat e kilometrazhit në fillim dhe në fund të aktivitetit, normativa e konsumit të automjeteve dhe konsumi specifik sipas itinerarit shoqëruar me nënshkrimet përkatëse	50 ñ 59	E lartë	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtori tregtar të merren masat që të rregullohet me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit, që në vijimësi të hartohen kartelat përkatëse të secilit automjet, të caktohen personat / komisioni përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve për automjetet, të kryhen kontrollet përkatëse periodike për monitorimin e shpenzimeve për karburantin, kontrollin teknik, riparimin e automjeteve dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës në vazhdimësi. Gjithashtu Administratori i UKK z. A. P. të ngrejë komision për verifikimin e sasive reale të karburantit të shpenzuara nga sasia prej 47,539 litra, ekuivalente me vlerën 7,367,468 lekë për periudhën 2018-2020, shoqëruar me dokumentacion të plotë justifikues sipas legjislacionit cituar më sipër, për të cilin ofrohet bindje e arsyeshme mbi procedurën e rregullt të konsumit të tij

	të shoferit. Nga ana e administrimit të shoqërisë (Administratori, Drejtoria Tregtare) si dhe nga inxhinieri i Drejtorisë Teknike, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë. Këto veprime vlerësuar në konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues në sasinë e 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë janë veprime që kanë sjellë dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.			
9	Nga auditimi rezulton se të gjitha ngjarjet dhe veprimet ekonomike, regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj.	59 ñ 69	E lartë	Në mënyrë që të ruhet dhe garantohet siguria e informacioneve të saj, UK Kurbin të marrë masa për përdorimin e programeve financiare në mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabël.
10	Për të tre vitet objekt auditimi, nuk janë pasqyruar saktë vlerat sa i takon klientëve debitorë nga furnizimi me ujë dhe të ardhurat e arkëtuara si vijon: <u>Për vitin 2018</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 135.351.480 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjô paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. <u>Për vitin 2019</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 142.247.887 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjô paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të	59 ñ 69	E lartë	Sektori i financës të marrë masa që në të ardhmen të rakordojë dhe pasqyrojë me vërtetësi dhe saktësi vlerat sipas të dhënave të gjeneruara nga sektorët dhe regjistrimet përkatëse.

	ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. <u>Për vitin 2020</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 149.428.475 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etj) paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 192.779.329 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 40.445.970 lekë.			
11	Për vitin 2018, në zërin óToka dhe ndërtesa) në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi Shoqëria nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, Shoqëria ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuarët, nga të cilat në ZVRPP përkatëse kanë rezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UK Kurbin, por deri në momentin e auditimit nuk është finalizuar ende ky proces.	59 ñ 69	E lartë	Administratori dhe Këshilli i Administrimit të shoqërisë të marrin masa për nxitjen e përsheptimit të procesit të regjistrimit të pronave të UK Kurbin. Për këtë qëllim të kërkohet edhe angazhimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë, Bashkisë Kurbin.
12	Nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk është kryer asnjëherë analizë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me llogaritë debitore-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. Shoqëria nuk ka marrë masa as për analizimin dhe veçimin e vlerave të debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe zgjidhjen e kësaj situatë. Në fund të vitit 2019, shoqëria nuk ka marrë masa për likuidimin e një pjese të detyrimeve edhe pse ka patur gjendje monetare në vlerën 7.277.546 lekë.	59 ñ 69	E lartë	Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë të merret në analizë në mënyrë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitore dhe kreditore, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kriterëve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarrim për arkëtim të detyrueshëm.
	Për vitin 2020 Administratori nuk ka marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe kryerjen e këtij procesi për aktivet e shoqërisë.	59 ñ 69		Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit për çdo vit për të gjitha aktivet që ka dispozicion duke krijuar komisionet përkatës për kryerjen e këtij procesi.

	Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësjetllës Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori. Këshilli Mbikëqyrës, pasi e miraton këtë rregullore, me kërkesën e administratorit të shoqërisë, ia dërgon atë për miratim në emër të Këshillit Mbikëqyrës dhe vetë administratorit, Asamblesë së Aksionareve të UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonës së shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë.	69 në 78		Nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për secilën periudhë përkatëse në funksion të ushtrimit të detyrës, të hartohet/miratohet Rregullorja e Ujit, në zbatim të Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" të ndryshuar, dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 óPër miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës-kanalizimeve SHA.".
	Në óUjësjetllës Kanalizime Kurbinô SHA raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë. Kjo pasi pusët e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujti, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret seriozisht në konsideratë. Si e tillë, Shoqëria ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERR. për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen. Bilanci i Ujit sipas modelit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IËA) në sistemet e furnizimit me ujë përfaqëson një metodikë për të vlerësuar sasinë e ujit që hyn dhe si konsumohet brenda sistemit, përkatësisht në pjesën që i faturohet konsumatorëve dhe në humbjet administrative dhe reale të tyre. Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e	69 në 78		Të vendosi matës në çdo vendburim nga furnizohet me ujë UKK.

	kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Bilanci i Ujit përshkruan dhe analizon gjendjen aktuale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjikë dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Kjo është dhe arsyeja kryesore që kërkesat e UK për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve duhet të shoqërohet detyrimisht me paraqitjen e një Plani Biznesi 5 Vjeçar. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj). Bazuar në të dhënat mbi treguesin e prodhimit dhe faturim-arkëtimit, në total sipas viteve, humbjet në rrjetin transmetues dhe shpërndarës zënë në total mbi 60 % për qind, për vitin 2018 zënë 65%%, për vitin 2019 zënë 59%, për vitin 2020 zënë 54% dhe për periudhën 01.04.2021 zënë 53% treguesit.			
	Nga ana e òUKKò SHA, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer kontrolle sistematike për konstatimet dhe prerjen e lidhjet e paligjshme, gjithashtu nuk është marrë asnjë masë për konstatimin e përdorimit nga ana e subjekteve private të puseve të prodhimit të ujit me/pa leje. Kjo ka sjellë mos funksionim të grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbini pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri.	69 në 78		Nga ana e òUKKò SHA, të kryhen në mënyrë të vazhdueshme inspektime për identifikimin e lidhjeve të paligjshme dhe të zbatohet kuadri ligjor për subjekte/konsumatorët që shfrytëzojnë puse për ujë.
	Efiçenca e Stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK. Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UKK ka arritur në numrin 120 punonjës dhe 7127 lidhje, kjo sipas raportime të E.RR. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 16.8 staf/1000 lidhje UK. Ky tregues është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës dhe qëndron ende larg objektivit të performancës së mirë të kërkuar nga ERR. . Duke qenë se numri i lidhjeve UK gjatë vitit 2020 është rritur në 7,127, numrit i	69 në 78		Të zvogëlohet numri i punonjësve në strukturën e UKK, duke menaxhuar më mirë burimet njerëzore, shfrytëzuar rritjen e eficiencës në punë dhe rritjen e performancës së shoqërisë. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Asamblesë, anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë.

	stafit nuk ka ndikuar në përmirësimin e këtij indikator. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, i cili në disa raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm disa shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë, UK Elbasan etj., i plotësojnë kushtet që efienca e stafit të jetë në nivelet e një performace të mirë. Duke parë karakterin mjaft kompleks dhe relativ të këtij treguesi, kërkohet një analizë me e thelluar e tij sepse jo të gjitha shoqëritë e mësipërme mund të konsiderohen të suksesshme në realizimin e këtij treguesi. ERR. në aplikimet e shoqërive për tarifa analizon në mënyrë të detajuar këtë tregues, i cili lidhet direkt me kostot e punës, duke konsideruar vetëm kostot e justifikuara për përballimin përmes tarifës.			
	Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar. Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. <i>Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”.</i> -Zhvillimi i procedurës. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE óS...L. & G..M.ô SHPK, me vlerë kontrate 365,697,488 lekë, ose 436,431,509 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 101/13,	78 në 109		Autoriteti Kontraktor, UKK, në përcaktimin e kriterëve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të marrë masa për vendosjen e tyre në përputhje me llojin e saj si dhe në respektimin të referencave ligjore në fuqi me qëllim rritjen e konkurrencës dhe mos diskriminimin e Operatorëve Ekonomik të fushës. Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, UKK, të nxjerrë përgjegjësitë për procedurën konkrete ku vlera e kontraktuar prej 363,692,924lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet,

	date 23.06.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues BOE óS...L. & G...M.ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE óS...L. & G...M.ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 <i>óShqyrtimi i ofertave</i>” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 <i>óPër prokurimin publikó</i>, i ndryshuar ku citohet <i>óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”.			<i>eficencë dhe efektivitet (3-E^{te}).</i>
	-Zhvillimi i procedurës. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óE.ô SHPK me vlerë kontrate 3,437,895 lekë pa tvsh ose 4,125,474 lekë me tvsh , si dhe lidhur kontrata me nr. 158/14, date 03.07.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óE....ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike e kualifikuar, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óE....ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 <i>óShqyrtimi i ofertaveó</i> të ligjit 9643, datë 20.11.2006 <i>óPër prokurimin publikó</i>, i ndryshuar ku citohet <i>óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit</i>”.	78 ñ 109		Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.
	-Zhvillimi i procedurës. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óE...Gô SHPK me vlerë kontrate 1,019,625 lekë pa tvsh ose 1,223,550 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 322/14, date	78 ñ 109		Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik

	14.12.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE ôE...ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja e kualifikuar), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ôE...ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ôShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ôPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet ôAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.			pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, UKK, të nxjerrë përgjegjësitë për procedurën konkrete ku vlera e kontraktuar prej 1,019,625lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{të}).
	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE ôE....ô SHPK me vlerë kontrate 3,491,020 lekë pa tvsh ose 4,189,224 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 321/14, date 20.11.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE ôE...ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE ôE....ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 ôShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 ôPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet ôAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.	78 ñ 109		Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

KONKLuzioni I PëRGJITHSHËM

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare të Ujësjetllës Kanalizime Kurbin SHA në tërësi për periudhën nga data 01.01.2018 deri 30.04.2021, si dhe të pasqyrave financiare të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga institucioni nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e MFK për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësimit të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontroleve të brendshme, mosplotësimit dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, mbajtjes së regjistrimit manual të transaksioneve në ditarë, raporteve të pa plota të audituesit të brendshëm, procedurave të pa implementuara për delegimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe mungesës së objektivave e planeve të punës për arritjen e tyre.

UK Kurbin në vitin 2019 rezultoi ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, në vlerën 13,986,204 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjetllës Kurbin ato rezultojnë në vlerën 435,508,393 lekë; dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjetllës Kurbin në vlerë 612,388,769 lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë K.A, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese.

Për vitin 2018-2020 nuk është kryer procesi i identifikimit dhe inventarizimit të aktiveve që shoqëria ka në dispozicion.

OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të UKK, për vitin ushtrimor 2018-2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje¹:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të pamodifikuar për llogaritë vjetore të subjektit, UKK duke arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Theksimi i çështjeve:

¹*Opinion i pamodifikuar* Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje me gabimet materiale, por jo thelbësore të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuar në raportimin e pasqyrave financiare. Konkretisht:

- Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet në vlerën 7,367,468 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e keqmenaxhimit në mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit;

- Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet në vlerën **1,601,527 lekë** nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor;

- Përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet në vlerën **1,352,928 lekë** si gjoba ngapagesat dhe deklaratimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë;

- Për 4 prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në keqpërdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën **420,941,416 lekë**, si rezultat i shpalljes fitues të BOE/OE të cilët nuk kanë plotësuar pjesërisht kriteret për kualifikim.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga UKK, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Nga auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla etj, u evidentuan raste si ai i shpenzimeve të karburantit, për të cilët grupi i auditimit është i pasigurt mbi materialitetin, pra nivelin real të konsumimit për realizimin e detyrave funksionale, por jo thelbësore për trajtimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të UKK:

Strukturat drejtuese të UKK, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të UKK janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme , nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI,

audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kritereve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 539/1, datë 20.05.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 20.05.2021 deri me datë 30.06.2021, në subjektin "Ujësjetës Kanalizime" SHA Kurbin, për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 30.04.2021, u krye auditimi mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare me përbërje:

1. R. XH. , Përgjegjës Grupi
2. A. Z. , Auditues
3. M. B. , Audituese
4. R. K. , Audituese
5. J. T. , Audituese

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që UKK SHA ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë shoqërisë. Auditimi ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raportet e besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhenëse u është shërbyer abonentëve për furnizimin me ujë të pijshëm, si dhe shërbimin e largimit të ujërave të ndotura sipas standardeve që kërkohen.

2. Qëllimi i auditimit

Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim **promovimin e përgjegjshmërisë** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. *Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).*

3. Identifikimi i çështjes

Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Shoqëria ka si qëllim sigurimin dhe furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm me ujë, në një mënyrë të shëndetshme, ekonomike dhe mjedisore.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 óMbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 óPër sponsorizimet, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 óPër tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 óPër arkivat; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 óPër kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përdorimit të ujërave të ndotura, i ndryshuar; Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 óPër strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 óKodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 óPër regjistrimin e pasurive të paluajtshme, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 óPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 óPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 óPër funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës óPër emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 óPër miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK, VKM nr. 236, datë 10.05.1993 óPër administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjarë dhe jo familjarë i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 3, datë 28.07.2004 óPër administrimin e ujit të pijshëm; metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009; Kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 04.02.2011 óPër miratimin e modelit të kontratës tip; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 óPër disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 óPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë; etj.

7. Standardet e auditimit

- ISSAI100– *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*
- ISSAI400 *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).*

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* në mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve të veçanta.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e UKK, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, takimeve ballafaqese në subjekt dhe në KLSH, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Shoqëria óUjësjiellës KanalizimeKurbino SHA, funksionon si Shoqëri me kapital 100% shtetëror. Aksionari i vetëm i kësaj shoqërie është Bashkia Kurbino e përfaqësuar nga znj. M. C. . Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareó, i ndryshuar.UKK SHA drejtohet me një nivel qëështëKëshilli Administrativ (KA). KA ipërbërë nga z. A. P. , Kryetar, z. A. B. dhe z. R. T. anëtarë, funksionon sipas përcaktimeve në ligjin e mësipërm dhe statutin e shoqërisë. Administrator i Shoqërisë është z. A. P. .Shoqëria ka si qëllim sigurimin dhe furnizim e qëndrueshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm me ujë, në një mënyrë të shëndetshme, ekonomike dhe mjedisore.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

1. Titulli:	Mungon regjistri i vendimeve të AP dhe regjistri i pjesëmarrjeve të mbledhjeve të KA.
Situata:	Për vitet objekt auditimi 2018, 2019, 2020 dhe 2021 (4 mujor) rezulton se nuk është mbajtur regjistri i vendimeve të AP dhe regjistri i pjesëmarrjeve të mbledhjeve të KA. Mos regjistrimi i vendimeve të AP, referuar ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135, paragrafi i fundit <u>përcaktohet se</u> : “Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme”, shkakton cilësimin e tyre si të pavlefshëm.
Kriteri:	Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareó, i ndryshuar, neni 135, pika 4 si dhe Statuti i shoqërisë i miratuar me Vendimin nr. 2 datës 13.05.2019, neni 10 pika 1 <u>ku përcaktohet se</u> : “Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen”dhe neni 14, pika 6 <u>ku përcaktohet se</u> : Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhjeó.
Ndikimi:	Mungesa e regjistrimit të vendimeve mund tëpassjell pavlefshmëri të akteve dhe nuk konfirmohet pjesëmarrja e anëtarëve të KA për sa i përket angazhimit të tyre lidhur me zbatimin e detyrave që u ngarkon ligji në drejtim të Administrimit të Shoqërisë.
Shkaku:	Mos mbajtja e regjistrimit të vendimeve nga ana e Sekretarit të AP dhe e regjistrimit të pjesëmarrësve të anëtarëve të KA në mbledhjet e saj.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	AP e përfaqësuar nga Aksionari i vetëm Bashkia Kurbino, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit të AP të marrë masa për të mbajtur regjistrin e posaçëm të vendimeve të AP me qëllim shmangien e tyre si absolutisht të pavlefshme. Gjithashtu, KA dhe Administratori të marrin masat për plotësimin e regjistrimit të pjesëmarrjes nga Sekretari i KA gjatë mbledhjeve.
2. Titulli i gjetjes:	Asambleja e Aksionarëve të UKK SHA, rezulton të jetë mbledhur vetëm 4 herë

	për vitin 2019, dhe nuk është mbledhur as edhe një herë në vitin 2018 dhe 2020.
Situata:	Asambleja e Aksionarëve nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe konkretisht nenit 6 óAsambleja e përgjithshëm, pika 3, sipas të cilës óAsambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, detyrim i cili sipas pikës nr. 2 thirret nga Kryetari i AP (Kryetarja e Bashkisë); Këshilli i Administrimit; Administratori i Shoqërisë, por mund të thirret edhe nga Eksperti Kontabël i Autorizuar; nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata për raste emergjente
Kriteri:	Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar dhe Statuti i Shoqërisë, neni 6 óAsambleja e përgjithshëm, pika 3, sipas të cilës óAsambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit
Ndikimi:	Mos ushtrim i rregullt i veprimtarisë
Shkaku:	Nuk janë marrë vendime dhe nuk është analizuar vit pas viti situata financiare e UKK
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	UKK SHA të marrë masa për realizimin e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve të paktën 1 (një) herë në vit, sipas përcaktimeve statutoare.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Mbi shtrirjen territoriale të UKKurbin dhe treguesit e përgjithshëm financiar

SHA Ujësjiellës Kanalizime Kurbini, ka për aksionar me 100% të vlerës së aksioneve, Bashkia e re të Kurbinit, NJQV e cila shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbini ka 46,291 banorë, ndërsa sipas regjistrimit civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, me densitet të popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011, 172 banorë km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 271 banorë km².

Territori i Bashkisë Kurbini shtrihet në një zonë bujqësore dhe pjesërisht malore në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe.

Kurbini gjendet përgjatë aksit rrugor dhe hekurudhor veri-jug, gjë që ka sjellë edhe zhvillimin e shërbimeve të transportit. Qyteti i Laçit, i cili ka një të tretën e popullsisë së bashkisë, është një zonë ish-industriale dhe është krijuar si qytet përreth fabrikave të Superfosfatit dhe të pasurimit të bakrit, që të dyja të mbyllura. Pjesa tjetër e bashkisë është zonë bujqësore, ndërsa me rëndësi konsiderohet Laguna e Patokut, e cila është zhvilluar si zonë peshkimi dhe qendër e turizmit ditor. UKKurbini SHA aktualisht rezulton se ka të punësuar mesatarisht 120 punonjës si dhe rreth 7120 lidhje (kjo sipas raportimeve të ERR. , për vitin 2020) dhe është një shoqëri në vështirësi të mëdha financiare, nga ku sipas të dhënave me burim UKK, prodhimi për periudhën objekt auditimi është 9,5 milion lekë; faturimi 3,8 milion lekë dhe humbjet 5,6 milion lekë ose rreth 60 % të prodhimit, humbje të cilat në fakt kanë tregues pozitiv vit pas viti, pasi vijnë në reduktim, duke u ulur nga 65% në vitin 2018 në 54% në vitin 2020.

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 539/1, datë 20.05.2021, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për periudhën 01.01.2018-30.04.2021;
- 2- Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe/apo Këshillit të Administrimit për periudhën 01.01.2018-30.04.2021;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

A. VENDIMET E MARRA NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
Për periudhën Janar 2018-Prill 2021

Me reformën e re territoriale aksionari i vetëm i UK Kurbin SHA, për periudhën objekt auditimi, është Bashkia Kurbin e përfaqësuar nga Kryetari znj. M. C. . Për vitin 2018 e vijim, Administrator është caktuar z. A.P., kjo sipas Vendimit respektiv të Asamblesë së Aksionarëve, (nr. 4, datë 12.05.2016), detyrë të cilën z. P. e kryen që nga krijimi i UKK, duke qenë kështu titullari i parë i këtij institucioni, krijuar në vitin 2018, pas reformës territoriale, ndërsa më parë UKK SHA është krijuar në vitin 2002, duke përfshirë ish-Bashkitë Laç 46.3% dhe Mamurras 33.9% si dhe ish-Komunën Milot 19.8% të aksioneve.

Administratori aktual, z. P. , është riemëruar në detyrë për një periudhë 3 vjeçare, sipas vendimit të AA nr. 4, datë 13.05.2019, si dhe kontratës së punës nr. 2505/1, datë 14.05.2019, prot nga UKK me nr. 93, datë 14.05.2019, si dhe Kryetar i KA me kontratën e punës nr. 2505, datë 14.05.2019.

Sipas Kontratave respektive të sipërcituara, konkretisht nenit 3 óKohëzgjatja e kontratësó, kontrata lidhet për një periudhë 1 (një) vjeçare me të drejtë rinovimi. Rinovimi i kontratës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit do të jetë në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Për periudhën objekt auditimi rezulton se nga Bashkia Kurbin nuk është respektuar ky detyrim i përcaktuar në kontratën e sipërcituar.

Për periudhën Janar 2018- Prill 2021 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e përbërë nga ortakut i vetëm Bashkia Kurbin është drejtuar nga A. B. (ish-Kryetar i Bashkisë) dhe aktualisht nga M. C. (Kryetare aktuale e UKK).

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga UKK, rezulton se për periudhën objekt auditimi Asambleja Aksionerëve (AA) është mbledhur vetëm 1 herë duke marrë gjithsej 6 vendime, të cilat i përkasin vitit 2019 (sipas tabelës bashkëlidhur).

Vendimi nr. 1, datë 13.05.2019, përkon me emërimin e sekretarit të Asamblesë dhe konkretisht z. Santor Lleshi, vendimi nr. 2, datë 13.05.2019, përkon me miratimin e statutit; vendimi nr. 3, datë 13.05.2019, përkon me miratimin e Administratorit; vendimi nr. 4, datë 13.05.2019, përkon me miratimin e Kryetarit të KA dhe 2 anëtarëve; vendimi nr. 5, datë 13.05.2019, përkon me shkarkimin e ekspertit kontabël z. Sh. T. ; dhe vendimi nr. 6, datë 13.05.2019, përkon me emërimin në detyrë të ekspertit kontabël z. A. K. ;

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e mbledhjeve të AA, rezultoi se procesi i realizimit të mbledhjeve, vendimmarrja, pasqyrimi e deri në zbardhjen e vendimeve është kryer konform procedurave ligjore, pasi rezulton se:

Mbledhjet janë realizuar me kërkesë të Administratorit për thirrjen e AA, duke realizuar procesin e njoftimit të anëtare dhe duke përcaktuar rendin e ditës. Për çdo vendim nga Sekretari i Asamblesë S. Ll. është mbajtur procesverbali përkatës i cili rast pas rasti është firmosur dhe më tej është bërë zbardhja e vendimeve, të cilat po ashtu janë firmosur.

Nga auditimi rezulton se Asambleja e Aksionerëve nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe konkretisht nenit 6 óAsambleja e përgjithshmeó, pika 3, sipas të cilës óAsambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vitó, detyrim i cili sipas pikës nr. 2 thirret nga Kryetari i AP (Kryetarja e Bashkisë); Këshilli i Administrimit; Administratori i Shoqërisë, por mund të thirret edhe nga Eksperti Kontabël i Autorizuar; nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata për raste emergjente.

B. MBI VENDIMET E MARRA NGA KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

Për periudhën Janar 2018 deri më Prill 2021.

Për periudhën Janar 2018- Prill 2021 Këshilli i Administrimit i përbërë nga A. P. , Administratori dhe A. B. dhe R. T. (anëtarë), si përfaqësues të Bashkisë Kurbin sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga UKK, rezulton se ka marrë gjithsej 33 vendime dhe konkretisht 12 vendime për vitin 2018; 10 vendime për vitin 2019; 7 vendime për vitin 2020 dhe 4 vendime për vitin 2021 (sipas tabelës bashkëlidhur).

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit mbi realizimin e mbledhjeve të Këshillit Administrimit, rezultoi se procesi i realizimit të mbledhjeve, vendimmarrja, pasqyrimi e deri në zbardhjen e vendimeve është kryer konform procedurave ligjore, pasi rezulton se:

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit (KA) janë realizuar me kërkesë të Administratorit për thirrjen e KA, duke realizuar procesin e njoftimit të anëtarë dhe duke përcaktuar rendin e ditës. Për çdo vendim nga njëri prej anëtarëve dhe konkretisht z. T. , kjo për shkak të mungesës të Sekretarit të Këshillit (pa caktuar për mungesë fondesh). është mbajtur procesverbali përkatës i cili rast pas rasti është firmosur nga të tre anëtarët e KA^{nsë}, si dhe më tej është bërë zbardhja e vendimeve, të cilat po ashtu janë firmosur nga të tre anëtarët e KA^{nsë}.

Nga auditimi rezulton se janë bërë njoftime të rregullta për zhvillimin e mbledhjeve si njoftimet janë bërë në kohë, për të mundësuar vënien në disponim të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës apo Këshillit të Administrimit raportet dhe materialet e përgatitura për mbledhje dhe vetëm në dy raste rezulton se në dosjen e administruar nga UKK mungon procesverbali i mbledhjes dhe vetëm një rast mungon Njoftimi i Administratorit, raste të cilat përbëjnë një fenomen të izoluar dhe nuk kanë pasjellë vendimmarrje të gabuar.

2. Mbi hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij.

1. Titulli i Gjetjes:	Mangësi të identifikuar në hartimin e plan biznesit 5 vjeçar, hartimin programeve ekonomiko-financiare vjetore dhe miratimin e ndryshimit të tyre.
Situata:	1. Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 dhe 2021 UK Sh.a. Kurbin, nuk ka hartuar apo miratuar plane të programeve ekonomiko-financiare vjetore dhe nuk ka reflektuar ndryshimet e tyre (sipas rasteve kur ka patur ndryshime), duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr.nr. 9901, datë 14.4.2008, óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareó, të shkronjave óaó e óbó, të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, óPër organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendoreó, të ndryshuar për zbatimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit. Shoqëria është mjaftuar vetëm me plan biznesin 5 vjeçar 2019-2024, dokument ky që nuk ka përfshirë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit, por vetëm për vitin 2019. Për këtë periudhë konstatohet se nga ana e administratorit nuk është hartuar urdhri për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt-programeve si dhe nuk janë dërguar, pranë Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim. 2. Nga auditimi u konstatua se në programin ekonomiko financiar të vitit 2018 dhe plan biznesin 2019-2024 konstatohet se nuk janë përfshirë në

	këtë plan investimet e realizuara faktikisht, ku përmendim këtu projektin "Ndërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laç", për shkak se këto dokumentacione nuk janë rishikuar në vijim për të shoqëruar ato me relacione shpjeguese të faktorëve që nuk kanë mundur parashikimin e tyre në program sipas rastit në mënyrë që të pasqyrohet domosdoshmëria e kryerjes investimeve të parashikuara; tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve në raport me shpenzimet e tjera. Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në kapitullin I të tij parashikon procesin e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, detyrim ky i të gjitha shoqërive publike me kapital shtetëror për periudha 1 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të mbështetet në objektivat e caktuara nga organet drejtuese dhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 dhe të miratohen nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli i Administrimit.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të shkronjave "a" dhe "b", të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, kapitulli I; Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 .
Ndikimi/Efekti:	Pamundësi për hartimin e programeve sipas objektivave afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë; mos përcaktimi i vizionit, qëllimeve strategjike, analizave për menaxhimin e kërkesës për ujë, programit për përmirësimin e performancës; mungesë planifikimi të investimeve kapitale të shoqërisë dhe mos reflektim i ndryshimeve në buxhetet në dispozicion në planin financiar.
Shkaku:	Mos vendosja në zbatim e përcaktimeve ligjore dhe rregullatore nga ana e strukturave drejtuese të shoqërisë; infrastruktura e dobët dhe kushtet e vështira sipas së cilave zhvillohet veprimtaria e institucionit nuk kanë lejuar përmbushjen e këtyre kriterëve; mungesa e trajnimeve të stafit në këtë drejtim
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	1. Administratori i UK Kurbin të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt programeve për çdo vit, dhe për t'ja dërguar ato Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim. 2. Grupet e punës për hartimin e planeve ekonomiko-financiare, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në planin e biznesit 5 vjeçar të përfshijnë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit me qëllim përmirësimin e performancës dhe objektivave strategjik dhe vjetor të shoqërisë në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës dhe Kanalizime.

2. Titulli i Gjetjes:	Mangësi të identifikuar në drejtim të raportimit tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar.
Situata	Nga auditimi u konstatua se për sa i përket raportimit tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar nuk ka gjetur zbatim në të gjitha rastet VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaô, neni 18 pika 7 óAdministratori Ekzekutiv ka këto kompetenca: ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.”; neni 13 pika 3 “ Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t’iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiarô; dhe neni 20 pika 2 óDrejtori tregtar ka këto kompetenca: c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.se raportimi nuk ka qenë konformô. Në ato raporte të kryer nga ana e administratorit, <u>jo në të gjitha rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit. Më hollësisht në analizën për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018 konstatohet se është kryer një raportim vetëm për vlerën totale të tyre, duke mos evidentuar realizimin sipas zërave. Gjithashtu, në raportimet e kryera, informacioni është bazuar vetëm në shpenzimet e kryera bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga vetë shoqëria, duke mos përfshirë në to informacion mbi subvencionet e përfituara, apo detyrimet e pa shlyera të njesisë. Në këto kushte nuk mundësohet monitorimi i realizimit të planit.</u>
Kriteri:	VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaô, neni 18 pika 7
Ndikimi/Efekti:	Pamundësi për kryerjen e monitorimit të realizimit të planit të të ardhurave mujore apo vjetore me qëllim marrjen e masave në kohë ku është e mundur për përmirësimin e situatës; Mungesa e planeve të paracaktuara sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve nuk mundëson monitorimin e tyre për shmangien e tejkalimeve; apo identifikimin e arsyeve për zërat që rezultojnë me nën realizim.
Shkaku:	Mos kryerja e raporteve periodike në përputhje me kuadrin rregullator dhe ligjor; Në raportimet e kryera nga ana e administratorit, jo në të gjitha

	rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	1. Administratori i UK Kurbin të marrë masa për kryerjen e raportimeve mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar mujor dhe vjetor pranë Këshillit Administrativ me informacione të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, për të mundësuar analizimin e të dhënave historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë sipas planit dhe periudhave të mëparshme.

3. Titulli i Gjetjes:	Mangësi në drejtim të raportimit mbi detyrimet e prapambetura dhe evidencave të tjera të shpenzimeve të financuara nga buxheti i shtetit
Situata	Nga auditimi u konstatua se për sa i përket financimit nga buxheti i shtetit, nga ana e UK Kurbin për periudhën nën auditim nuk rezulton të jenë përcjellë pranë institucioneve eprore projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime periodike me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (kryesisht për investime). -Drejtorja e Thesarit pranë MFE ka raportuar pagesa për detyrime të prapambetura nga UK Kurbin në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara otë paguara gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr.50, datë 05.02.2014 óPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitó, në një kohë ku nga ana e shoqërisë <u>nuk rezulton të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE</u>; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UK Kurbin paraqiten në vlerën 0. Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, dhe raportit vjetor për stokun e detyrimeve të prapambetura të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, UK Kurbin në vitin 2019 rezulton ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën 13,986,204 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjetës Kurbin ato rezultojnë në vlerën 435,508,393lekë ; dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjetës Kurbin në vlerë 612,388,769lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat sikundër vërehet paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë K.A, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese.
Kriteri:	Ligjinr. 10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe Kontrollinó, i ndryshuar; VKM nr.50, datë 05.02.2014 óPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitó
Ndikimi/Efekti:	Raportim jo i saktë i situatës lidhur me detyrimet e prapambetura në

	shumat e deklaruar si të paguara dhe stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Mungesa së analizimit dhe marrjes së masave nga organet drejtuese të shoqërisë për reduktimin e humbjeve; mangësi në raportimin drejt strukturave drejtuese
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Organet Drejtuese të UK Kurbin, duke përfshirë Administratorin, Këshillin e Administrimit, Asamblenë e Përgjithshme, etj të ngrenë grupe punë për analizimin e detyrimeve të prapambetura; përcjelljen e një informacioni real të vlerës së tyre me qëllim raportimin real të tyre në raportin vjetor të hartuar nga MSHMS për stokun e detyrimeve të prapambetura, dhe hartimin e një plani veprimi dhe shlyerjeje për reduktimin e tyre.

4. Titulli i Gjetjes:	Planifikim i dobët i buxhetit për investime të UK Kurbin, shoqëruar me rishikime të fondeve përgjatë vitit; dhe ndërmarrja e angazhimeve për kryerjen e investimit duke planifikuar një buxhet 3 vjeçar afatmesëm që mbulon vetëm 42% të fondeve të një kontrate me afat zbatimi 2 vjeçar
Situata	-Nga analizimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit me përfitues UK Kurbin konstatohet se përgjatë vitit 2020 ka patur disa rishikime të fondeve buxhetore, konkretisht 4 rishikime për projekte që prekin investimet kapitale me një rritje të fondeve të këtyre projekteve me vlerë prej 52,776 mijë lekë. Sipas Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 óPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitô, pika 79: <i>óNumri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetitô, dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve, referuar edhe vlerës totale të shpenzimeve të kryera në kuadër të investimeve kapitale të UK Kurbin, mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime reflektuar edhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit. Gjithashtu, nga kryqëzimi i të dhënave të kontratave të lidhura me përfitues UK Kurbin për vitin 2020, me PBA-në e institucioneve qendrore publikuara në web-in e MFE, u konstatuan 2 projekte me vlerë totale 12,276 mijë lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, pra plani i pagesave të kontratave për projekte investimesh në PBA e periudhës 2020-2022 për vitin 2020 nuk cilat kanë të përfshirë plan pagesash për këto projekte por përgjatë vitit janë rishikuar fondet për financimin e këtyre kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 óPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ô, pika 19. e) e tij. Për rishikimet e kryera më sipër, nga ana e UK Kurbin nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë kërkesë zyrtare pranë institucioneve eprore për kryerjen e këtyre ndryshimeve në buxhetet në dispozicion.</i> - Nga auditimi u konstatua se kontrata e investimit óNdërtimi i rrjetit të jashtëm e të brendshëm ujësjellësit të qytetit Laç faza IIô ka planifikuar

	kryerjen e shpenzimeve financiar nga buxheti i shtetit në kontratë si më poshtë: Viti 2020 - 87 767 397 lekë pa tvsh. Viti 2021 - 70 000 000 lekë pa tvsh Viti 2022 - 30 000 000 lekë pa tvsh Pra në total sipas kontratës në vlerën 438,836 mijë lekë, në harkun 3 vjeçar janë planifikuar për t'iu kryer pagesa në vlerë 187,767 mijë lekë (ose 42%); dhe shuma e mbetur e financimit është përcaktuar në vitet në vazhdim. Në kushtet kur faktikisht kontrata parashikon përfundimin e punimeve në harkun kohor 2 vjeçar, ky nivel planifikimi i fondeve icili po kështu paraqitet edhe në planin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar mund të bëhet shkak për krijimin në të ardhmen të detyrimeve të prapambetura. Për këtë projekt, me aktin normativ nr. 34, në datën 23 Dhjetor është shtuar niveli i financimit edhe me 40,000,000 lekë, pra rreth 57% të planit të buxhetit që sipas PBA 2020-2022 ishte parashikuar për këtë kontratë në vitin 2021.
Kriteri:	Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Planifikimi 3 vjeçar i fondeve për likuidimin e detyrimeve të kontratave duke mos mbuluar vlerën totale të tyre, bëhet shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Rishikimet e shpeshta të fondeve kanë një impakt negativ në indikatorët e matjes së performancës së buxhetit.
Shkaku:	Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit.; Planifikim i fondeve më pak se detyrimet e pritshme të zbatimit të kontratës referuar periudhës kohore të implementimit të saj
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	Strukturat përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, në bashkëpunim me AKUK, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit gjatë procesit të planifikimit, dhe ekzekutimit të buxhetit duke bërë palë të këtij procesi edhe njësitë e varësisë përfituese të fondeve publike, në këtë rast UK Kurbin, me qëllim përmirësimin e performancës buxhetore në drejtim të përfshirjes në projektbuxhet të investimeve dhe shmangien e rishikimeve përgjatë vitit me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit, dhe që mund të bëhen shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Gjithashtu, këto struktura, të marrin masat për shmangien në të ardhmen të fenomenit ku planifikimi i fondeve për investime nuk garanton mbulimin e pagesave të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i kontratave, referuar edhe periudhës kohore të implementimit të projektit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Projekt programet ekonomike drejtuar Këshillit Mbikëqyrës/Administrimit së bashku me relacionet respektive për periudhën 2018-2021.*
- *Miratimi i programeve ekonomike nga Këshilli Mbikëqyrës/Administrimi dhe/ose Asambleja Aksionare për periudhën 2018-2021.*
- *Plani i biznesit*
- *Planifikimi (fillestar dhe i ndryshuar sipas relacioneve respektive) dhe realizimi i programeve ekonomike për periudhën objekt auditimi.*
- *Etj.*

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 dhe 2021 UK Sh.a. Kurbin, **nuk** ka hartuar apo miratuar plane të programeve ekonomiko-financiare vjetore dhe ndryshime (sipas rastit), duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr.nr. 9901, datë 14.4.2008, óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të shkronjave óaó e óbó, të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, óPër organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, të ndryshuar për zbatimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit. Shoqëria është mjaftuar vetëm me plan biznesin 5 vjeçar 2019-2024, dokument ky që **nuk** ka përfshirë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit, por vetëm për vitin 2019. Për këtë periudhë konstatohet se nga ana e administratorit nuk është hartuar urdhri për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt-programeve si dhe nuk janë dërguar, pranë Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

-Lidhur me planifikimin e kryer për vitin 2018 dhe 2019, në programin ekonomiko financiar të vitit 2018 dhe plan biznesin 2019-2024 konstatohet se nuk janë përfshirë investimet e realizuara faktikisht, ku përmendim këtu projektin óNdërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laçó. Gjithashtu konstatohet se **nuk** janë rishikuar këto dokumentacione në vijim shoqëruar ato me relacione shpjegues të faktorëve apo që nuk kanë mundur parashikimin e tyre në program sipas rastit në mënyrë që të pasqyrohet domosdoshmëria e kryerjes investimeve të paparashikuara, si edhe tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve në raport me shpenzimet e tjera. Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 óMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëroró në kapitullin I të tij parashikon procesin e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, detyrim ky i të gjitha shoqërive publike me kapital shtetëror për periudha 1 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të mbështetet në objektivat e caktuara nga organet drejtuese dhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 dhe të miratohen nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli i Administrimit. Kreu I, pika 8 e VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaó përcakton se Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut për të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve e afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së informacionit miratohen me udhëzime të ministrit të linjës. Gjithashtu, shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar për pjesën e tyre të të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

-Ujësjellës Kanalizime Kurbin ka plotësuar detyrimin e saj për të përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime çdo 3 mujor pyetësorët përkatës. Për sa i përket detyrimit për të raportuar pranë Prefektit të Qarkut, nga ana e Ujësjellësit është kryer raportimi periodik, por në mungesë të përgjigjeve/komenteve nga ky organ, kohët e fundit nuk është kryer më një raportim i tillë.

- Për sa i përket raportimit tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar rezulton se **nuk** ka gjetur zbatim në të gjitha rastet VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaó, neni 18 pika 7 óAdministratori Ekzekutiv ka këto kompetenca: ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.”; neni 13 pika 3 “ Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi: ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t’iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiaró; dhe neni 20 pika 2 óDrejtori tregtar ka këto kompetenca: c) Harton plan-buxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.se raportimi nuk ka qenë konformó. Në ato raportime të kryer nga ana e administratorit, jo në të gjitha rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast **nuk** rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit. Më hollësisht në analizën për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2018 konstatohet se është kryer një raportim vetëm për vlerën totale të tyre, duke mos evidentuar realizimin sipas zërave. Gjithashtu, në raportimet e kryera, informacioni është bazuar vetëm në shpenzimet e kryera bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga vetë shoqëria, duke mos përfshirë në to informacion mbi subvencionet e përfituara, apo detyrimet e pa shlyera të njësisë. Në këto kushte nuk mundësohet monitorimi i realizimit të planit. Vendimet e Këshillit të Administrimit mbajnë numrin 1 për të gjitha periudhat, duke mos ecur sipas rendit kronologjik për çdo vit.

Më hollësisht:

Viti 2018

Mbi hartimin dhe miratimin e programit ekonomiko-financiar

Administratori i Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbin me urdhrin nr.23, datë 01.03.2018 ka ngritur grupin e punës për hartimin e planit të biznesit, me përbërje:

1. Z. T. P. , Drejtor Departamenti Tregtar
2. Znj. J. E. , Kryetar i Degës Teknike
3. Z. G. M. , Përgjegjës Finance
4. Z. V. T. , Përgjegjës Sektori Laç

Në vijim, me vendimin nr.1, datë 03.04.2018 të Kryetarit të Asamblesë Aksionare Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbin, dhe me vendimin nr.1, datë 19.03.2019 të Këshillit të Administrimit të UK Kurbin, është miratuar plani i biznesit i shoqërisë për vitin 2018.

Mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar

1. Në vijim të shkresës nr.183, prot datë 07.03.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështet për t’u trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Shkurt 2018, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 12.03.2018.

2. Në vijim të shkresës nr.235, prot datë 23.04.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështet për t’u trajtuar

është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Mars 2018, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 26.04.2018.

3. Në vijim të shkresës nr.2308, prot datë 07.06.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Maj 2018, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 11.06.2018.

4. Në vijim të shkresës nr.359 prot datë 10.07.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Qershor 2018, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 13.07.2018.

5. Në vijim të shkresës nr.390, prot datë 22.08.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Korrik 2018, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 27.08.2018.

6. Në vijim të shkresës nr.426, prot datë 20.09.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Gusht 2018.

7. Në vijim të shkresës nr.467, prot datë 25.10.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Shtator 2018 , miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 29.10.2018.

8. Në vijim të shkresës nr.497, prot datë 20.11.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Tetor 2018 , miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 26.11.2018.

9. Në vijim të shkresës nr.533, prot datë 17.12.2018 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Nëntor 2018 , miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 20.12.2018, por duke qenë se ato nuk paraqiten në mënyrë progresive nuk janë përfshirë në tabelën e mëposhtme.

10. Në vijim të shkresës nr.54, prot datë 25.01.2019 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018 , miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 30.01.2019. Në këtë dokument janë miratuar të ardhurat dhe shpenzimet në total, bazuar vetëm në të ardhurat e gjeneruara nga vetë shoqëria (pra pa përfshirë subvencionet) dhe shpenzimet faktike të kryera, pa identifikuar ato të pa shlyera, që përkthehen në detyrime të prapambetura për njësinë.

Analiza vjetore e vitit 2018 miratuar nga Administratori i shoqërisë, z. A. P. në datë 24.01.2019 është përcjellë elektronikisht për grupin e auditimit. Ky dokumentacion konsiston në një relacion të hartuar kryesisht për identifikimin e disa prej ngjarjeve kryesore me të cilat është përballur institucioni, sfidave dhe vendimmarrjeve kyce. Fillimisht, në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me iujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaó është krijuar shoqërua Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbin (ku nga bashkimi i shoqërisë me ish ndërmarrjen e ujësjiellës kanalizimeve është rritur kapitali në 595 milion lekë, nga 181 milion lekë) për tōu pasuar me hartimin e

strukturës organizative, rregullores dhe planit të biznesit për vitin 2018; si dhe miratimin me licencën për ushtrimin e aktivitetit.

Gjithashtu, ndër të tjera për **vitin 2018** janë raportuar të ardhura në vlerën 57,464 mijë lekë, nga të cilat 11,220 mijë lekë janë përdorur për arkëtime detyrimesh të prapambetura; 16,270 mijë lekë shlyerje detyrime energji elektrike ndaj OSHEE.

Prioritetet e UK Kurbin për këtë periudhë:

- Ulje e humbjeve
- Ndërprerja e lidhjeve të paligjshme
- Likuidimi i faturave të energjisë elektrike
- Pajisja e punëtorëve me uniforma dhe vegla pune
- Ngritja e nivelit të arkëtimeve në Milot dhe Mamurras
- Vendosja e matësve të ujit për abonentët familjarë
- Ndjekja e debitorëve ndër vite për abonentët familjarë dhe lidhja e akt marrëveshjeve
- Dorëzimi i dokumentacionit të ujësjellësit pranë Arkivit Lezhe.

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas zërave për **vitin 2018** paraqitet sipas tabelës më poshtë. Lidhur me realizimin, nuk ishte e mundur kryerja e të njëjtës analizë pasi nga ana e Ujësjellës Kurbin nuk kryhej një raportim i tillë.

Në mijë lekë

Viti 2018		
	Planifikimi	Realizimi
Të ardhura		
Popullata	39,072	
Lokale	3,758	
Ente private	757	
Institucione buxhetore	3,740	
Libreza Uji	120	
Ndërrim kontrate	95	
Kontrata të reja	638	
Mbyllje kontrate	55	
Arkëtime të prapambetura	16,074	
Tarifë vërtetimi	221	
Interes bankare		
Matësa uji shitje	1,042	
Subvencion bashkia Kurbin	12,000	
Subvencion AKUK Tiranë		
Total	78,295	NA
Shpenzime		
Paga	49,000	
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	9,731	
Tatim në burim	126	
Shërbim telefoni	25	
Shërbim postar	25	
Shërbim interneti	30	
Blerje klori	720	
Shpenzime transporti, naftë	2,500	
Amortizim		
Bloqë uji, kancelari	700	
Pagesë Tarife Përdorimi Burime Ujore	35	
Pagesë tarifë ERRU	348	
Pagesë ekspert kontabël	108	
Qera	600	
Materiale të ndryshme elektrike dhe hidraulike	2060	
Komisione bankare	25	
Energji elektrike për zyra	1,500	
Veprim sistemes bankar		
Pagesë trupi certifikues TCPE Sigurim Teknik	75	

Vlerësim i ndikimit në mjedis		
Zyra e përmbarimit+ISHSH	641	
Detyrime të prapamberura	550	
Blerje komp	130	
Uniforma, vegla pune	510	
Projekte investimi	780	
Investim hidroizolim, riparim, emergjenca	7,872	
Total Shpenzimet	78,295	NA

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Pra, për shkak të mos kryerjes së analizimit të realizimit të shpenzimeve sipas zërave në të cilat kryet planifikimi, nuk ishte e mundur kryerja e krahasimit mbi nivelin e realizimit krahasuar me planin për vitin 2018.

Në Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime **për vitin 2018** ku janë pasqyruar për cdo shoqëri UK të ardhurat nga aktiviteti duke i krahasuar ato me O&M dhe Kostot Totale, si dhe rezultatin financiar vjetor të tyre me humbje ose fitim; si dhe nevojat reale për subvencione për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra nga shoqëritë, situata për UK paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

UK Kurbin	
Të ardhurat nga aktiviteti UK	49,189
Kostot O&M	124,167
Kosto totale	137,998
Nevoja për subvencione për mbulimin e kostove O&M	74,978
Në% ndaj totalit të kostove O&M	60%
Subvencionet e marra	38,070
Diferenca	(36,908)
Humbje	(88,809)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Viti 2019

Mbi hartimin dhe miratimin e programit ekonomiko-financiar

Për vitin 2019, administratori i Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbin me urdhrin nr.97, datë 17.12.2018 ka ngritur grupin e punës për hartimin e planit të biznesit me përbërje:

1. Z. T. P. , Drejtor Departamenti Tregtar
2. Znj. J. E. , Kryetar i Degës Teknike
3. Z. G. M. , Përgjegjës Finance
4. Z. D. A. , Përgjegjës i Degës së Shitjes
5. Znj. A. Rr. , Ekonomiste Kujdesi ndaj Klientit

Në konkludim të punës së këtij grupi, me vendimin nr.1, datë 11.02.2019 të Kryetarit të Asamblesë Aksionare Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Kurbin, dhe me vendimin nr.2, datë 01.02.2019 të Këshillit të Administrimit të UK Kurbin, është miratuar plani i biznesit për shoqërinë për **vitin 2019-2023**. Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se në emërtimin e këtij dokumenti parashikohet kryerja e planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2019-2023, rezulton se ky planifikim në këtë dokument është kryer vetëm për vitin 2019. Pra, **si rezultat** veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë për vitin 2020, 2021 ka funksionuar **pa planifikim**.

Mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar

1. Në vijim të shkresës nr.193, prot datë 24.04.2019 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështjet për t'u trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Mars 2019, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 26.04.2019.

2. Në vijim të shkresës nr.248, prot datë 28.05.2019 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tû trajtuar është analizimi i të ardhurave për muajin Janar-Prill 2019, por duke mos përfshirë analizimin e shpenzimeve.

3. Në vijim të shkresës nr.275, prot datë 20.06.2019 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tû trajtuar është analizimi i shpenzimeve për muajin Janar-Maj 2019, por duke mos përfshirë analizimin e të ardhurave.

4. Në vijim të shkresës nr.312, prot datë 17.07.2019 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tû trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Qershor 2019, miratuar me vendimin nr.2, datë 22.07.2010 të Këshillit të Administrimit.

5. Në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe Statutit të shoqërisë miratuar datë 13.05.2019, neni 14 pika 4, me vendimin nr. 4, datë 24.01.2020 të Këshillit të Administrimit të Sh.a Ujësjeles Kanalizime Kurbin, janë miratuar shpenzimet e shoqërisë për periudhën Janar-Dhjetor 2019 .

Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas zërave për **vitin 2019** paraqitet sipas tabelës më poshtë. Lidhur me realizimin, nuk ishte e mundur kryerja e të njëjtës analizë pasi nga ana e Ujësjeles Kurbin nuk kryhej një raportim i tillë.

Në mijë lekë

Viti 2019		
	Plan	Realizimi
Të ardhura		
Popullata	40,000	
Lokale	4,500	
ente private	2,600	
Institucione buxhetore	2,900	
Libreza Uji	53	
Ndërrim kontrate	113	
Kontrata të reja	50	
Mbyllje kontrate		
Arkëtime të prapambetura	5,000	
Tarifë vërtetimi	70	
Interes bankare		
Matësa uji shitje		
Subvencion bashkia Kurbin	13,654	
Subvencion AKUK Tiranë	25,000	
Total	93,940	NA
		Shpenzime
Paga	52,420	
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	8,754	
Tatim në burim		
Shërbim telefoni		
Shërbim postar		
Shërbim interneti		
Blerje klori	774	
Shpenzime transporti, naftë		
Amortizim	900	
Blloqë uji, kancelari		
Pagesë Tarife Përdorimi Burime Ujore	50	
Pagesë tarifë ERRU		
Pagesë ekspert kontabël		
Qera		
Materiale të ndryshme elektrike dhe hidraulike	5,000	
Komisione bankare		

Energji elektrike për zyra	75,000	
Veprim sistemes bankar		
Pagesë trupi certifikues TCPE Sigurim Teknik		
Vlerësim i ndikimit në mjedis		
Zyra e përmbarimit+ISHSH		
Detyrime të prapamberura		
Blerje komp		
Uniforma, vegla pune		
Projekte investimi		
Investim hidroizolim, riparim, emergjenca	1,359	
Total Shpenzimet	144,257	NA

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Edhe për vitin 2019, sikundër vitin 2018, për shkak të mos kryerjes së analizimit të realizimit të shpenzimeve sipas zërave në të cilat kryet planifikimi, nuk ishte e mundur kryerja e krahasimit mbi nivelin e realizimit krahasuar me planin.

Në Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime **për vitin 2019** ku janë pasqyruar për cdo shoqëri UK të ardhurat nga aktiviteti duke i krahasuar ato me O&M dhe Kostot Totale, si dhe rezultatit financiar vjetor të tyre me humbje ose fitim; si dhe nevojat reale për subvencione për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra nga shoqëritë, situata për UK paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

UK Kurbin	
Të ardhurat nga aktiviteti UK	43,667
Kostot O&M	130,431
Kosto totale	139,855
Nevoja për subvencione për mbulimin e kostove O&M	86,764
Në% ndaj totalit të kostove O&M	67%
Subvencionet e marra	26,453
Subvencionuar Nën nevojën për kostot O&M	(60,311)
Humbje	(96,188)
Humbje në % ndaj totale	3%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Viti 2020

Mbi hartimin dhe miratimin e programit ekonomiko-financiar

Sikundër u trajtua më sipër, për vitin 2020 Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbin ka funksionuar në mungesë të një planifikimi lidhur me situatën e pritshme ekonomiko-financiare. Sipas UK Kurbin, shoqëria është bazuar në planin e vitit 2019.

Mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar

1. Në vijim të shkresës nr.33/1, prot datë 27.04.2020 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështet për t'u trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Mars 2020, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 30.04.2020.

2. Në vijim të shkresës nr.263, prot datë 18.08.2020 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështet për t'u trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Korrik 2020, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 21.08.2020.

3. Në vijim të shkresës nr.314, prot datë 14.10.2020 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çështet për t'u trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin Janar-Shtator 2020, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 16.10.2020.

4. Me vendimin nr. 2, datë 05.02.2021 të Këshillit të Administrimit të U.K Kurbin, janë miratuar shpenzimet e kryera nga shoqëria për periudhën Janar-Dhjetor 2020, dhe analiza për situatën financiare si më poshtë:

Në mijë lekë

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Viti 2020		
	Plani	Realizimi
Të ardhura		
Popullata		34,456
Lokale+ente private		4,056
Institucione buxhetore		878
Libreza Uji		30
Ndërrim kontrate		54
Kontrata të reja		18
Mbyllje kontrate		166
Paga të prapambetura		780
Tarifë vërtetimi		4
Interes bankare		91
Total	NA	40,445
Shpenzime		
Paga		27,467
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore		5,785
Tatim në burim		144
Shërbim telefoni		24
Shërbim postar		8
Shërbim interneti		78
Blerje klori		588
Shpenzime transporti, naftë		1,601
Bllaqë uji, kancelari		402
Pagesë Tarife Përdorimi Burime Ujore		130
Pagesë tarifë ERRU		205
Pagesë ekspert kontabël		252
Qera		550
Materiale të ndryshme elektrike dhe hidraulike		2,489
Komisione bankare		81
Energji elektrike për zyra		130
Veprim sistemues bankar		1
Pagesë trupi certifikues TCPE Sigurim Teknik		68
Vlerësim i ndikimit në mjedis		83
Zyra e përmbartimit+ISHSH		445
Total Shpenzimet	NA	40,537

Pra, në mungesë të një planifikimi lidhur me planin e pritshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve, nuk është e mundur kryerja e analizave krahasimore plan-fakt për vitin 2020.

Viti 2021

Mbi hartimin dhe miratimin e programit ekonomiko-financiar

Sikundër u trajtua më sipër, edhe për vitin 2021 Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kurbin ka funksionuar në mungesë të një planifikimi lidhur me situatën e pritshme ekonomiko-financiare.

Mbi realizimin e programit ekonomiko-financiar

1. Në vijim të shkresës nr.97/1, prot datë 19.04.2021 të Kryetarit të Këshillit të Administrimit është bërë njoftimi për mbledhje të Këshillit të Administrimit ku ndër çëshjtet për tōu trajtuar është analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për muajin **Janar-Mars 2021**, miratuar ato me vendimin nr. 1, datë 22.04.2021.

Në mijë lekë

Janar-Mars 2021		
	Plan	Realizimi
Të ardhura		

Popullata		8,151
Lokale+ente private		949
Institucione buxhetore		133
Libreza Uji		11
Ndërrim kontrate		8
Kontrata të reja		8
Mbyllje kontrate		18
Paga të prapambetura		
Tarifë vërtetimi		0.2
Interes bankare		0.01
Total	NA	9,279
Shpenzime		
Paga		7,266
Pagesë për Këshillin Administrativ		178
Pagesë për Mjekun e Ndërmarrjes		25
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore		257
Tatim në burim		36
Shërbim telefoni		6
Shërbim postar		1
Shërbim interneti		
Blerje klori		315
Shpenzime transporti, naftë		450
Bllaqë uji, kancelari		119
Pagesë Tarife Përdorimi Burime Ujore		61
Pagesë tarifë ERRU		
Pagesë ekspert kontabël		
Qera		200
Materiale të ndryshme elektrike dhe hidraulike		188
Komisione bankare		10
Energji elektrike për zyra		24
Zhblllokime me autobot per KUZ		194
Veprim sistemues bankar		
Pagesë trupi certifikues TCPE Sigurim Teknik		
Vlerësim i ndikimit në mjedis		
Zyra e përmbartimit+ISHSH		50
Certifikim elektronik E Albania		4
Total Shpenzimet	NA	9,390

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të UK Kurbin

Pra, në mungesë të një planifikimi lidhur me planin e pritshëm të të ardhurave dhe shpenzimeve, nuk është e mundur kryerja e analizave krahasimore plan-fakt për 3 mujorin e parë të vitit 2021. Në mënyrë të përmblendhur për periudhën objekt auditimi, ecuria e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve (në total) në mënyrë progresive sipas raportimeve periodike të hartuara nga UK Kurbin, paraqitet si më poshtë:

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve 2018-2021

Në mijë lekë

Periudha	Të ardhura	Shpenzime
Janar-Shkurt 2018	13,580	7,663
Janar-Mars 2018	18,373	13,005
Janar-Maj 2018	27,837	27,865
Janar-Qershor 2018	32,427	33,840
Janar-Korrik 2018	36,397	39,534
Janar- Gusht 2018	40,772	47,397
Janar-Shtator 2018	54,817	53,180
Janar-Tetor 2018	59,346	56,049

Janar-Dhjetor 2018	57,464	
Janar-Mars 2019	10,611	10,130
Janar-Prill 2019	14,822	NA
Janar-Maj 2019	NA	25,092
Janar-Qershor 2019	21,691	29,841
Janar-Mars 2020	9,256	8,821
Janar-Korrik 2020	22,650	20,632
Janar-Shtator 2020	29,942	30,223
Janar-Mars 2021	9,279	9,222

Burimi: Përpunuar nga grupi i audiitmit sipas të dhënave të UK Kurbin

Lidhur me financimin e projekteve të UK Kurbin nga Buxheti i Shtetit.

-Për sa i përket financimit nga buxheti i shtetit, nga ana e UK Kurbin për periudhën nën auditim nuk rezulton të jenë përcjellë pranë institucioneve eprore projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (për investime).

-Drejtorja e Thesarit pranë MFE ka raportuar pagesa për **detyrime të prapambetura** nga UK Kurbin në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara otë paguara gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr.50, datë 05.02.2014 óPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtës, në një kohë ku nga ana e shoqërisë nuk rezulton të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UK Kurbin paraqiten në vlerën 0. Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, UK Kurbin në vitin **2019** rezulton ndër institucionet që deklarojnë **detyrime të prapambetura**, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën **13,986,204 lekë** në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjeles Kurbin ato rezultojnë në vlerën **435,508,393lekë** ; dhe në fund të vitit **2020** në vlerën **31,832,357 lekë** në një kohë ku sipas pasqyrave financiare të Ujësjeles Kurbin në vlerë **612,388,769lekë**.

-Nga analizimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit me përfitues UK Kurbin konstatohet se për vitin 2020 ka patur disa rishikime të fondeve buxhetore, konkretisht **4 rishikime për projekte** (18CF903,18CF904,19AG301,19AG302) që prekin investimet kapitale me një ndryshim buxheti prej **52,776 mijë lekë**. Sipas Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 óPër Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit, pika 79: óNumri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qëndrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit, dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve, referuar edhe vlerës totale të shpenzimeve të kryera në kuadër të investimeve kapitale për vitin 2020 (173,430 mijë) mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime reflektuar edhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit.

Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer rishikime për **2 projekte investimi** (18CF903,18CF904) me vlerë **40,500 mijë lekë** pas datës 15 nëntor të vitit 2020, veprim në kundërshtim me nenin 48 óAfati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet: óE drejta e njërive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor. Ky rishikim i fondeve është kryer në zbatim të Aktit Normativ nr.34 i fundit të vitit 2020. Gjithashtu, nga kryqëzimi i të dhënave të kontratave të lidhura me përfitues UK

Kurbin për vitin 2020, me PBA-në e institucioneve qendrore publikuara në ëeb-in e MFE, u konstatuan **2 projekte** (19AG301,19AG302,) me vlerë totale **12,276 mijë lekë**, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, pra plani i pagesave të kontratave për projekte investimesh në PBA e periudhës 2020-2022 për vitin 2020 nuk cilat kanë të përfshirë plan pagesash për këto projekte por përgjatë vitit janë rishikuar fondet për financimin e këtyre kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 óPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ó, pika 19. e) e tij.

-Nga auditimi u konstatua se kontrata REF-55903-04-08-2020 óNdërtimi i rrjetit te jashtëm e te brendshëm ujësjellësit te qytetit Laç faza IIó ka planifikuar kryerjen e shpenzimeve financiar nga buxheti i shtetit si më poshtë:

Viti 2020 - 87 767 397 lekë pa tvsh.

Viti 2021 - 70 000 000 lekë pa tvsh

Viti 2022 - 30 000 000 lekë pa tvsh

Pra në total sipas kontratës në vlerën 438,836 mijë lekë, në harkun 3 vjecar janë planifikuar për tóu kryer pagesa në vlerë 187,767 mijë lekë (42%); dhe shuma e mbetur e financimit ne vitet ne vazhdim, edhe pse faktikisht kontrata parashikon përfundimin e punimeve në harkun kohor **2 vjecar**, situatë **kjo që mund të bëhet shkak për krijimin në të ardhmen të detyrimeve të prapambetura.**

Nëse i referohemi planifikimit të kryer në PBA 2020-2022 të MIE, konstatohet se në 3 vite janë planifikuar shpenzimet si më sipër por si vlera që e përfshijnë edhe TVSH (pra për vitin 2020 janë planifikuar rreth 87 milion lekë, dhe jo rreth 109 milion lekë që është faktikisht vlera që do të paguhet nga buxheti i shtetit bashkë me TVSH). Ky planifikim në projekt buxhet ku janë parashikuar shpenzime prej **46,941 mijë lekë më pak** se plani i pagesave të kontratës në procedurën e prokurimit mund të jetë **dhe një ndër faktorët që kanë ndikuar për kryerjen e rishikimeve të fondeve në datën 23 Dhjetor** duke shtuar në buxhetin e UK Kurbin edhe 40,000 mijë leke. Fonde këto që përbëjnë rreth 56 % të buxhetit total të parashikuar për këtë kontratë në vitin 2021.

3. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

1. Titulli i gjetjes:	Mos përmbushje dhe devijime nga struktura e miratuar
Situata:	Për muajin Mars 2018, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon; 1. Nga Administrata nuk ka pasur Jurist; 2. Nga Departamenti Tregtar nuk ka pasur asnjë nga tre Faturistët e fshatrave; 3. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik. 4. Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Punëtorë Kolekori, 1 Sanitare dhe 1 Punëtor Mirëmbajtje. Për muajin Shtator 2018 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon; 1. Nga Administrata nuk ka pasur Jurist; 2. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 Faturistë, nga 21 që duhet të jenë për këtë muaj, janë 17; 3. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, si dhe mungojnë 6 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj); 4. Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Punëtor Kolektorësh, 1 Sanitare, 3 Manovratorë Saraçinescash, 1 Elektropompist Laç, 1 Elektropompist

	Mamurras. Për muajin Shkurt 2019 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon: 1. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 2 faturistë; 2. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, mungon 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe mungojnë 7 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj.); 1. Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Hidraulik (nga 3 që duhet të jenë në fakt janë 4), 1 Saldator (nga 1 që duhet të jetë në fakt janë 2), 1 Sanitare, 1 Punëtorë Kolektori, 5 Manovratorë dhe Klorifikues (nga 26 që duhet të jenë në fakt janë 31), 1 Elektropompist (nga 23 që duhet të jenë në fakt janë 24). Për muajin Gusht 2019 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon: 1. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 faturistë; 2. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, mungon 1 Elektropompist, 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe mungojnë 18 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj.); 3. Janë jashtë strukturës së miratuar, 1 Hidraulik, 1 Saldator, 1 punëtorë Kolektorësh, si dhe 4 Manovratorë dhe Klorifikues. Për muajin Prill 2020 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon: 1. Nga Administrata mungon Inxhinieri; 2. Nga Departamenti Tregtar mungon 1 Faturist; 3. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit, Përgjegjësi Stacion Pompe Laç, 1 Hidraulik dhe 1 Elektropompist; 4. Janë jashtë strukturës së miratuar, 4 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 1 Manovrator Klorifikues. Për muajin Dhjetor 2020 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon: 1. Nga Administrata mungon Inxhinieri; 2. Nga Departamenti Tregtar mungon 1 Faturist; 3. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit, Përgjegjës Depo Uji Laç, Përgjegjësi Stacion Pompe Laç, 1 Hidraulik dhe 1 Elektropompist; 4. Janë jashtë strukturës së miratuar, 3 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 2 Manovrator Klorifikues. Për muajin janar 2021 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon: 1. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 Faturist; 2. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit; Janë jashtë strukturës së miratuar, 2 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 1 Manovrator Klorifikues.
Kriteri:	Vendimet e Këshillit Administrativ óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbinô sipas viteve VKA nr. 3, datë 23.01.2018, VKA nr. 1, datë 01.02.2019, VKA nr. 1, datë 24.01.2020 dhe VKA nr. 1, datë 05.02.2021.
Ndikimi:	Mos përmbushje dhe mos respektim i strukturës organizative të miratuar.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Administratori i UK Kurbin të marrë masa për ri shqyrtimin e nevojave për pozicionet e shtuara në strukturë dhe propozimin e tyre për miratim pranë

	Këshillit Administrativ, duke shmangur emërimet e punonjësve në pozicione të pa miratuara.
--	--

2. Titulli i gjetjes:	Mos përcaktimi i plotë i nivelit të pagave.
Situata:	Në lidhjen 2 të nivelit të pagave të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 3, datë 23.01.2018 óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbinô, nuk pasqyrohet niveli i pagave për pozicionet Arkiviste dhe Arkëtare, pavarësisht se këto pozicione janë të miratuara në strukturë. Pagesa për këto 2 pozicione është bërë në nivelin e pagës së Krye-arkëtares. Po kështu edhe për pozicionin e punëtorit të Kolektorit nuk është përcaktuar niveli i pagës dhe pagesa për këtë pozicion është bërë në pagën minimale.
Kriteri:	Neni 6 i Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveô dhe neni 13, pika 1, e Statutit të Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
Ndikimi:	Paqartësi në përcaktimin e pagave të pozicioneve në strukturë dhe përcaktimi i tyre pa miratim.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Administratori dhe Këshilli Administrativ i UK të marrin masa për shqyrtimin dhe miratimin e qartë të nivelit të pagave për çdo pozicion specifik në strukturë.

3. Titulli i gjetjes:	Lidhja e kontratës së punës pa procedurë rekrutimi.
Situata:	Bazuar në Ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Administratori i UK Kurbin ka lidhur Kontratë Pune me nr. 513, datë 03.10.2019, me znj. Sh. G. , në pozicionin Mjeke e Përgjithshme. Për këtë emërim nuk ka pasur as procedurë rekrutimi dhe as miratim të Këshillit Administrativ për përcaktimin e nivelit të pagës.
Kriteri:	Neni 6 i Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveô dhe neni 13, pika 1, të Statutit të Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
Ndikimi:	Lidhja e kontratës së punës pa procedurë rekrutimi.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Administratori i UK Kurbin të marrë masa për propozimin për miratim pranë Këshillit Administrativ të nevojës së punësimit të mjekut të ndërmarrjes dhe përcaktimin e nivelit të pagës dhe në vijim të ndjekë të gjitha hapat e duhura për njoftimin dhe rekrutimin për këtë pozicion.

4. Titulli i gjetjes:	Mos llogaritja e saktë e pagave.
Situata:	Nga auditimi konstatohet që në listë-pagesat dhe listë-prezencat e UK Kurbin për periudhën objekt auditimi merret gjithmonë si referencë 21 ditë pune në muaj dhe jo 22 ditë. Ky veprim nuk ka efekt financiar gjatë përllogaritjes së pagës mujore me përjashtim kur pagesa për një punonjës nuk bëhet për ditët e plota të muajit (p.sh. punonjësi merr raport mjekësor, fillon punë në një ditë të caktuar të muajit, etj.) dhe si pasojë përpjesëtimi i ditëve të punës nuk bëhet i saktë.

Kriteri:	VKM nr. 511, datë 24.10.2002 óPër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreó i ndryshuar, kreu I, neni pikat 1-3.
Ndikimi:	Mos përlogaritje e drejtë e pagave në rastet kur pagesat nuk bëhen për muajin e plotë.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Spektori i financës të marrë masa që në përlogaritjen e pagave në rastet e mos pagesës së plotë mujore, të zbatojë përcaktimet ligjore për numrin mesatar të ditëve të punës prej 22 ditë. Ky përcaktim të zbatohet edhe nga personat përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e listë-prezenvace pranë spektorit të financës.

5. Titulli i gjetjes:	Mos llogaritja e vjetërsis së punonjsve.
Situata:	Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm për punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UK Kurbin, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë.
Kriteri:	Neni 6, pika 2, të Kodit të Punës.
Ndikimi:	Mos përlogaritja e saktë e pagave të punonjësave me gjithë elementët e saj.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Spektori i financës të marrë masa për përshirjen e vjetërsisë për secilin punonjë në përlogaritjen e pagave.

6. Titulli i gjetjes:	Gjenerimi i gjobave nga vonesat në likuidimin e sigurimeve.
Situata:	Për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklaratimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësave janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 objekt auditimi janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitó, dhe nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 óPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëó, të ndryshuar.
Ndikimi:	Vlera totale prej 1.610.234 lekë nga gjobat e gjeneruara përbën efekt financiar negativ.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Kurbin të marrë masa për kryerjen me prioritet të pagesave nga transaksione që gjenerojnë gjoba për shkak të vonesave, si dhe të planifikojë saktë në buxhete apo nevoja për subvencione vlerat sa i takon këtyre transaksioneve.

7. Titulli i gjetjes:	Efekte financiare nga vendimet gjyqësore.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka patur 6 procese gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës me punonjësit. Nga këto procese gjyqësore janë gjeneruar detyrime në vlerën 1.601.527lekë nga të cilat 1.240.727 lekë janë

	për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.
Ndikimi:	Vlera totale prej 1.601.527 përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	UK Kurbin të marrë masa që largimet nga puna të jenë konform Kodit të punës dhe Kontratës dy palëshe të punës dhe të mos shkelet asnjë e drejtë e punonjësit për asnjë rast. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që Vendimet e Gjykatës të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit nr. 539/1, datë 20.05.2021, i ndryshuar, óMbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna, u shqyrtua me zgjedhje dokumentacioni si më poshtë:

1. *Struktura organike;*
2. *Listë pagesat e punonjësve dhe dokumentacioni shoqërues;*
3. *Vendimet e Këshillit Administrativ për strukturën organizative;*
4. *Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;*
5. *Etj.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Për vitin 2018:

Struktura UK Kurbin është miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ Nr. 3, datë 23.01.2018 óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kurbinó dhe ka në përbërje të saj 170 punonjës, nga të cilët:

- a) Administrata 8 (tetë) punonjës;
- b) Departamenti Tregtar 29 (njëzetë e nëntë) punonjës;
- c) Departamenti Teknik 133 (njëqind e tridhjetë e tre) punonjës.

Për këtë vit me shkrirjen e njësisë Kanalizime, aksionari i vetëm Bashkia Kurbin nëpërmjet Urdhrave nr. 38 dhe 39, datë 22.01.2018 óPër transferim të punonjësveó, ka urdhëruar transferimin e 54 punonjësve të njësisë Kanalizime pranë Sh.A Ujësjetllës Kurbin, marrëdhëniet financiare të të cilëve fillojnë më datë 23.01.2018. Buxheti për paga, sigurime dhe tatime për këta punonjës do të sigurohet nga Bashkia Kurbin. Kjo situatë ka vazhduar edhe në vitin 2019, moment në të cilin ky veprim dhe përdorim fondesh është konsideruar shkelje në auditimin e kryer nga KLSh pranë Bashkisë Kurbin dhe në vitin 2019 nuk është vijuar më.

Nga auditimi konstatohet që për muajin Mars 2018, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

1. Nga Administrata nuk ka pasur Jurist;
2. Nga Departamenti Tregtar nuk ka pasur asnjë nga tre Faturistët e fshatrave;
3. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik.

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Punëtorë Kolekori, 1 Sanitare dhe 1 Punëtor Mirëmbajtje.

Në lidhjen 2 të nivelit të pagave të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 3, datë 23.01.2018 óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbinô, nuk pasqyrohet niveli i pagave për pozicionet Arkiviste dhe Arkëtare. Pagesa për këto 2 pozicione është bërë në nivelin e pagës së Krye-arkëtares, si dhe për pozicionin e punëtorit të Kolektorit nuk është përcaktuar niveli i pagës dhe pagesa për këtë pozicion është bërë në pagën minimale, këto në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveô dhe nenin 13, pika 1, të Statutit të Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Për punonjës in Fatmir Kuqi me pozicion Hidraulik Milot, të cilit i takon paga prej 28.600 lekë në muaj sipas miratimit të nivelit të pagave, në kundërshtim me këtë, për muajin Mars 2018 është paguar me pagë minimale prej 24.000 lekë pra me një diferencë 4.600 lekë me pak se çfarë i takon në fakt.

Nga auditimi konstatohet që për muajin Shtator 2018 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

1. Nga Administrata nuk ka pasur Jurist;
2. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 Faturistë, nga 21 që duhet të jenë për këtë muaj, janë 17;
3. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, si dhe mungojnë 6 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj).

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Punëtorë Kolektorësh, 1 Sanitare, 3 Manovratorë Saraçineskash, 1 Elektropompist Laç, 1 Elektropompist Mamurras.

Për vitin 2019:

Struktura UK Kurbin është miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ Nr. 1, datë 01.02.2019 óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbinô dhe ka në përbërje të saj 170 punonjës, nga të cilët:

- a) Administrata 8 (tetë) punonjës;
- b) Departamenti Tregtar 29 (njëzetë e nëntë) punonjës;
- c) Departamenti Teknik 133 (njëqind e tridhjetë e tre) punonjës.

Në tërësi nuk përputhet organigrama me strukturën sipas emërtimeve të pozicioneve. Në organigramë ka Punëtorë Mirëmbajtje dhe Zhbllokues, të cilët nuk identifikohen tek struktura sipas emërtesave të pozicionit. Në strukturë pozicioni i Punëtorëve është i ndarë vetëm në dy kategori (Punëtorë Kanalizimi dhe Punëtorë Ujësjiellësi).

Bazuar në Ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Administratori i UK Kurbin ka lidhur Kontratë Pune me nr. 513, datë 03.10.2019, me znj. Shkëlqime Gazi, në pozicionin Mjeke e Përgjithshme. Për këtë emërim nuk ka pasur as procedurë rekrutimi dhe as miratim të Këshillit Administrativ për përcaktimin e nivelit të pagës, në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveô dhe nenin 13, pika 1, të Statutit të Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Nga auditimi konstatohet që për muajin Shkurt 2019 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

2. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 2 faturistë;
3. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, mungon 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe mungojnë 7 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj.).

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Hidraulik (nga 3 që duhet të jenë në fakt janë 4), 1 Saldator (nga 1 që duhet të jetë në fakt janë 2), 1 Sanitare, 1 Punëtorë Kolektori, 5 Manovratorë dhe Klorifikues (nga 26 që duhet të jenë në fakt janë 31), 1 Elektropompist (nga 23 që duhet të jenë në fakt janë 24).

Nga auditimi konstatohet që për muajin Gusht 2019 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

1. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 faturistë;
2. Nga Departamenti Teknik nuk ka pasur Drejtor Teknik, mungon 1 Elektropompist, 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe mungojnë 18 Punëtorë (Ujësjiellësi, Kanalizim, etj.).

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 Hidraulik, 1 Saldator, 1 punëtorë Kolektorësh, si dhe 4 Manovratorë dhe Klorifikues.

Për vitin 2020:

Struktura UK Kurbin është miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ Nr. 1, datë 24.01.2020 për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbin dhe ka në përbërje të saj 120 punonjës, nga të cilët:

- a) Administrata 7 (shtatë) punonjës;
- b) Departamenti Tregtar 24 (njëzetë e katër) punonjës;
- c) Departamenti Teknik 89 (tetëdhjetë e nëntë) punonjës.

Nga auditimi konstatohet që për muajin Prill 2020 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

1. Nga Administrata mungon Inxhinieri;
2. Nga Departamenti Tregtar mungon 1 Faturist;
3. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit, Përgjegjës Stacion Pompe Laç, 1 Hidraulik dhe 1 Elektropompist.

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 4 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 1 Manovrator Klorifikues.

Nga auditimi konstatohet që për muajin Dhjetor 2020 pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vihen re mangësi dhe devijime nga struktura si vijon;

1. Nga Administrata mungon Inxhinieri;
2. Nga Departamenti Tregtar mungon 1 Faturist;
3. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit, Përgjegjës Depo Uji Laç, Përgjegjës Stacion Pompe Laç, 1 Hidraulik dhe 1 Elektropompist.

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 3 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 2 Manovrator Klorifikues.

Për Janar 2021:

Struktura UK Kurbin është miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ Nr. 1, datë 05.02.2021 për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kurbin dhe ka në përbërje të saj 120 punonjës, nga të cilët:

- a) Administrata 5 (pesë) punonjës;
- b) Departamenti Tregtar 27 (njëzetë e shtatë) punonjës;
- c) Departamenti Teknik 88 (tetëdhjetë e tetë) punonjës.

Nga auditimi konstatohet që:

- 1. Nga Departamenti Tregtar mungojnë 4 Faturist;
- 2. Nga Departamenti Teknik mungon Drejtori i Departamentit.

Janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 2 Punëtorë (Ujësjiellës dhe Kanalizimi), 1 sanitare dhe 1 Manovrator Klorifikues.

Në lidhje me strukturën u auditua me zgjedhje zbatimi i strukturës për muajt:

- Mars dhe Shtator i vitit 2018;
- Shkurt dhe Gusht i vitit 2019.;
- Prill dhe Dhjetor i vitit 2020;
- Janar i vitit 2021.

Tabela për të dhënat e numrit të punonjësve për muajt e përzgjedhur

Emërtimi	Nr. punonjësish - Struktura UK Kurbin		Realizim
	Plan	Fakt	
Mars 2018	170	165	97%
Shtator 2018	170	164	96.5%
Shkurt 2019	170	167	98%
Gusht 2019	170	153	90%
Prill 2020	120	120	100%
Dhjetor 2020	120	120	100%
Janar 2021	120	120	100%

Burimi: UK Kurbin.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Nga auditimi në tërësi të listë-pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shumica e përgjithshme e listë-pagesave është e njëjtë me pagesat e kryera në bankat përkatëse e përgatitur për këtë qëllim.

Nga auditimi konstatohet që listë-pagesat dhe listë-prezencat e UK Kurbin për periudhën objekt auditimi merret gjithmonë si referencë 21 ditë pune në muaj, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore i ndryshuar, kreu I, neni pikat 1-3, ku sipas përllogaritjes çdo muaj ka 22 ditë pune dhe jo 21 ditë. Ky veprim nuk ka efekt financiar gjatë përllogaritjes së pagës mujore me përjashtim kur pagesa për një punonjës nuk bëhet për ditët e plota të muajit (p.sh. punonjësi merr raport mjekësor, fillon punë në një ditë të caktuar të muajit, etj.) dhe si pasojë përpjesëtimi i ditëve të punës nuk bëhet i saktë.

Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UK Kurbin, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, të Kodit të Punës.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 òPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit pasardhës në të cilin është kryer pagesa.

Është përllogaritur dhe ndalur kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar òPër disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë përcaktuar në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Mirëpo, për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 objekt auditimi janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë. Vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029. Me një total në vlerën 1.610.234 lekë e cila përbën efekt financiar negativ, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, dhe nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 òPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar.

Janë audituar muajt Mars dhe Shtator për vitin 2018, Shkurt dhe Gusht për vitin 2019, Prill dhe Dhjetor për vitin 2020 dhe Janar i vitit 2021, nga të cilat rezulton se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme mbi llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni nuk është penalizuar me gjoba apo interesa të paguara për pagesë të vonuar.

Realizimi i fondit të pagave (plan, fakt dhe në %) për vitet 2018-2020 dhe Janar-Qershor 2021.

Nga verifikimi i fondit të pagave për vitet 2018, 2019, 2020 dhe Janar-Qershor 2021 po paraqesim tabelën krahasuese e cila rezulton si më poshtë:

Tabela për të dhënat përmbledhëse për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitet 2018-2020 dhe Janar-Qershor 2021

në lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Janar-Qershor 2021
----	----------	-----------	-----------	-----------	--------------------

		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagave	43,880,287	40,136,641	91%	43,827,221	43,924,703	100%	35,800,255	33,106,755	92%	20,230,661	14,289,025	71%
2	Sig. Shoq.	13,514,626	14,062,156	104%	13,792,527	14,676,932	106%	10,946,436	11,234,047	103%	6,468,195	407,313	6%

Burimi: UK Kurbin.

Nga auditimi konstatohen se fondi i pagave të shpenzuar për vitin 2018 është 40.136.641 lekë pra me një realizim 91 % të fondit të planifikuar prej 43.880.287 lekë. Për vitin 2019 fakti është 43.924.703 lekë ose 100% e fondit të planifikuar prej 43.827.221 lekë. Për vitin 2020 fakti është 33.106.755 lekë ose 92% e fondit të planifikuar prej 35.800.255 lekë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2021 fakti është 14.289.025 lekë ose 71% e fondit të planifikuar prej 20.230.661 lekë. Ndërsa fondi i shpenzuar për sigurimet shoqërore për vitin 2018 është 14.062.156 lekë pra me një realizim 104%. Për vitin 2019 ky fond i shpenzuar për sigurimet shoqërore është 14.676.932 lekë me një realizim 106%. Për vitin 2020 ky fond i shpenzuar për sigurimet shoqërore është 11.234.047 lekë me një realizim 103%. Për 6-mujorin e parë të vitit 2021 ky fond i shpenzuar për sigurimet shoqërore është 407.313 lekë me një realizim 6%.

Vendimet Gjyqësore për marrëdhëniet e punës

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka patur 6 procese gjyqësore që kanë efekt për marrëdhëniet e punës. Në total detyrime në vlerën 1.601.527lekë nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 360.800lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitó, vlera prej 1.601.527 përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

Tabela e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar

në lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Vendimi i formës së prerë (numër dhe datë)	Vlera e përfituar nga punonjësi	Vlera e shpenzime përmbarimore dhe gjyqësore	Totali i likuiduar	Data e likuidimit
1	O. V.	Nr. 560-143, datë 03.04.2017	156,288	76,400	232,688	04.10.2019 04.11.2019 30.12.2019
2	A. J.	Nr. 447-107, datë 09.03.2017	156,288	51,400	207,688	30.12.2019
3	A. S.	Nr. 587-155, datë 06.04.2017	341,000	89,000	430,000	24.06.2019 11.07.2019
4	B. L.	Nr. 809, datë 23.05.2018	50,285	50,000	100,285	08.04.2019
5	Gj. I.	Nr. 585, datë 18.06.2019	493,966	44,000	537,966	-
6	P. LL.	Nr. 153, datë 05.03.2020	42,900	50,000	92,900	09.06.2020
TOTALI			1,240,727	360,800	1,601,527	

Burimi: UK Kurbin

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- z. A. P. , me detyrë Administrator;
z. G. M. , me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

4. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.

1. Titulli i gjetjes:	Shpenzime të kryera nëpërmjet arkës më tepër se limiti i vendosur
Situata:	Nga llogaria e arkës së Shoqërisë UK Kurbin janë kryer pagesa me para në dorë më tepër se 1,000 lekë. Respektivisht për periudhën e auditimit konstatohet shuma prej 53,363,362 lekë shpenzuar me arkë për vitin 2018 dhe shuma prej 6,054,102 lekë shpenzuar me arkë për vitin 2019, veprime këto të cilat nuk duhet të lejoheshin nga Drejtori Tregtar/Përgjegjës i Financës, i cili duhet të monitoronte dhe kontrollonte dokumentacionin e arkës në mënyrë periodike.
Kriteri:	Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publikó, pika 64, ku cilësohet: <i>“Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1,000 lekë”.</i>
Ndikimi:	Nuk ka ndikim.
Shkaku:	Mos njohja e legjislacionit.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtori Tregtar i shoqërisë të merren masa që në vazhdimësi të mos kryhen pagesa nëpërmjet arkës me para në dorë më tepër se limiti i lejuar.

2. Titulli i gjetjes:	Shpenzime për vendime të gjykatave për largime të punonjësve të shoqërisë pa shkaqe të arsyeshme.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit për periudhën objekt auditimi për punonjës të cilët janë larguar pa shkaqe të përligjura, duke detyruar punonjës të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur UKK në Gjykatë. Nga paditë e punonjësve kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë duke e detyruar UKK të paguajë shumën 5,292,924 lekë, për të cilat nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar edhe detyrimet përbarimore. Për veprime të tilla Uj•sjell•s Kanalizime SHA Kurbin ka dëmshpërblyer për periudhën objekt auditimi, konkretisht: 9 punonjës dhe zyrat përbarimore për vitin 2018 në shumën 2,990,097 lekë; 7 punonjës dhe zyrat përbarimore për vitin 2019 në shumën 2,027,527 lekë, 4 punonjës dhe zyrat përbarimore për vitin 2020 në shumën 225,300 lekë; 4 punonjës dhe zyrat përbarimore deri në 01.04.2021 në shumën 50,000 lekë.
Kriteri:	Kodit t• Punës dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, i ndryshuar, neni 8.
Ndikimi:	Veprimet e mësipërme kanë sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë në vlerën 5,292,924 lekë.
Shkaku:	Veprimet e administratorit në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga shoqëria të merren masa që në vazhdimësi, për marrëdhëniet me punonjës të shoqërisë të zbatohen kushtet e vendosura në kontratat individuale dhe kolektive, largimet të jenë për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara, duke zbatuar afatet kohore përkatëse të njoftimit, gjithashtu të merren në konsideratë shmangia e shpenzimeve për detyrimet përbarimore.

3. Titulli i gjetjes:	Shpenzime për automjetet dhe karburantin.
------------------------------	---

Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për karburantin e automjeteve të Ujësjellës Kanalizime Kurbin SH.A, rezultoi se ka në përdorim 4 automjete nga të cilat 1 automjet tip Mercedes Benz 250 TDI me targa TR 5.69 J është në pronësi të shitësit të automjetit F. I. H. prej datës 12.11.2014 dhe nuk janë bërë ndryshimet e pronësisë përkatëse. Për 4 automjetet në përdorim nga UKK sha nga Drejtoria Tregtare dhe Dega Teknike nuk janë mbajtur kartelat përkatëse për secilin automjet, ku të jenë të evidentuara qartësisht të dhënat teknike të mjeteve, shpenzimet e kryera periodike për mirëmbajtjen e tyre dhe kolaudimet, kilometrazhi sipas muajve dhe viteve mbi të cilin të bëhen dhe llogaritjet e orëve të punëve, sasisë e furnizimit me karburant si dhe programet e respektive të punës dhe itineraret përkatëse të përshkruara nga secili mjet. Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti UKK SHA rezultoi se nga Drejtoria Tregtare, Zyra e Financës dhe Dega Teknike nuk ka evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të çdo të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për zërin e karburantit. Nga dokumentacioni i daljeve të karburantit nga magazina e Shoqërisë rezultoi se: Për vitin 2018 janë përdorur 15,206 litra naftë me vlerë 2,587,257 lekë; Për vitin 2019 janë përdorur 16,063 litra naftë me vlerë 2,663,264 lekë; Për vitin 2020 janë përdorur 16,270 litra naftë me vlerë 2,116,947 lekë; për të cilat për grupin e auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion argumentues dhe justifikues si Urdhri e Administratorit për miratimin e programeve të punës, Programet individuale të punës në të cilat të përshkruhet itinerari i lëvizjeve të automjetit, motivacioni i lëvizjes. Mungonin të dhënat e kilometrazhit në fillim dhe në fund të aktivitetit, normativa e konsumit të automjeteve dhe konsumi specifik sipas itinerarit shoqëruar me nënshkrimet përkatëse të shoferit. Nga ana e administrimit të shoqërisë (Administratori, Drejtoria Tregtare) si dhe nga inxhinieri i Drejtorisë Teknike, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë. Këto veprime vlerësuar në konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues në sasinë e 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë janë veprime që kanë sjellë dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-10.
Ndikimi:	Veprimet e mësipërme kanë sjellë dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë në shumën 7,367,468 lekë për sasinë prej 47,539 litra dhe në shumën për mosverifikimin e kilometrave të përshkuar të automjeteve me sasinë e furnizuar me karburant.
Shkaku:	Keqmenaxhimi dhe mosnjohja e kuadrit ligjor mbi normativat dhe menaxhimin shpërndarjes së karburantit nga Administratori i UKK Kurbin SHA dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tij.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtori tregtar të merren masat që të rregullohet me urdher strukturat që menaxhon mbajtjen e karburantit, që në vijimësi të hartohen kartelat përkatëse të secilit automjet, të caktohen personat / komisioni përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve për automjetet, të kryhen kontrollet përkatëse periodike për monitorimin e shpenzimeve për

	karburantin, kontrollin teknik, riparimin e automjeteve dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës në vazhdimësi. Gjithashtu Administratori i UKK z. A. P. të ngrej komision për verifikimin e sasive reale të karburantit të shpenzuara nga sasia prej 47,539 litra, ekuivalente me vlerën 7,367,468 lekë për periudhën 2018-2020, shoqëruar me dokumentacion të plotë justifikues sipas legjislacionit cituar më sipër, për të cilin ofrohet bindje e arsyeshme mbi procedurën e rregullt të konsumit të tij.
--	---

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.266/6 datë 11.10.2021 óMbi Projektraportin e Auditimit nga z. A. P. , z.D. A. , z.G. M. , znj.J. E. dhe z.J. K. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ky konstatim nuk qendron, pasi për vitet 2018, 2019, 2020 ne si ndërmarrjes e ujësjellësit disponojmë dokumentacion argumentues dhe justifikues lidhur me shpenzimet e karburantit shpenzime që janë mbajtur nga Inxhinierja e Degës Teknike znj. J. E. me delegim kompetence nga Administratori i Shoqërisë me urdhërat respektive për secilin vit. Gjithashtu janë të hartuara planet mujore për shpenzime jo vetëm për karburantin, por për të gjithë aktivitetin mujor. Disponojmë faturë tatimore për çdo shpenzim dhe metoda e mbajtur për mënyrën e shpenzimeve të karburantit është e gjetur këtu ndër vite dhe kemi vazhduar duke punuar në këtë mënyrë në mungesë edhe të një kontrolli të mirëfilltë siç edhe u paraqitet ju pranë zyrave tona pra nuk jemi dakord që mungon dokumentacioni për këto shpenzime karburanti. bashkëngjitur këtij observimi do ju paraqesim provat tona. Sqarojmë se për vitin 2018 e në vazhdim ndërmarrja jonë ka hasur jo pak vështirësi në punën e përditshme duke u detyruar (jo për faj të saj) që të kryejmë shërbimeve me të gjitha metodat ligjore të mundshme si përdorimi i arkës për vitin 2018 dhe pjesërisht për vitin 2019. Kemi përmirësuar gjëndjen duke e hequr si veprim Arkën për vitin 2020 e në vazhdim, faktori kryesor argumentues për veprime me Arkë është mbyllja e plotë e llogarive tona bankare nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë që nga Shtatori i vitit 2014 e deri në 29.09.2017 ku jemi bllokuar 4 here nga ky Institucion për mos pagesë ndër vite të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim fitimi apo edhe disa gjoba që kapnin vlerës e mbi 9 milion lekëve duke na u kthyer në një problem social mos pagimi i sigurimeve dhe pagave të punonjësve theksoj se Bankat e Nivelit të Dytë na kan pas bllokuar 100% pra as paga as blerje as sigurime dhe ju informoj se në një hapje të sistemit të OT. Bank në ato vite rezultonte Ndërmarrja e Ujësjellësit me 1 miliard lekë detyrime tatimore ku në të vërtete kishim rreth 20 milion lekë. Me anë të ligjit nr. 33/2017 óPër pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fdhirjes/shuarjes së detyrimeve tatimoreó përfituam faljen e detyrimeve të gjobave pasi paguam principalin duke e kthyer ndërmarrjen në rrugën e duhur në zbatim të ligjit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pagesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, i ndryshuar, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-10.

Grupi i auditimit pasi shqyrtoj me vëmëndje evidencat e dërguara nga UKK mbi situatën e përshkruar me sipër, vuri re se një pjesë e evidencave të dërguara me observacion, nuk janë të dhëna shtesë referuar atyre që subjekti UKK ka vendosur në dispozicion gjatë fazës së terrenit. Për këto evidenca grupi ka mbajtur edhe qëndrimin si në situatën mësipër. UKKka paraqitur dokumentacionin si mëposhtë:

- Planet e punës për vitet 2018-2020, të cilat nuk janë të protokolluara brenda institucionit. Përmbajtja e tyre është plan pune i përgjithshëm për realizimin e së cilave nuk argumentohet nëse ndjehete nevojës përdorimi i mjeteve logjistike dhe i automjeteve.

- Urdhër nr.3, datë 18.01.2018, Urdhër nr.2, datë 06.01.2019 dhe Urdhër nr.4, datë 11.01.2020 óPër delegim kompetence degës teknike për mënyrën e shpërndarjes së karburantit, në të cilat citojnë 3 mjete dhe 1 gjenerator, ku 1 nga mjetet tip Mercedes Benz 250TDI me targa TR 53.9 J nuk është në pronësi të Ujësjiellësit Kurbin dhe mjeti tjetër Range Rover AA0.5RM në pronësi të Bashkisë Kurbin, dokumentacioni procedural i njohjes së mjetit, kontrollit dhe përdorimit të tij për nevoja të UKK nuk është i saktë.

- Urdhër i Brendshëm nr.95 me nr.prot 528 datë 17.12.2018 óPër ngritjen e komisionit për të saktësuar normativën e harxhimit të karburantit të mjetit tip Eskavator Kamatsu shoqëruar me procesverbal.

- Urdhër i Brendshëm nr.95 me nr.prot 529 datë 17.12.2018 óPër ngritjen e komisionit për të saktësuar normativën e harxhimit të karburantit të mjetit tip Benz 250, shoqëruar me procesverbal, ku prova primitive që anëtarët e komisionit kanë kryer për saktësimin e normativës së harxhimit të karburantit nuk tregojnë as itinerar dhe as kilometrazh.

- Kartelat e harxhimit të karburantit të automjeteve, të cilat janë të nënshkruara vetëm nga Dega Teknike Ing. J. E. , në mungesë të nënshkrimit të shoferit të mjetit për secilën datë që është përdorur automjeti. Këto kartela janë jo të plota për nga mungesa e shënimit të kilometrazhit përpara çdo fillim shërbimi si dhe sasia e kilometrazhit në fund të shërbimit.

Dokumentacioni i cili shoqëron observacionet në tërësinë e vetë nuk përmbanë elementët e vërtetueshmërisë së të dhënave dhe faktimi i tyre mbi sasinë reale të konsumimit për periudhën objekt auditimi. Duke evidentuar kushtet e vështira financiare të UKK si dhe materialet e dorrëzuara, grupi i auditimit e ka marrë pjesërisht në konsideratë observacionin, duke kërkuar prej UKK verifikimin real të sasive të karburantit të shpenzuara si dhe me dokumentacion të plotë justifikues sipas legjislacionit cituar më sipër, për të cilin ofrohet bindje e arsyeshme mbi procedurën e rregullt tëkonsumit të karburantit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

- Për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime nëpërmjet arkës (llog.531) më tepër se limiti i vendosur

Situata: Nga llogaria e arkës së Shoqërisë UK Kurbin janë kryer pagesa me para në dorë më tepër se 1,000 lekë. Respektivisht për periudhën e auditimit konstatohet shuma prej 53,363,362 lekë shpenzuar me arkë për vitin 2018 dhe shuma prej 6,054,102 lekë shpenzuar me arkë për vitin 2019, veprime këto të cilat nuk duhet të lejoheshin nga Drejtori Tregtar/Përgjegjës i Financës, i cili duhet të monitoronte dhe kontrollonte dokumentacionin e arkës në mënyrë periodike. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik, pika 64, ku cilësohet:

“Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1,000 lekë”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori Tregtar z. D. A. dhe Përgjegjësi i Financës G. M.

-Për periudhën objekt auditimi u shqyrtuan transaksionet e shpenzimeve të përzgjedhura nga grupi i auditimit, të kryera nëpërmjet bankës dhe u pa se shpenzimet shoqëroheshin me dokumentacion justifikues, vërtetues dhe dokumentacion i cili vërteton kryerjen e shpenzimit, vendin dhe mënyrën e kryerjes së shërbimit.

-Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit për periudhën objekt auditimi për punonjës të cilët janë larguar pa shkaqe të përligjura, duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur UKK në Gjykatë. Nga paditë e punonjësve kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë duke e detyruar UKK të paguajë shumën 5,292,924 lekë, për të cilat nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar edhe detyrimet përmbartimore. Për veprime të tilla Ujësjetës Kanalizime SHA Kurbin ka dëmshpërblyer për periudhën objekt auditimi, konkretisht:

9 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2018 në shumën 2,990,097 lekë;

7 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2019 në shumën 2,027,527 lekë,

4 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2020 në shumën 225,300 lekë;

4 punonjës dhe zyrat përmbartimore deri në 01.04.2021 në shumën 50,000 lekë

Viti	Pagesa përmbartimi dhe largim punonjësish		
	Arka	Banka	Total
2018	2,009,777	980,320	2,990,097
2019	441,185	1,586,342	2,027,527
2020	-	225,300	225,300
01.04.2021	-	50,000	50,000
Total	2,450,962	2,841,962	5,292,924

Burimi: Ujësjetës Kanalizime SHA Kurbin

Këto veprime bien në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 8, duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë në vlerën 5,292,924 lekë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z.A. P. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë UK Kurbin sh.a.

- Për periudhën objekt auditimi shpenzimet për subvencione janë kryer sipas destinacionit të përcaktuar.

Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për subvencionet rezultoi se:

Për vitin 2018 janë akorduar 2 fonde subvencionesh në vlerë totale prej 24,514.140 lekë konkretisht:

Me shkresën nr. 3130 prot, datë 06.11.2018 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Monitorimit të Shoqërive Ujësjetës Kanalizime, është akorduar subvencioni në shumën 20,000,000 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të

përballuar ôkostot neto si paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, faturat e energjisë elektrike materialet e konsumara dhe kimikatet.

Me shkresën nr. 3561 prot, datë 20.12.2018 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Monitorimit të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime, është akorduar subvencioni në shumën 4,514,140 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të likujduar faturat e energjisë elektrike.

Për vitin 2019 është akorduar 1 fonde subvencionesh në vlerë totale prej 24,191.000 lekë konkretisht:

Me shkresën nr. 3121/6 prot, datë 21.10.2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Koordinimit Statistikës dhe Informacionit, është akorduar subvencioni në shumën 24,191,000 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të përballuar, faturat e energjisë elektrike dhe blerje klori. Nga të cilat vetëm 9,171,711 lekë janë përdorur për shlyerje të faturave të energjisë elektrike, kurse shuma prej 15,019,289 lekë nuk është përdorur sipas destinacionit të përcaktuar, detajuar në 8,933,910 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe 6,085,379 lekë për paga të personelit, në mbështetje të VKB Kurbin nr.27, datë 22.11.2019 Për ndryshim destinacioni të përdorimit të subvencionit të akorduar për vitin 2019 për SH.A Ujësjetllës Kanalizime Kurbin.

Për vitin 2020 është akorduar 3 fonde subvencionesh në vlerë totale prej 16,448,174 lekë konkretisht:

Me shkresën nr. 3413 prot, datë 30.12.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Koordinimit Statistikës dhe Informacionit, është akorduar subvencioni në shumën 5,224,087 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të përballuar, shlyerjet e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën 5,201,986 lekë dhe 22,101 lekë për shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj DPT.

Me shkresën nr. 2244 prot, datë 02.09.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Koordinimit Statistikës dhe Informacionit, është akorduar subvencioni në shumën 5,224,087 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të përballuar, shlyerjet e faturave të energjisë elektrike.

Me shkresën nr. 2245 prot, datë 02.09.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizime, Drejtorisë së Monitorimit, Sektori i Koordinimit Statistikës dhe Informacionit, është akorduar subvencioni në shumën 6,000,000 lekë, ku në përmbajtje të kësaj shkrese përcaktohet destinacioni i këtij fondi i cili duhet të përdoret për të përballuar, problemet e shkaktuara nda pandemia covid ñ 19.

Si e tillë u vu re se gjatë shqyrtimit të transaksioneve të subvencioneve, UK Kurbin sha gjatë ekzekutimit të shpenzimeve nuk ka ndryshuar destinacionin e subvencionit të akorduar.

-Mbi shpenzimin e pa justifikuar të karburantit për automjetet

Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për karburantin e automjeteve të Ujësjetllës Kanalizime Kurbin SH.A, rezultoi se ka në përdorim 4 automjete nga të cilat 1 automjet tip Mercedes Benz 250TDI me targa TR 53.9 J është në pronësi të shitësit të automjetit Ferdinand Ilir hoxhallari prej datës 12.11.2014 dhe nuk janë bërë ndryshimet e pronësisë përkatëse. Për 4 automjetet në përdorim nga UKK sha nga Drejtoria Tregtare dhe Dega Teknike nuk janë mbajtur kartelat përkatëse për secilin automjet, ku të jenë të evidentuara qartësisht të

dhënat teknike të mjeteve, shpenzimet e kryera periodike për mirëmbajtjen e tyre dhe kolaudimet, kilometrazhi sipas muajve dhe viteve mbi të cilin të bëhen dhe llogaritjet e orëve të punëve, sasi të e furnizimin me karburant si dhe programet e respektive të punës dhe itineraret përkatëse të përshkruara nga secili mjet.

Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti UKK SHA rezultoi se nga Drejtoria Tregtare, Zyra e Financës dhe Dega Teknike nuk ka evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të çdo të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për zërin e karburantit. Nga dokumentacioni i daljeve të karburantit nga magazina e Shoqërisë rezultoi se:

Për vitin 2018 janë përdorur 15,206 litra naftë me vlerë 2,587,257 lekë;

Për vitin 2019 janë përdorur 16,063 litra naftë me vlerë 2,663,264 lekë;

Për vitin 2020 janë përdorur 16,270 litra naftë me vlerë 2,116,947 lekë;

për të cilat për grupin e auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion argumentues dhe justifikues si Urdhri e Administratorit për miratimin e programeve të punës, Programet individuale të punës në të cilat të përshkruhet itinerari i lëvizjeve të automjetit, motivacioni i lëvizjes. Mungonin të dhënat e kilometrazhit në fillim dhe në fund të aktivitetit, normativa e konsumit të automjeteve dhe konsumi specifik sipas itinerarit shoqëruar me nënshkrimet përkatëse të shoferit. Nga ana e administrimit të shoqërisë (Administratori, Drejtoria Tregtare) si dhe nga inxhinieri i Drejtorisë Teknike, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë. Këto veprime vlerësuar në konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues në sasinë e 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë janë veprime që kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E^{-të} për buxhetin e shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-10.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Kurbin SH.A z.A. P. , Drejtori Tregtar z. D. A. , Përgjegjësi i Financës z.G. M. , Inxhinieri i Degës Teknike znj. J. E. dhe Përgjegjësi i sasise respektive z. J. K. .

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 7 datë 16/07/2021 dhe për këtë çështje subjekti nuk ka paraqitur observacion.

-Lidhur me auditimin e procedurave të prokurimit "Blerje të Vogla", për vitin 2019-2020 sipas regjistrit të realizimit të tyre, vënë në dispozicion nga UKK ka rezultuar si vijon:

UKK ka realizuar 111 procedura për vitin 2019 dhe 61 për vitin 2020, nga ku është konstatuar se për disa procedura objekti i prokurimit është i njëjtë, apo i të njëjtës natyrë (sipas anekseve bashkëlidhur).

Kështu për vitin 2019 rezulton se objekti i prokurimit është i njëjtë apo i ngjashëm për 26 raste/lloje, për vlerën prej 8,964,000 lekë, nga ku mund të përmendim procedurat për óBlerje naftë për nevojat e UKKô, ku në total vlera e prokuruar shkon 2,100,000 lekë; óRiparim dhe avolzhim pompe sektori Milotô, ku në total vlerë e prokuruar shkon 810,000 lekë; óRehabilitimi i puseve dhe stacionit të pompimit të ujësjetllës Laçô, ku në total vlerë e prokuruar shkon 750,000 lekë; etj, procedura të cilat UKK duhet ti kishte parashikuar dhe prokuruar që në fillim të vitit.

E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin 2020 nga ku rezulton se objekti i prokurimit është i njëjtë apo i ngjashëm për 11 raste/lloje, për vlerën prej 3,256,500 lekë, nga ku mund të përmendim

procedurat për zërin óBlerje materiale Hidraulikeô, ku në total vlerë e prokuruar shkon 1,391,000 lekë etj, procedura të cilat UKK duhet ti kishte parashikuar dhe prokuruar që në fillim të vitit.

Bazuar në nenin 8 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô i ndryshuar, asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP.

Bazuar në nenin 9 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô i ndryshuar, Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje të siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.

Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.

Bazuar në nenin 57 pika 3 dhe 4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô i ndryshuar, Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme Përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme, Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/janë detyrat e mëposhtme:

- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.²

Procedurat e zhvilluara janë të lidhura me njëra tjetrën, ndaj rezulton që është pjestuar fondi për shmangien e procedurës së prokurimit, veprime të cilat ngarkojnë me NJHDT e përbërë nga B. N. , J. E. dhe G. M. si dhe titullari i AK, A. P. , në cilësinë e miratuesit të tyre.

-Nga auditimi u konstatua edhe dy raste nga ku rezulton se nga UKK është prokuruar procedura óAnëtarësim në SHU.ô, për vlerën prej 150,000 lekë ose total për të dy vitet 300,000 lekë. Për këto procedura, duke qenë se objekti i tyre nuk është ofrimi i një shërbimi konkret, por pagesë tarife vjetore anëtarësimi në Shoqatën Ujësjiellës Kanalizime Albania, nuk duhej prokuruar por paguar në mënyrë të drejtpërdrejtë si detyrim i çdo anëtari në shoqatë (kuotë anëtarësimi).

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 9 datë 16/07/2021 dhe për këtë çështje subjekti nuk ka paraqitur observacion.

² Ky paragraf është shtuar me Vendimin Nr. 797, datë 29.12.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, ópër miratimin e rregullave të prokurimit publikô, të ndryshuar.

5. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit).

1. Titulli i gjetjes:	Mos përdorimi i sistemeve IT në raportimin financiar.
Situata:	Nga auditimi rezulton se të gjitha ngjarjet dhe veprimet ekonomike, regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj.
Kriteri:	Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, i ndryshuar.
Ndikimi:	Risk në parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga struktura përgjegjëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Në mënyrë që të ruhet dhe garantohet siguria e informacioneve të saj, UK Kurbin të marrë masa për përdorimin e programeve financiare në mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabël.

2. Titulli i gjetjes:	Mangësi në dokumentacionin shoqërues të pasqyrave financiare.
Situata:	Në hartimin e pasqyrave financiare nuk përfshihet òFormati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagaveò, duke mos paraqitur zyrtarisht informacionet mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave si numri mesatar i punonjësve, ndryshimin e këtij numri gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblimet e tjera, ndihmat shoqërore, kontributet për sigurimet dhe tatimet mbi të ardhurat personale.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018, òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi:	Mungesa e të dhënave statistikore që gjenerohen nga kjo pasqyrë.
Shkaku:	Mos plotësimi i të gjithë elementëve të pasqyrave financiare
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Spektori i financave të marrë masa që në vijimësi pasqyrat financiare të hartohen në mënyrë të plotë, duke pasqyruar informacion mbi çdo element të aktivitetit të shoqërisë siç kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi.

3. Titulli i gjetjes:	Përfshirja e magazinierit në procesin e inventarizimit.
Situata:	Përgjatë të gjithë periudhës objekt auditimi rezulton se në grupet e punës të ngritura për inventarin e magazinës dhe aseteve të shoqërisë në fund të vitit, është pjesë edhe magazinieri i shoqërisë.
Kriteri:	Paragrafi 99 i Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në NjSPò, i ndryshuar.
Ndikimi:	Mundësi për konflikt interesi.
Shkaku:	Mos zbatimi i përcaktimeve ligjore.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Administratori i UK të marrë masa që në të ardhmen të mos përfshijë në grupin e punës për procesin inventarizues edhe magazinierin e shoqërisë, i cili ka në

	ngarkim mallrat.
--	------------------

4. Titulli i gjetjes:	Mos pasqyrimi i saktë i zërave në pasqyrat financiare.
Situata:	Për të tre vitet objekt auditimi, nuk janë pasqyruar saktë vlerat sa i takon klientëve debitorë nga furnizimi me ujë dhe të ardhurat e arkëtuara si vijon: <u>Për vitin 2018</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 135.351.480 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etj paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. <u>Për vitin 2019</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 142.247.887 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etj paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. <u>Për vitin 2020</u> Zëri otë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 149.428.475 lekë, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etj paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 192.779.329 lekë. UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 40.445.970 lekë.
Kriteri:	Pika 2.1 eUdhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó.
Ndikimi:	Mos paraqitja me vërtetësi e situatës fianciare të shoqërisë.
Shkaku:	Mos rakordimi me të dhënat nga evidencat.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Sektori i financës të marrë masa që në të ardhmen të rakordojë dhe pasqyrojë me vërtetësi dhe saktësi vlerat sipas të dhënave të gjënuara nga sektorët dhe regjistrimet përkatëse.

5. Titulli i gjetjes:	Mos pasqyrimi i vlerës së tokës në pasqyrat e aktiveve.
Situata:	Për vitin 2018, në zërin óToka dhe ndërtesaó në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi Shoqëria nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, Shoqëria ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuaret, nga të cilat në

	ZVRPP përkatëse kanë rrezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UK Kurbin, por deri në momentin e auditimit nuk është finalizuar ende ky proces.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësité e qeverisjes së përgjithshmeó.
Ndikimi:	Mos paraqitja e situatës reale në lidhje me aktivet në pronësi të shoqërisë.
Shkaku:	Mos finalizimi i procesit të regjistrimit të pronësisë nga ZVRPP.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Administratori dhe Këshilli i Administrimit të shoqërisë të marrin masa për nxitjen e përsheptimit të procesit të regjistrimit të pronave të UK Kurbin. Për këtë qëllim të kërkohet edhe angazhimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë, Bashkisë Kurbin.

6. Titulli i gjetjes:	Mos klasifikimi i duhur i detyrimeve.
Situata:	Në zërin detyrime afatshkurtra, ndër të tjera UK Kurbin pasqyron edhe detyrimet e prapambetura që ka akumuluar nga mos likuidimi i energjisë elektrike që nga viti 2015, të cilat me përjashtim të atyre të periudhës ushtrimore duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata.
Kriteri:	SNK 1, paragrafi 69.
Ndikimi:	Mos paraqitja e situatës reale të detyrimeve të shoqërisë.
Shkaku:	Mos klasifikimi i duhur i detyrimeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Në hartimin e pasqyrave financiare, sektori i financës të marrë masa për sistemimin e llogarive të detyrimeve sipas periudhave të akumulimit të tyre dhe pasqyrimin e saktë të këtyre zërave në të ardhmen.

7. Titulli i gjetjes:	Mos analizimi i llogarive debitore-kreditore.
Situata:	Nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk është kryer asnjëherë analizë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me llogarivtë debitore-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. Shoqëria nuk ka marrë masa as për analizimin dhe veçimin e vlerave të debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe zgjidhjen e kësaj situatë. Në fund të vitit 2019, shoqëria nuk ka marrë masa për likuidimin e një pjese të detyrimeve edhe pse ka patur gjendje monetare në vlerën 7.277.546 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, óPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtareó, i ndryshuar. Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, i ndryshuar, neni 8 dhe 9.
Ndikimi:	Rëndimi i situatës financiare të shoqërisë.
Shkaku:	Neglizhencë në marrjen e masave për analizimin e llogarive debitore-kreditore.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë të merret në analizë në mënyrë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitore dhe kreditore, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kritereve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarrim për arkëtim të detyrueshëm.

8. Titulli i gjetjes:	Mos kryerja e inventarizimit.
------------------------------	-------------------------------

Situata:	Për vitin 2020 Administratori nuk ka marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe kryerjen e këtij procesi për aktivet e shoqërisë.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó
Ndikimi:	Mos azhurnim i situatës së aktive dhe mos paraqitja me vërtetësi në raportimin financiar.
Shkaku:	Mos kryerja e inventarizimit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit për çdo vit për të gjitha aktivet që ka dispozicion duke krijuar komisionet përkatës për kryerjen e këtij procesi.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit nr. 539/1, datë 20.05.2021, u shqyrtua legjislacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr. 25/2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó;
- **Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;**
- Udhëzimi nr. 14 datë 28.12.2006 óPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huajó, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó;
- Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2011, óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó;
- Pasqyrat financiare për vitet 2018 ñ 2020 dhe dokumentacioni shoqërues;
- Inventarët.

Viti 2018:

Pasqyrat financiare janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe miratuar nga Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 1, datë 26.03.2019, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor. Nga auditimi rezulton se të gjitha ngjarjet dhe veprimet ekonomike, regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj, në kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 óPër dokumentin elektronikó, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se për vitin 2018 nuk është hartuar óFormati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagaveó, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó. Me urdhrin nr. 94, datë 17.12.2018 është ngritur grupi i punës për inventarizimin e magazinës së UK Kurbin, në përbërje të të cilit është edhe përgjegjësi i magazinës, në kundërshtim me paragrafin 99 të Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në NjSPó, i ndryshuar.

Pozicioni financiar i UK Kurbin për vitin 2018 paraqitet si vijon:

Pasqyra e aktiveve:

Aktive afatshkurtra total	192.869.363
- Aktive monetare	316.543
- Të drejta të arkëtueshme	190.558.232
- Inventarët	1.994.588
Aktivitet afatgjata total	566.968.608
- Toka dhe ndërtesa	27.240.574
- Impiante dhe makineri	536.621.111
- Të tjera instalime dhe pajisje	1.306.923
- Parapagime për aktive materiale dhe në proces	1.800.000
Aktivitet total	759.837.971

Nga auditimi rezultoi se llogaria e Të drejta të arkëtueshme në bilanc në vlerën totale 190.558.232 lekë, përbëhet nga të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) në vlerën 135.351.480 lekë dhe TVSh e zbritshme+të tjera në vlerën 55.206.752 lekë, vlera të cilat po të ishin marrë masa konkrete për arkëtimin e tyre, do arrihej të mbulohej një pjesë e vlerës së detyrimeve. Nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidenca përmbledhëse e llogarisë e Klientë debitor, familjar, privat, etj paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë. Për këto diferenca nuk gjendet dokumentacion apo shënime shpjeguese se nga rezultojnë.

Në aktivet afatgjata është pasqyruar në zërin e parapagime për aktive materiale dhe në proces vlera prej 1.800.000 lekë, e cila në të vërtetë është vlera e inventarit për harta dhe projekte të zonës së Kurbin. Ndërkohë në zërin e Toka dhe ndërtesa në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi Shoqëria nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, Shoqëria ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuarët, nga të cilat në ZVRPP përkatëse kanë rrezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UK Kurbin, por deri në momentin e auditimit nuk është finalizuar ende ky proces.

Pasqyra e detyrimeve:

Detyrimet afatshkurtra total	371.341.216
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	276.603.886
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	4.294.624
- Të pagueshme të tjera	784.311
- Provizione	89.658.395
Detyrimet afatgjata total	0
Kapitali total	388.496.755

Në zërin detyrime afatshkurtra në vlerën totale prej 371.341.216 lekë, ndër të tjera UK Kurbin ka akumuluar detyrime të prapambetura kryesisht nga mos likuidimi i energjisë elektrike që nga viti 2015, i cili në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 267.326.933 lekë. Nga auditimi rezulton se këto detyrime të akumuluar që nga viti 2015, duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata, në kundërshtim me SNK 1, paragrafi 69. Po kështu, si pasojë e gjendjes së vështirë financiare, UK Kurbin në mbyllje të periudhës ushtrimore ka krijuar detyrime edhe për zërin paga dhe sigurime, konkretisht në vlerën 3.141.225 lekë për paga dhe në vlerën 1.153.399 lekë

për sigurime. Për këto të fundit, si pasojë e vonësive në shlyerjen e tyre, janë gjeneruar edhe gjopa në vlerën 393.660 lekë.

Nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk është kryer asnjëherë analizë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me llogaritë debitore-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera.

Për vitin 2018, UK Kurbin ka pësuar një rritje të kapitalit si pasojë e bashkimit me KUZ Laç, nga ku është emetuar kapitali i nënshkruar në vlerën 414.000.000 lekë duke rezultuar në total në fund të vitit, në vlerën 595.000.000 lekë.

Pasqyra e performancës:

- Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	44.588.799
- Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	36.566.097
Të ardhura total	81.154.896
- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	1.393.250
- Shpenzime të personelit	56.581.327
- Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10.652.347
- Shpenzime të tjera shfrytëzimi	82.703.597
Shpenzime total	151.330.521
Fitimi/humbja para tatimit	-70.176.617

Sa i takon pasqyrës së performancës, UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Po kështu, UK Kurbin është subvencionuar nga shteti në vlerën 36.566.097 lekë, pjesa më e madhe e të cilit shkon për likuidimin e energjisë elektrike.

Ndërkohë shpenzimet në total janë pasqyruar në vlerën 151.330.521 lekë, ku në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi, përsëri rreth 75% të vlerës e zenë shpenzimet për energji elektrike për funksionimin e sistemit të pompave të ujësllësit. Në fund të periudhës, shoqëria rezulton me një performancë negative financiare në vlerën 70.176.617 lekë.

Për vitin 2019:

Pasqyrat financiare janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe miratuar nga Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 1, datë 27.03.2020, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se edhe për vitin 2019 nuk është hartuar formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Me urdhrin nr. 121, datë 26.12.2019 është ngritur grupi i punës për inventarizimin, në përbërje të të cilit përsëri është edhe përgjegjësi i magazinës, në kundërshtim me paragrafin 99 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në NjSP, i ndryshuar.

Pozicioni financiar i UK Kurbin për vitin 2019 paraqitet si vijon:

Pasqyra e aktiveve:

Aktive afatshkurtra total	205.370.032
- Aktive monetare	380.795
- Të drejta të arkëtueshme	203.034.469

- Inventarët	1.954.768
Aktivet afatgjata total	548.684.050
- Toka dhe ndërtesa	25.878.545
- Impiante dhe makineri	519.746.464
- Të tjera instalime dhe pajisje	1.259.041
- Parapagime për aktive materiale dhe në proces	1.800.000
Aktivet total	754.054.082

Nga auditimi rezultoi se llogaria óTë drejta të arkëtueshme në bilanc në vlerën totale 203.034.469 lekë, përbëhet nga të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) në vlerën 142.247.887 lekë dhe TVSh e zbritshme+të tjera në vlerën 60.786.582 lekë, vlera të cilat po të ishin marrë masa konkrete për arkëtimin e tyre, do arrihej të mbulohej një pjesë e vlerës së detyrimeve. Nga auditimi rezulton se ky zë është rënduar kryesisht nga mos vjelja e detyrimeve nga debitorët për furnizim me ujë, pasi llogaria debitorë të tjerë nuk ka pësuar ndryshime për këtë vit. Nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se në evidenca përmbledhëse e llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjô paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë. Për këto diferenca nuk gjendet dokumentacion apo shënime shpjeguese se nga rezultojnë.

Në aktivet afatgjata është pasqyruar në zërin óparapagime për aktive materiale dhe në procesô vlera prej 1.800.000 lekë, e cila në të vërtetë është vlera e inventarit për harta dhe projekte të zonës së Kurbin.

Pasqyra e detyrimeve:

Detyrimet afatshkurtra total	436.508.393
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	343.632.948
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	2.431.239
- Të pagueshme të tjera	785.811
- Provizione	89.658.395
Detyrimet afatgjata total	0
Kapitali total	317.545.689

Në zërin detyrime afatshkurtra në vlerën totale prej 436.508.393 lekë, ndër të tjera UK Kurbin ka shtuar përsëri detyrime të prapambetura kryesisht nga mos likuidimi i energjisë elektrike që, i cili në fund të vitit 2019 rezulton në vlerën 334.704.289 lekë. Përsëri edhe për këtë vit, këto detyrime të akumuluar që nga viti 2015, duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata. Për këtë vit vihet re një ulje e detyrimeve në zërin paga dhe sigurime, të cilat pasqyrohen konkretisht në vlerën 1.568.500 lekë për paga dhe në vlerën 862.739 lekë për sigurime.

Për këtë vit, ka një ulje të detyrimeve ndaj punonjësve, por një rritje të detyrimeve ndaj të tretëve.

Pasqyra e performancës:

- Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	42.396.568
- Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	36.499.676
Të ardhura total	78.896.247
- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	561.900
- Shpenzime të personelit	56.749.748
- Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18.330.308
- Shpenzime të tjera shfrytëzimi	74.205.370
Shpenzime total	149.847.326
Fitim/humbja para tatimit	-70.951.066

Sa i takon pasqyrës së performancës, UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimit për periudhën rezultoi se vlera e të ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Po kështu, UK Kurbin është subvencionuar nga shteti në vlerën 36.499.676 lekë, pjesa më e madhe e të cilit shkon për likuidimin e energjisë elektrike.

Ndërkohë shpenzimet në total janë pasqyruar në vlerën 149.847.326 lekë, ku në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi, përsëri rreth 75% të vlerës e zenë shpenzimet për energji elektrike për funksionimin e sistemit të pompave të ujësllësit. Në fund të periudhës, shoqëria rezultoi me një performancë negative financiare në vlerën 70.951.066 lekë.

Për këtë vit, shoqëria ka mbyllur vitin ushtrimor me gjendje cash në Bankë në vlerën 7.277.546 lekë, të cilat nuk ka marrë masa për ti përdorur në funksion të shlyerjes së detyrimeve të shumta.

Për vitin 2020:

Pasqyrat financiare janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe miratuar nga Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 1, datë 30.03.2020, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se edhe për vitin 2020 nuk është hartuar óFormati 8- Pasqyra e numrit të punonj•sve dhe fondi i pagaveô, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeô. Për këtë vit konstatohet se Administratori nuk ka marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe kryerjen e këtij procesi, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në NjSPô, i ndryshuar.

Pozicioni financiar i UK Kurbin për vitin 2020 paraqitet si vijon:

Pasqyra e aktiveve:

Aktive afatshkurtra total	248.307.797
- Aktive monetare	7.277.546
- Të drejta të arkëtueshme	239.135.324
- Inventarët	1.894.927
Aktivët afatgjata total	640.847.959
- Toka dhe ndërtesa	24.584.618
- Impiante dhe makineri	492.032.513
- Të tjera instalime dhe pajisje	1.007.233
- Aktive materiale afatgjata në proces	123.223.595
Aktivët total	889.155.756

Nga auditimi rezultoi se llogaria óTë drejta të arkëtueshmeô në bilanc në vlerën totale 239.135.324 lekë, përbëhet nga të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) në vlerën 149.428.475 lekë dhe TVSh e zbritshme+ të tjera në vlerën 89.706.849 lekë, vlera të cilat po të ishin marrë masa konkrete për arkëtimin e tyre, do arrihej të mbulohej një pjesë e vlerës së detyrimeve. Nga auditimi rezultoi se ky zë është rënduar kryesisht nga mos vjelja e detyrimeve nga debitorët për furnizim me ujë, pasi llogaria debitorë të tjerë nuk ka pësuar ndryshime për këtë vit, me përjashtim të shtimit të vlerës së TVSh-së së zbritshme. Nga verifikimi i dokumentacionit në dispozicion rezultoi se evidenca përmbledhëse e llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjô paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit,

është në vlerën 192.779.329 lekë. Për këto diferenca nuk gjendet dokumentacion apo shënime shpjeguese se nga rezultojnë.

Në aktivet afatgjata është pasqyruar në zërin óAktive materiale në procesô vlere prej 123.223.595 lekë, të cilat përfaqësojnë vlerën 1.800.000 lekë të inventarit për harta dhe projekte të zonës së Kurbin, me shtesa gjatë vitit në vlerën 3.491.020 lekë, si dhe vlerën e projektit që po zbatohet për ujësjellësin e ri të Kurbin prej 117.932.575 lekë.

Pasqyra e detyrimeve:

Detyrimet afatshkurtra total	506.256.141
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	411.096.545
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	4.965.556
- Të pagueshme të tjera	535.645
- Provizione	89.658.395
Detyrimet afatgjata total	106.132.628
Kapitali total	276.766.987

Në zërin detyrime afatshkurtra në vlerën totale prej 506.256.141 lekë, ndër të tjera UK Kurbin ka shtuar përsëri detyrime të prapambetura kryesisht nga mos likuidimi i energjisë elektrike, i cili në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën 395.876.389 lekë. Përsëri edhe për këtë vit, këto detyrime të akumuluar që nga viti 2015, duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata. Për këtë vit vihet re një rritje si e detyrimeve në zërin paga dhe sigurime, ashtu edhe në detyrimet nga aktiviteti i shfrytëzimit. Megjithatë për këtë vit, sektori i financës ka marrë masa për identifikimin dhe evidentimin e qartë të tyre. Për këtë vit, shoqëria ka përfshirë në zërin detyrime afatgjata, vlerën e detyrimeve që burojnë nga vijimi i dy projekteve të UK Kurbin të parashikuar për tu kryer në 36 muaj.

Pasqyra e performancës:

- Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	38.809.129
- Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	60.186.595
Të ardhura total	98.995.724
- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	817.841
- Shpenzime të personelit	45.785.558
- Shpenzime konsumi dhe amortizimi	29.259.686
- Shpenzime të tjera shfrytëzimi	63.911.433
Shpenzime total	139.774.518
Fitimi/humbja para tatimit	-40.778.702

Sa i takon pasqyrës së performancës, UK Kurbin ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëttimeve për periudhën rezulton se vlere e të ardhurave është 40.445.970 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Po kështu, UK Kurbin është subvencionuar nga shteti në vlerën 20.344.099 lekë dhe pjesa tjetër e zërit otë ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimitô përbëhet nga grante për investimin që po kryhet në vlerën 39.568.996 lekë.

Ndërkohë shpenzimet në total janë pasqyruar në vlerën 139.774.518 lekë, ku në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi, përsëri rreth 75% të vlerës e zenë shpenzimet për energji elektrike për funksionimin e sistemit të pompave të ujësjellësit. Në fund të periudhës, shoqëria rezulton me një performancë negative financiare në vlerën -40.778.702 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. A. P. , me detyrë Administrator;

z. G. M. , me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

6. Evidentimi, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të realizuara nga shitja e ujit dhe nga shërbimet e tjera.

1. Titulli i gjetjes:	Nga óUjësjiellës Kanalizime Kurbinô SH.A nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Ujit.
Situata:	Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësjiellës Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori. Këshilli Mbikëqyrës, pasi e miraton këtë rregullore, me kërkesën e administratorit të shoqërisë, ia dërgon atë për miratim në emër të Këshillit Mbikëqyrës dhe vetë administratorit, Asamblesë së Aksionareve të UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonës së shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë.
Kriteri:	Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 óPër miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës-

	kanalizimeve SH.A."
Ndikimi:	Nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonës së shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë. Shkaku: Mungesa e Rregullores së Ujit si pasojë e moszbatimit të Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për periudhën 2018-2021.
Shkaku:	Mos përmbushje e detyrave funksionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për secilën periudhë përkatëse në funksion të ushtrimit të detyrës, të hartohet/miratohet Rregullorja e Ujit, në zbatim të Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" të ndryshuar, dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA."

2. Titulli i gjetjes:	Në Ujësjellës Kanalizime Kurbin SHA raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë.
Situata:	Kjo pasi pusët e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret seriozisht në konsideratë. Si e tillë, Shoqëria ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERRU për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen. Bilanci i Ujit sipas modelit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IËA) në sistemet e furnizimit me ujë përfaqëson një metodikë për të vlerësuar sasinë e ujit që hyn dhe si konsumohet brenda sistemit, përkatësisht në pjesën që i faturohet konsumatorëve dhe në humbjet administrative dhe reale të tyre. Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Bilanci i Ujit përshkruan dhe analizon gjendjen aktuale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjike dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Kjo është dhe arsyeja kryesore që kërkesat e UK për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve duhet të shoqërohet detyrimisht me paraqitjen e një Plani Biznesi 5 Vjeçar.

	Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj). Bazuar në të dhënat mbi treguesin e prodhimit dhe faturim-arkëtimit, në total sipas viteve, humbjet në rrjetin transmetues dhe shpërndarës zënë në total mbi 60 % për qind, për vitin 2018 zënë 65%%, për vitin 2019 zënë 59%, për vitin 2020 zënë 54% dhe për periudhën 01.04.2021 zënë 53% treguesit.
Kriteri:	Çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.
Ndikimi:	Shoqëria ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERR. për metodologjinë e matjes.
Shkaku:	Nuk jep informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Të vendosi matës në çdo vendburim nga furnizohet me ujë UKK.

3. Titulli i gjetjes:	Mngesa e kontrolleve sistematike.
Situata:	Nga ana e óUKKô SHA, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer kontrolle sistematike për konstatimet dhe prerjen e lidhjet e paligjshme, gjithashtu nuk është marrë asnjë masë për konstatimin e përdorimit nga ana e subjekteve private të puseve të prodhimit të ujit me/pa leje. Kjo ka sjellë mos funksionim të grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri.
Kriteri:	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, Kodi i ujit, pjesa e dytë óSistemi i furnizimit me ujëô .
Ndikimi:	Bilanci i Ujit nuk përshkruan dhe analizon gjendjen reale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjikë dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).
Shkaku:	Mos funksionimi i grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e óUKKô SHA, të kryhen në mënyrë të vazhdueshme inspektime për identifikimin e lidhjeve të paligjshme dhe të zbatohet kuadri ligjor për subjekte/konsumatorët që shfrytëzojnë puse për uji.

4. Titulli i gjetjes:	Mungesë e Efijencës së Stafit
Situata:	Efijenca e Stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK. Ky

	tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UKK ka arritur në numrin 120 punonjës dhe 7127 lidhje, kjo sipas raportime të E.RR. Treguesi i performancës së Efijencës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 16.8 staf/1000 lidhje UK. Ky tregues është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës dhe qëndron ende larg objektivit të performancës së mirë të kërkuar nga ERRU. Duke qenë se numri i lidhjeve UK gjatë vitit 2020 është rritur në 7,127, numrit i stafit nuk ka ndikuar në përmirësimin e këtij indikator. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, i cili në disa raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm disa shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë ,UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë, UK Elbasan etj., i plotësojnë kushtet që efijenca e stafit të jetë në nivelet e një performace të mirë. Duke parë karakterin mjaft kompleks dhe relativ të këtij treguesi, kërkohet një analizë me e thelluar e tij sepse jo te gjitha shoqëritë e mësipërme mund të konsiderohen të suksesshme në realizimin e këtij treguesi. ERR. në aplikimet e shoqërive për tarifa analizon në mënyrë të detajuar këtë tregues, i cili lidhet direkt me kostot e punës, duke konsideruar vetëm kostot e justifikuara për përballimin përmes tarifës.
Kriteri:	Niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje për sektorin Ujësjetellësve është rreth 5.4 punonjës për 1000 lidhe.
Ndikimi:	Kostot e personelit zënë pjesën më të madhe të kostove O&M në shërbimin e Ujësjetellës Kanalizime Kurbin SHA. Numri i lartë i personelit ndikon negativisht në treguesit ekonomik financiar të shoqërisë.
Shkaku:	Marrja pa kriter në punë e një numri më të lartë punonjësish se nevojat reale për fuqinë punëtore në UKK.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Të zvogëlohet numri i punonjësve në strukturën e UKK, duke menaxhuar më mirë burimet njerëzore, shfrytëzuar rritjen e efijencës në punë dhe rritjen e performancës së shoqërisë. Këto veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Asamblesë, anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë.

5. Titulli i gjetjes:	Numri i konsumatorëve që janë të pajisur me matës në Bashkinë Kurbin në raport me numrin total të konsumatorëve të ujit të pijshëm është relativisht i ulët (afërsisht 40%).
Situata:	Në vitin 2018 sasinë e ujit të faturuara me matës në Bashkinë Kurbin janë 182,163 m3 në raport me numrin total të faturimeve që ishte 1,199,934 m3. Si e tillë faturimi afrofe llogaritet në sasinë 1,017,771 m3 ujë. ERRU ka vënë objektiv për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecurisë ndër vite, mbetet ende shumë punë për tu bërë në këtë drejtim në arritjen e këtij treguesi. Ndihet detyrë e UKK të instalojë matës edhe në konsumatorët e tjerë në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve që faturohen dhe ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura". Kjo sepse niveli i matje është tregues shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë.
Kriteri:	UKK duhet të instalojë matës edhe në konsumatorët e tjerë në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve që faturohen ti afrohet mesatares së nivelit të matjes.

	Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura".
Ndikimi:	Niveli i matje është tregues shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë.
Shkaku:	Mungesa e linjave të grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura dhe identifikimi lidhjeve në KUZ që ekzistojnë e lidhjeve të popullsisë në njësitë administrative.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	UKK të instalojë matësit e ujit të pijshëm për konsumatorët në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve të pajisur me matës ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë e treguesit óUji pa të Ardhura. Të planifikohen/realizohen investime për vendosjen e matësve në UKK në mënyrë që të rritet niveli i matjes.

f.Titulli i gjetjes: Mos aplikimi i tarifave dhe gjobave të kamat vonesave.

Situata: Gjatë shqyrtimit të arkëtimeve të pagesave nga furnitorët e furnizuar me ujë, në UKK u konstatua se faturimet nuk përfshinin në vlerën financiare përlogaritjen e kamatëvonesave dhe gjobave për mos likuidim të detyrimit në kohë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

-Nga óUjësja Kanalizime Kurbinô SH.A nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Ujit. Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësja Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori. Këshilli Mbikëqyrës, pasi e miraton këtë rregullore, me kërkesën e administratorit të shoqërisë, ia dërgon atë për miratim në emër të Këshillit Mbikëqyrës dhe vetë administratorit, Asamblesë së Aksionareve të UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonës së shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 óPër miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësja-kanalizimeve SH.A."

-Në óUjësja Kanalizime Kurbinô SH.A raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë, kjo pasi pusët e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret seriozisht në konsideratë. Si e tillë, Shoqëria ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERRU për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen.

Bilanci i Ujit sipas modelit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IËA) në sistemet e furnizimit me ujë përfaqëson një metodikë për të vlerësuar sasinë e ujit që hyn dhe si konsumohet brenda

sistemit, përkatësisht në pjesën që i faturohet konsumatorëve dhe në humbjet administrative dhe reale të tyre. Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Bilanci i Ujit përshkruan dhe analizon gjendjen aktuale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjike dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Kjo është dhe arsyeja kryesore që kërkesat e UK për miratimin e tarifave të reja të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve duhet të shoqërohet detyrësisht me paraqitjen e një Plani Biznesi 5 Vjeçar.

Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Metodika e Hartimit të Bilancit të Ujit

Hartimi i Bilancit të Ujit për sistemet e furnizimit me ujë pa/pjesërisht me matje realizohet nëpërmjet metodës òlart-poshtëò. Kjo metodë përdoret në sisteme në të cilat është e pamundur që të llogariten humbjet teknike më të gjithë nënkomponentët përbërës të tyre. Humbjet Teknike më këtë metodë llogariten si diferencë e sasisë së ujit që hyn në sistem me shumën e Konsumit të Autorizuar të Faturuar e të Pa faturuar, si dhe të Humbjeve Administrative.

Metoda e llogaritjes së Humbjeve Teknike sipas metodës óposhtë-lartò kërkon sisteme furnizimi me ujë që kanë matje individuale dhe zonale, si dhe kryerjen e matjeve të rregullta në terren. Në sistemet e furnizimit me ujë pa/pjesërisht me matje për hartimin e Bilancit të Ujit Konsumi i Autorizuar i Faturuar dhe i Pa faturuar mund të llogaritet. Në pamundësi për të llogaritur komponentët e Humbjeve Teknike, e vetmja fushë për të hartuar Bilancin e Ujit në këto sisteme mbetet që të vlerësohen ose llogariten Humbjet Administrative mundësisht me të gjithë elementët përbërës të saj. Humbjet Administrative përbëhen nga:

I. Konsumi i Paautorizuar

ÇLidhjet e paligjshme

ÇNënfaturimet e konsumatorëve me ujëmatës

ÇManipuluesit e ujëmatësve dhe óby passò

ÇNënfaturimet e konsumatorëve pa ujëmatës

II. Pasaktësia në Ujëmatës

Realisht shoqëria nuk disponojnë të dhëna te plota dhe të mjaftueshme për përcaktimin e të gjithë nënkomponentëve të Humbjeve Administrative të përmendura më sipër. Prandaj të dhënat e nevojshme për përcaktimin e të gjithë nënkomponentëve të tyre do të mblidhen duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë, që nga rekordet (regjistrimet), anketime të ndryshme, të dhëna nga ndonjë studim i fizibilitetit të kryer më parë, apo të dhëna nga sisteme furnizimi me ujë e kushte të ngjashme.

Gjendja e volumit të ujit të prodhuar në sistem për të tre sektorët e UKK për periudhën objekt auditimi paraqitet si mëposhtë:

	VOLUMI I UJIT TE PRODHUAR M3				
MUAJIT	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	TOTALI
JANAR	314,383	267,786	227,327	192,991	1,002,487
SHKURT	285,981	235,692	215,392	166,529	903,594
MARS	309,816	254,631	227,763	196,024	988,234
PRILL	305,673	259,787	231,845	190,675	987,980
MAJ	317,316	259,732	199,662		776,710
QERSHOR	302,747	225,228	178,520		706,495
KORRIK	285,173	225,027	172,332		682,532
GUSHT	276,535	235,048	177,112		688,695
SHTATOR	256,554	224,036	189,664		670,254
TETOR	263,414	234,833	193,767		692,014
NENTOR	255,409	218,230	187,734		661,373
DHJETOR	263,032	232,261	194,025		689,318
TOTALI	3,436,033	2,872,291	2,395,143	746,219	9,449,686

Burimi: “Ujësjellës Kanalizime Kurbin” sh.a

Gjendja e volumit të ujit të faturuar për të tre sektorët e UKK për periudhën objekt auditimi paraqitet si mëposhtë:

	VOLUMI I UJIT TE FATURUAR M3				
MUAJIT	VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	TOTALI
JANAR	99,023	96,505	93,894	88,177	377,599
SHKURT	98,944	96,652	92,168	87,414	375,178
MARS	98,580	95,853	93,071	86,963	374,467
PRILL	100,892	96,786	90,170	87,698	375,546
MAJ	100,853	97,074	93,603		291,530
QERSHOR	102,902	98,500	93,633		295,035
KORRIK	100,502	100,168	91,115		291,785
GUSHT	102,481	100,831	92,098		295,410
SHTATOR	103,084	100,085	91,286		294,455
TETOR	99,759	98,095	89,527		287,381
NENTOR	98,002	95,598	88,546		282,146
DHJETOR	95,674	91,844	87,836		275,354
TOTALI	1,200,696	1,167,991	1,096,947	350,252	3,815,886

Burimi: “Ujësjellës Kanalizime Kurbin” sh.a

Mbi treguesin e koeficientit të humbjeve të ujit

Në lidhje me treguesin e koeficientit të humbjeve nga ana e drejtorisë së shoqërisë, nuk ishte kryer programe dhe analiza të hollësishme për këtë tregues shumë të rëndësishëm për rezultatet e shoqërisë. Bazuar në të dhënat mbi treguesin e prodhimit dhe faturim-arkëtimit, në total sipas viteve, humbjet në rrjetin transmetues dhe shpërndarës zënë në total mbi 60 % për qind, për itin 2018 zënë 65%%, për vitin 2019 zënë 59%, për vitin 2020 zënë 54% dhe për periudhën 01.04.2021 zënë 53% treguesit jepen sipas pasqyrës së mëposhtme:

Periodha	Prodhimi	Faturimi	Humbjet	%
2018	3,436,033	1200696	2,235,337	65%
2019	2872291	1167991	1,704,300	59%
2020	2395143	1096947	1,298,196	54%
2021	746219	350252	395,967	53%
TOTALI	9,449,686	3815886	5,633,800	60%

Burimi: "Ujësjellës Kanalizime Kurbin" sh.a

Humbjet e përlogaritura për të tre sektorët e UKK për periudhën objekt auditimi paraqitet si mëposhtë:

Humbjet				
VITI 2018	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	TOTALI
2,235,337	1,704,300	1,298,196	395,967	5,633,800

Burimi: "Ujësjellës Kanalizime Kurbin" sh.a

-Nga ana e óUKKô SHA, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer kontrole sistematike për konstatimet dhe prerjen e lidhjet e paligjshme, gjithashtu nuk është marrë asnjë masë për konstatimin e përdorimit nga ana e subjekteve private të puseve të prodhimit të ujit me/pa leje Kjo ka sjellë mos funksionim të grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri.. Bilanci i Ujit nuk përshkruan dhe analizon gjendjen reale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjike dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, Kodi i ujit, pjesa e dytë óSistemi i furnizimit me ujëô .

Veprim dhe mosveprim i cili ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Asamblesë, anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë.

-Numri i konsumatorëve që janë të pajisur me matës në Bashkinë Kurbin në raport me numrin total të konsumatorëve të ujit të pijshëm është relativisht i ulët (afërsisht 40%).

Në vitin 2018 sasitë e ujit të faturuara me matës në Bashkinë Kurbin janë 182,163 m³ në raport me numrin total të faturimeve që ishte 1,199,934 m³. Si e tillë faturimi afrofe llogaritet në sasinë 1,017,771 m³ ujë. ERR. ka vënë objektiv për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecures ndërr vite, mbetet ende shumë punë për tu bërë në këtë drejtim në arritjen e këtij treguesi. Ndihet detyrë e UKK të instalojë matës edhe në konsumatorët e tjerë në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve që faturohen dhe ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura". Kjo sepse niveli i matje është tregues shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë.

-Mbi mungesën e Efijencës së Stafit

Efiçenca e Stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK. Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UKK ka arritur në numrin 120 punonjës dhe 7127 lidhje, kjo sipas raportime të E.RR. . Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 16.8 staf/1000 lidhje UK.

Ky tregues është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës dhe qëndron ende larg objektivit të performancës së mirë të kërkuar nga ERR. . Duke qenë se numri i lidhjeve UK gjatë vitit 2020 është rritur në 7,127, numrit i stafit nuk ka ndikuar në përmirësimin e këtij indikatori. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, i cili në disa raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm disa shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë ,UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë, UK Elbasan etj., i plotësojnë kushtet që efiçenca e stafit të jetë në nivelet e një performace të mirë. Duke parë karakterin mjaft kompleks dhe relativ të këtij treguesi, kërkohet një analizë me e thelluar e tij sepse jo të gjitha shoqëritë e mësipërme mund të konsiderohen të suksesshme në realizimin e këtij treguesi.

ERR. në aplikimet e shoqërive për tarifa analizon në mënyrë të detajuar këtë tregues, i cili lidhet direkt me kostot e punës, duke konsideruar vetëm kostot e justifikuara për përballimin përmes tarifës.

-Mbi aplikimin e tarifave dhe gjobave të kamat vonesave.

Gjatë shqyrtimit të arkëtimeve të pagesave nga furnitorët e furnizuar me ujë, në UKK u konstatua se faturimet nuk përfshinin në vlerën financiare përlogaritjen e kamatëvonesave dhe gjobave për mos likuidim të detyrimit në kohë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- Ç Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" të ndryshuar.
- Ç Ligjit nr. 111/2012 óPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreó
- Ç Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 óPër miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA."
- Ç Vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 11.12.2009, óKodi i ujitó

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Asamblesë, anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë.

7. Mbi Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2018 në 30.04.2021;

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;

Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;

Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);

Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/mallrave dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili Sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka UKK, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publik, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2018-30.04.2021, auditoi të gjitha procedurat me vlerë mbi 800,000 lekë.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varion nga 1 deri në 2 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesimin e paktë të OE edhe pse kriteret përgjithësisht janë në përputhje me ligjin.

-Nga auditimin i 8 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 1 óObjekti dhe qëllimi pika 2, gërma (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjes gërma (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ó Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ku;

a- Në 26 procedura, me vlerë të vogël nga Titullari i AK dhe Njësia e Prokurimit është bërë copëzimi i fondeve.

b- Në 2 (dy) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

c- Në 5 (pesë) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Procedurat e zhvilluara dhe të audituara janë:

Lloji	Objekti	Vlera prokuruar pa tvsh	Vlera kontratës pa tvsh	Diferenca nga fondi limit	OE/BOE fitues	NJP	KVO	3E ^{4e}
Hapur	Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit	365,697,488	363,692,924	2,004,563	S., EG. & GPG COM.	PO	PO	363,692,924
Hapur	Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese per furnizimin me ujë të Qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimit	50,000,000	49,299,952	700,048	SE.	PO	PO	49,299,952
KP	Mbikëqyrje Punimesh "Ndërtimi i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm	4,036,511	3,437,895	598,616	ER.	JO	PO	JO

	<i>faza II</i>							
KP	<i>Mbikëqyrje Punimesh "Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese per furnizimin me uje te qytetit te Lacit"</i>	1,151,000	1,019,625	131,375	ER.	JO	PO	1,019,625
KP	<i>Hartim projekti për ujësjellësin Mamurras</i>	4,385,000	3,491,020	893,980	E.-G	JO	PO	JO
KP	<i>Blerje Karburant per nevoja te Sh.a Ujësjetlës Kanalizime Kurbin...2019</i>	800,000	783,750	16,250	LI.-08	JO	JO	JO
KP	<i>Blerje Karburant per nevoja te Sh.a Ujësjetlës Kanalizime Kurbin viti 2020</i>	2,500,000	2,495,350	4,650	LI.-80	JO	JO	JO
KP	<i>Ftesë për ofertë me objekt 6Blerje Klor për nevoja të Sh.a Ujësjetlës Kanalizime Kurbin viti 2020</i>	800,000	753,000	47,000	ATL.-3	JO	JO	JO
	TOTALI	429,369,999	424,973,516	4,396,482				414,012,501

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

1. Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit óNdërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitô.
Situata:	Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar. Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. <i>Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues".</i> -Zhvillimi i procedurës. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE óSE., EG. & GP. COM.ô SHPK, me vlerë kontrate 365,697,488 lekë, ose 436,431,509 lekë me tvsh , si dhe lidhur kontrata me nr. 101/13, date 23.06.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues BOE óSE., EG. & GP. COM.ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të

	ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE óSE., EG. & GP. COM.ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 óObjekti dhe qëllimiô pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjesô germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ô për miratimin e rregullave të prokurimit publikô, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Ulje e pjesëmarrjes/konkurrimit në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 363,692,924lekë ,
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, UKK, në përcaktimin e kriterëve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të marrë masa për vendosjen e tyre në përputhje me llojin e saj si dhe në respektimin të referencave ligjore në fuqi me qëllim rritjen e konkurrencës dhe mos diskriminimin e Operatorëve Ekonomik të fushës. Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, UKK, të nxjerrë përgjegjësitë për procedurën konkrete ku vlera e kontraktuar prej 363,692,924lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të}) .
2. Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në përcaktimin e kriterëve dhe vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit óHapja e pushtimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te Qytetit te Laçit si dhe ndërtimi i stacionit te pompimitô.

Situata:	Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar. Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. <i>Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”.</i> <u>Zhvillimi i procedurës.</u> Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óSE.ô SHPK me vlerë kontrate 49,299,952 lekë pa tvsh ose 59,159,942 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 320/13, date 14.12.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óSE.ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óSE.ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 óObjekti dhe qëllimiô pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjesô germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i

	VKM nr. 797, datë 29.12.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ô për miratimin e rregullave të prokurimit publikô, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Ulje e pjesëmarrjes/konkurrimit në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 49,299,952 lekë, (Gjerësisht trajtuar në Akt-konstatimet nr. 09, datë 14.05.2021).
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, UKK, në përcaktimin e kriterëve të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit të marrë masa për vendosjen e tyre në përputhje me llojin e saj si dhe në respektimin të referencave ligjore në fuqi me qëllim rritjen e konkurrencës dhe mos diskriminimin e Operatorëve Ekonomik të fushës. Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, UKK, të nxjerrë përgjegjësitë për procedurën konkrete ku <i>vlera e kontraktuar prej 49,299,952lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te})</i> .

3. Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit óMbikëqyrje punimesh për objekt: Ndërtimi i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm faza II.....ô.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óEr.-Gô SHPK me vlerë kontrate 3,437,895 lekë pa tvsh ose 4,125,474 lekë me tvsh , si dhe lidhur kontrata me nr. 158/14, date 03.07.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óEr.-Gô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike e kualifikuar, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óEr.-Gô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e

	<i>pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 óObjekti dhe qëllimi</i> pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjes germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ó për miratimin e rregullave të prokurimit publikó, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Kualifikimi i një OE i cili mund të mos ketë kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës në përputhje me parashikimet e saj
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

4. Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit óMbikëqyrje punimesh për objekt: Hapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te qytetit te Laçitó.
Situata:	-Zhvillimi i procedurës. Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óEr.-Gó SHPK me vlerë kontrate 1,019,625 lekë pa tvsh ose 1,223,550 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 322/14, date 14.12.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óEr.-Gó SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja e kualifikuar), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óEr.-Gó SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveó të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; Nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1

	óObjekti dhe qëllimiô pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjesô germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ô për miratimin e rregullave të prokurimit publikô, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në shumën 1,019,625 lekë.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike. Autoriteti Kontraktor, UKK, të nxjerrë përgjegjësitë për procedurën konkrete ku <i>vlera e kontraktuar prej 1,019,625 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të})</i> .

5. Titulli gjetjes:	Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në vlerësimin e OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit óHartim projekti për Ujësjellësin Mamurrasô.
Situata:	<u>-Zhvillimi i procedurës.</u> Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óEr.-Gô SHPK me vlerë kontrate 3,491,020 lekë pa tvsh ose 4,189,224 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 321/14, date 20.11.2020. **** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óEr.-Gô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK. Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óEr.-Gô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.
Kriteri:	Mosreferim në aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes dhe konkretisht: Pikën 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertaveô të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; si dhe neni 1 óObjekti dhe qëllimiô pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjesô germa (a), (b) dhe (c),

	dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ó Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, ó për miratimin e rregullave të prokurimit publikó, të ndryshuar.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Efekti:	Kualifikimi i një OE i cili mund të mos ketë kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës në përputhje me parashikimet e saj.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, UKK, në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

I-Tenderi me objekt: óNdërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitó, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Ndërtimi i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit.</i>		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 11 Date 31.03.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr .11/2.dt.31.03.2020 1 ñ B. N. 2 - J. E. 3- G. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr 11/1 . Dt 31.03.2020 1-Kryetar ñ D. A. 2.Anetar A. Rr. 3 Anetar T. P.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimi E Hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 365,697,488	6.Oferta fituese (pa tvsh) 363,692,924.5 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 2,004,563.5
8. Data e hapjes së tenderit 15.05.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.1(Bashkim Opertaresh Sðkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) ShpallurFitues OE/Senka SH.P.K
11.Ankimime AK-sðka/ka; APPñsðka/ka; KPP-sðka/ka	12. Përgjigje Ankesësnga AK Nr. __ska__ / __prot, date __.__.20 Nr.__ska__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Prot __ska__ date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date __ska__, date ___.__.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni óMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitó me procesverbal datë 08.04.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 08.04.2020 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

-Nga NJHDT në DST nuk argumentojnë me procesverbal:

Pikën 2.3 Per Kapacitetin teknik:

2. Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës :

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.7.A. ô

AK në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ligjit rregullues nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktimeve të nenit 46 të LPP ku përcakton se cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës e për rrjedhim kërkesa për licensat e sipërcituara duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B.

AK duhet të kishte parashikuar edhe mundësinë e kontraktimit me një kontratë shërbimi të një operatori ekonomik të liçensuar për ofrimin e këtij shërbimi.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.7.A.

Rezultoni që ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit nëpërmjet hartimit të preventivit specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive. Për rrjedhojë të sa më lart argumentohet që kërkesa në fjalë do të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët konsiderohen që disponojnë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e kontratës. Në këtë mënyrë janë cënuar parashikimet e nenit 20 të LPP që çdo kërkesë apo kriter që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre ose paracaktim të fituesve.

AK duhet të kishte parashikuar edhe mundësinë e kontraktimit me një kontratë shërbimi të një operatori ekonomik të liçensuar për ofrimin e këtij shërbimi.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 ôPër arsimin dhe formimin profesional në RSHô, kontratë pune të vlefshme, IQT ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesa:

- Teknik Ndërtimi 4 (kater)
- Teknik Elektricist 1 (një)
- Teknik Mekanik 2 (dy)
- Teknik Hidraulik 4 (kater)

Numri i kërkuar për keto specialitete nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka në stafin e punonjësve, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me dëshmi kualifikimi profesionale, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë brenda periudhës e kërkuar si me poshtë:

Ç	Elektricist	5 (pese)
Ç	Hidraulik	40 (dyzet)
Ç	Mekanik	7 (shtate)
Ç	Elektro mekanik	1 (nje)
Ç	Hekurkthyes	4 (kater)
Ç	Karpentier	4 (kater)
Ç	Bojaxhi	4 (kater)
Ç	Pllakashtrues	2 (dy)

Ç	Punetor izolimi	1 (nje)
Ç	Pompist	1 (nje)
Ç	Betonues	1 (nje)

Numri i kërkuar për këto specialitete nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet, kjo në referim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

11. OE ofertues duhet te kete ne stafin e tij gjithashtu te pakten:

1 (Nje) Ekspert te auditimit te energjise (Me certifikaten perkatese).

Audituesi i energjisë për të përmbushur funksionin e tij dhe qëllimin e vendosjes së këtij kriteri, në këtë rast nuk ka pse të jetë detyrimisht pjesë e stafit përse kohë që mundet të kontraktohet edhe me kontratë shërbim konsulence me vlefshmëri përgjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues", për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga B. N., J. E. dhe G. M. si dhe titullari i AK, A. P. , në cilësinë e miratuesit të tyre.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës 15.05.2020, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	BO. óSE. , EGL. & GP. COM.ô SHPK	365,697,488	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 28.05.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka marrë pjesë vetëm 1 (një) OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë BOE óSE., EGL. & GP. COM.ô SHPK, me vlerë kontrate 365,697,488 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 29.05.2018 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE óSE. , EGL. & GP. COM.ô SHPK me vlerë kontrate 365,697,488 lekë pa tvsh ose 436,431,509 lekë me tvsh , si dhe lidhur kontrata me nr. 101/13, date 23.06.2020.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** BOE óSE. , EGL. & GP. COM. ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha

kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

Operatori ekonomik “SE.” SHPK dhe “ENG.” SHPK nuk e ka plotësuar saktë këtë shtojcën, pasi nuk kanë bërë check, duke mos klikuar asnjë nga alternativat respektive të saj.

7. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka në stafin e punonjesve, të vertetuar me kontrate pune të vlefshme, të pajisur me dëshmi kualifikimi profesionale, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë brenda periudhës e kërkuar si me poshte:*

- *Elektricitist* 5 (pese)
- *Hidraulik* 40 (dyzet)
- *Mekanik* 7 (shtate)
- *Elektro mekanik* 1 (nje)
- *Hekurkthyes* 4 (kater)
- *Karpentier* 4 (kater)
- *Bojaxhi* 4 (kater)
- *Pllakashtrues* 2 (dy)
- *Punetor izolimi* 1 (nje)
- *Pompist* 1 (nje)
- *Betonues* 1 (nje)

Operatori ekonomik nuk duhet të ishte kualifikuar pasi AK ka kërkuar që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi profesionale, ndërkohë që e ka kualifikuar OE edhe pse i ka paraqitur punonjësit vetëm me dëshmi të sigurimit teknik.

11. OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij gjithashtu të pakten:

Ç 1 (Nje) Inxhinier Menaxhim Projektesh.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues që punonjësi në fjalë zotëron kualifikimin e duhur për këtë pozicion.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE óSE., EGL. & GP. COM.ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SEN. , EGL. & GP. COM.”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 365,697,488lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{të}), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: D. A. , në cilësinë e kryetarit**

të KVO, A. Rr. dhe T. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A.P. .

-II-Tenderi me objekt: *óHapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te Qytetit te Laçit si dhe ndërtimi i stacionit te pompimit ”, me këto të dhëna:*

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Hapja e pus-shpime bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te Qytetit te Laçit</i>		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 28 Date 15.10.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit UrdhërNr.28/2.dt.15.10.2020 1 ñ B. N. 2 - J. E. 3- G. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave UrdhërNr 28/1 . Dt 15.10.2020 1Kryetar ñ D. A. 2.Anetar A. R. 3 Anetar T. P.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimi E Hapur		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 50,000,000	6.Oferta fituese (pa tvsh) 49,299,952 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 700,048
8. Data e hapjes së tenderit 27.11.2020	9.Burimi Financimit Buxheti I Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.1 b) Së kualifikuar ___ OE, c) Kualifikuar ___ OE ç) Shpallur Fitues OE/ Senka SH.P.K
11.Ankimime AK-ska/ka; APP-nska/ka; KPP-ska/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. ___ ska ___ / ___ prot, date ___ . ___ 20 Nr. ___ ska ___ / ___ prot, date ___ . ___ 20	13.Përgjigje Ankesës nga APP nr. Prot ___ ska, date ___ . ___ 20 apo KKP nr. prot, date ____, date ___ . ___ 20

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni óMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe për llogaritjen e vlerës së fondit limitó me procesverbal datë 15.10.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 15.10.2020 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

-Nga NJHDT në DST nuk argumentojnë me procesverbal:

Pikën 2.3 Per Kapacitetin teknik:

2. Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës :

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.7.A. ó

AK në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ligjit rregullues nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktimeve të nenit 46 të LPP ku përcakton se çdo kriter i veçantë duhet të jetë në

përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës e për rrjedhim kërkesa për licensat e sipërcituara duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B.

AK duhet të kishte parashikuar edhe mundësinë e kontraktimit me një kontratë shërbimi të një operatori ekonomik të liçensuar për ofrimin e këtij shërbimi.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A.

- Liçense lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.7.A.

Rezultoni që ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit nëpërmjet hartimit të preventivit specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive. Për rrjedhojë të sa më lart argumentohet që kërkesa në fjalë do të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët konsiderohen që disponojnë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e kontratës. Në këtë mënyrë janë cënuar parashikimet e nenit 20 të LPP që cdo kërkesë apo kriter që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre ose paracaktim të fituesve.

AK duhet të kishte parashikuar edhe mundësinë e kontraktimit me një kontratë shërbimi të një operatori ekonomik të liçensuar për ofrimin e këtij shërbimi.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 për arsimin dhe formimin profesional në RSHO, kontratë pune të vlefshme, IQT ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesa:

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Teknik Elektricist 1 (një)
- Teknik Mekanik 1 (një)
- Teknik Hidraulik 4 (kater)

Numri i kërkuar për keto specialitete nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së

1. OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij gjithashtu të pakten:

*1 (Një) Ekspert të auditimit të energjisë (Me certifikatën perkatese).

Audituesi i energjisë për të përmbushur funksionin e tij dhe qëllimin e vendosjes së këtij kriteri, në këtë rast nuk ka pse të jetë detyrimisht pjesë e stafit përse kohë që mundet të kontraktohet edhe me kontratë shërbim konsulence me vlefshmëri përgjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d),

neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga B. N. , J. E. dhe G. M. si dhe titullari i AK, A. P. , në cilësinë e miratuesit të tyre.**

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **01.12.2020**, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	OE óSE.ô SHPK	49,299,952	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 07.12.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka marrë pjesë vetëm 1 (një) OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óSE.ô SHPK, me vlerë kontrate 49,299,952 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 09.12.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE óSE.ô SHPK me vlerë kontrate 49,299,952 lekë pa tvsh ose 59,159,942 lekë me tvsh , si dhe lidhur kontrata me nr. 320/13, date 14.12.2020.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE óSE.ô SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike (e vetmja), rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitet 2019 dhe 2020. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Ka deklaruar punë në proces në Bashkinë Kurbin, Laç, Bashkinë Tiranë dhe në Bashkinë Shijak por nuk ka paraqitur vërtetim të taksave vendore.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 óPër arsimin dhe formimin profesional në RSHô, kontratë pune të vlefshme, IQT ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesa:

-Teknik Mekanik 1 (nje) I mungon IQT

3/Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm .

Liçenca e mjekut ka skaduar 10.08.2015-5 vite- 10.08.2020

11. OE ofertues duhet te ketë ne stafin e tij gjithashtu te paktën:

Ç 1 (Nje) Inxhinier Menaxhim Projektesh.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues që punonjësi në fjalë zotëron kualifikimin e duhur për këtë pozicion.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óSE. ô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “SE.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, **si dhe vlera e kontraktuar prej 49,299,952 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{të})**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: D. A. , në cilësinë e kryetarit të KVO, A. R. dhe T. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. P. .**

-III-Tenderi me objekt: óMbikëqyrje Punimesh óNdërtimi i rrjetit te jashtëm dhe te brendshëm faza II.....”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Mbikëqyrje Punimesh “Ndërtimi i rrjetit te jashtëm dhe te brendshëm faza II</i>		
1.Urdhër Prokurimi Nr 19 Date 28.05.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit UrdhërNr.19.dt._28_.05_.2020 1 B. N. 2 J. E. 3 G.M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr 19/1 . Dt 28.05.2020 1Kryetar D. A. 2.Anetar A. Rr. 3 Anetar T. P.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kerkese per Propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,036,511.67 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 3,437,895 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 598,616.67
8. Data e hapjes së tenderit 09.06.2020	9.Burimi Financimit Buxheti I Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Nr.6 &OE b) Sëkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 3 OE ç) Shpallur Fitues OE/ ER.-G SH.P.K
11.Ankimime AK-sëka/ka; APPñsëka/ka; KPP-sëka/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. __ska__ / __prot, date __.__.20 Nr.__ska__/_prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesës nga APP nr. Prot __ska__, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date ____, date ___.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni óMbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitó me procesverbal

datë 28.05.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 28.05.2020 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, është i argumentuar dhe nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **09.06.2020**, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	OE óER.-Gô SHPK	3,437,895	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	D.-E SHPK	3,390,670	Skualifikuar
3.	NOV. STU. SHPK	3,420,057	Skualifikuar
4.	I. SHPK	3,437,894	Skualifikuar
5.	A&E ENG. SHPK	3,439,451	Kualifikuar
6.	INS. DEK.-AL. SHPK	3,550,000	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 07.12.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, ka marrë pjesë 6 OE nga ku janë skualifikuar 3 dhe kualifikuar 3 (tre) OE.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK, me vlerë kontrate 49,299,952 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 29.06.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK me vlerë kontrate 3,437,895 lekë pa tvsh ose 4,125,474 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 158/14, datë 03.07.2020.

**** **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE óER.-Gô SHPK, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK nuk e ka plotësuar saktë këtë shtojcë, pasi nuk kanë bërë check, duke mos klikuar asnjë nga alternativat respektive të saj.

1.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se fondi limit

Vërtetimi i xhiros nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T02329949 datë 27.05.2021 i paraqitur nga Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

2.5 Deshmi per stafin punonjes te operatorit ekonomik, ku numri mesatar i punonjesve te siguruar te jete jo me i vogel se 15 (pesembedhjte) punonjes per periudhen Mars 2019 ñ Mars 2020 . Për këtë duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Mars 2019 ñ Mars 2020. Pa vule

Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T02329941 datë 27.05.2021 paraqitur nga Operatori ekonomik óER. -Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óER. -Gô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikó, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “ER. -G”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar shpalljen fitues të OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: D. A. , në cilësinë e kryetarit të KVO, A. Rr. dhe T. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. P. .

-IV-Tenderi me objekt: óMbikëqyrje punimesh për objekt: Hapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te qytetit te Laçit”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Mbikëqyrje punimesh me objekt: Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te e qytetit te Laçit		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 30 Date 27.10.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr.30/2.dt.27.10.2020 1 B. N. D. A. 2 J. E. 3- G. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr 30/1 . Dt 27.10.2020 1 Kryetar D. A. 2 mAnetar A. Rr. 3 Anetar T. P.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kërkese per propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,151,000	6.Oferta fituese (pa tvsh) 1,019,625 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 131,375
8. Data e hapjes së tenderit 10.11.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.4) Sëkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) ShpallurFitues OE/ Er.-G SH.P.K
11.Ankimime AK-ska/ka; APPñska/ka; KPP-ska/ka	12. Përgjigje Ankesësnga AK Nr. __sка__ / __prot, date __.__.20 Nr. __sка__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Prot __sка__, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date __sка__, date __.__.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni 0Mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitó me procesverbal datë 27.10.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 27.10.2020 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, është i argumentuar dhe nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **10.11.2020**, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	OE óER.-Gô SHPK	1,019,625	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	Ins. Dek.-ALB. SHPK	1,050,000	Kualifikuar
3.	MA. STU. SHPK	1,050,000	Kualifikuar
4.	NO.AT. STU. SHPK	1,050,000	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 25.11.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, kanë marrë pjesë 4 OE, të gjithë të kualifikuar.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK, me vlerë kontrate 1,019,625 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 04.12.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK me vlerë kontrate 1,019,625 lekë pa tvsh ose 1,223,550 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 322/14, date 14.12.2020.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óER.-Gô SHPK**, pavarësisht se është oferta e vetme e kualifikuar, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK nuk e ka plotësuar saktë këtë shtojcë, pasi nuk kanë bërë check, duke mos klikuar asnjë nga alternativat respektive të saj.

1.3. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- b. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se fondi limit

Vërtetimi i xhiros nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T0..55612 datë 14.09.2021 i paraqitur nga Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

2.5 Deshmi per stafin punonjes te operatorit ekonomik, ku numri mesatar i punonjesve te siguruar te jete jo me i vogel se 15 (pesembdhjete) punonjes per periudhen Mars 2019 në Mars 2020 . Për këtë duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Mars 2019 në Mars 2020. Pa vule

Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T03002497 datë 15.10.2020 i paraqitur nga Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óER.-Gô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “ER.-G”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj, si dhe vlera e kontraktuar prej 1,019,625lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga:D.A., në cilësinë e kryetarit të KVO, A. Rr. dhe T. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. P..

-V-Tenderi me objekt: óHartim projekti për Ujësjetllësin Mamurras..ô, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Hartim projekti për Ujësjetllësin Mamurras</i>		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 29 Date 16.10.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër Nr .29/2.dt.16.10.2020 1 në B N. 2 - J. E. 3- G. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr 29/1 . Dt 16.10.2020 1-Kryetar në D. A. 2.Anetar A R. 3 Anetar T. P.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit Kërkese për propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,385,000	6.Oferta fituese (pa tvsh) 3,491,020 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 893,980
8. Data e hapjes së tenderit 02.11.2020	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.4) Sëkualifikuar OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) ShpallurFitues OE/ Er.-G SH.P.K
11.Ankimime AK-ska/ka; APPnëska/ka; KPP-ska/ka	12. Përgjigje Ankesësnga AK Nr. __sка__ / __prot, date __.__.20 Nr. __sка__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Pro __sка__, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date __sка__, dat __.__.20__

Hartimi fondit limit:

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga Komisioni 0Mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limitó me procesverbal datë 18.10.2020. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas dokumentacionit/preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 18.10.2020 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST, rezulton se pas hedhjes në SEP ato nuk janë ndryshuar.

Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, është i argumentuar dhe nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

-Zhvillimi i procedurës.

Me procesverbalin e datës **04.11.2020**, nga ana eKomisionit të Vlerësimit të Ofertave, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjor), ku është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë:

Nr	SUBJEKTI	OFERTA	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	OE óER.-Gô SHPK	3,491,020	Ofertë e kualifikuar dhe shpallur fituese
2.	Ins. Dek.-AL. SHPK	3,587,482	Kualifikuar
3.	GR. ALB. SHPK	3,841,661	Kualifikuar
4.	STU. SER. SHPK	3,938,500	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 13.11.2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, kanë marrë pjesë 4 OE, të gjithë të kualifikuar.

Fituese është shpallur oferta e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK, me vlerë kontrate 3,491,020 lekë. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 16.11.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE óER.-Gô SHPK me vlerë kontrate 3,491,020 lekë pa tvsh ose 4,189,224 lekë me tvsh, si dhe lidhur kontrata me nr. 321/14, date 20.11.2020.

****** Lidhur me OE të shpallur fitues OE óER.-Gô SHPK**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

-Nga AK në DST “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK nuk e ka plotësuar saktë këtë shtojcë, pasi nuk kanë bërë check, duke mos klikuar asnjë nga alternativat respektive të saj.

Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1.Xhiro: Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2017, 2018, 2019), nga data e zhvillimit të tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, e cila duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht 1.754.000(njëmilion e shtateqind e pesedhjetë e kater mije) lekë pa tvsh

Vërtetimi i xhiros nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T0..55612 datë 14.09.2021 i paraqitur nga Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

2.5 Dëshmi për stafin punonjes të operatorit ekonomik, ku numri mesatar i punonjesve të siguruar të jete jo më i vogël se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjes për periudhën Mars 2019 në Mars 2020 . Për këtë duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjesve për secilin muaj për periudhën Mars 2019 në Mars 2020. Pa vule

Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër Nr.T0..02497 datë 15.10.2020 i paraqitur nga Operatori ekonomik óER.-Gô SHPK është i parregullt sepse nuk e përmban vulën elektronike.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE óERA.-Gô SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 óShqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet óAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “ERA.-G”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar shpalljen fitues të OE të rradhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: D. A. , në cilësinë e kryetarit të KVO, A. Rr. dhe T. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. A. P. .

Procedura prokurimi të konstatuara pa shkelje apo mangësi të LPP dhe akteve të dala në zbatim të tij.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Blerje Karburant për nevoja të Sh.a Ujësjes Kanalizime Kurbin viti 2020....</i>		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 7 Date 03.03.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit UrdhërNr.7/2.dt.03.03.2020 1 B. N. 2 J. E. 3- G. M.	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave UrdhërNr 7/1 . Dt 03/03.12.2020 1 Kryetar në D. A. 2.Anetar- A. Rr. 3 Anetar në T. P.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkese për Propozim		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,500,000 <i>leke</i>	6.Oferta fituese (pa tvsh) 2,495,350 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 4650 <i>leke</i>
8. Data e hapjes së tenderit 16.03.2020	9.Burimi Financimit Vet Financim	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.1) S kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) ShpallurFitues OE/ Lin.-80- SH.P.K
11.Ankimime AK-ska/ka; APPniska/ka; KPP-ska/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr. __sca__ / __prot, date __.__.20 Nr. __sca__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Prot __sca__, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date __sca__, date __.__.20__

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Blerje Karburant per nevoja te Sh.a Ujësjelees Kanlizime Kurbin.....</i>		
1.Urdhër Prokurimi Nr 101 Date 27.09.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Urdhër nr.101.dt.27.09.2019	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 101, Dt 27.09.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Ftese per oferte	1 B. N. 2 J. E. 3- G. M.	1Kryetar B. N. 2.Anetar J. E. 3 Anetar G. M.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 800,000 leke	6.Oferta fituese (pa tvsh) 783,750 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 16,250
8. Data e hapjes së tenderit 30.09.2019	9.Burimi Financimit Vet Finacim	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.1 OE b) Sčkualifikuar__ OE, c) Kualifikuar__ OE ç) ShpallurFitues OE/ Lin.-80 SH.P.K
11.Ankimime AK-sčka/ka; APPñsčka/ka; KPP-sčka/ka	12. Përgjigje Ankesësnga AK Nr. __scka__ / __prot, date __.__.20 Nr.__scka__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Prot __scka__, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date ____, date __.__.20__

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Blerje Klori per nevoja te SH.a Ujësjelees Kanalizime Kurbin viti 2020....</i>		
1.Urdhër Prokurimi .Nr 126 Date 27.01.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit UrdhërNr.126.dt.27.01.2020	4.Komisioni I Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr 126. Dt 27.01.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Ftese per oferte	1 B. N. 2 J. E. 3 G. M.	1 Kryetar B. N. 2 AnetarJ. K. 3 Anetar ñ G. M.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 800,000 <i>leke</i>	6.Oferta fituese (pa tvsh) 753,000 <i>leke</i>	7.Diferenca me fondinlimit (pa tvsh) 47,000 <i>leke</i>
8. Data e hapjes së tenderit 29.01.2020	9.Burimi Financimit Vet Financim	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrësnë tender Nr.13) Sčkualifikuar - 12OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) ShpallurFitues OE/ Atl. 3- SH.P.K
11.Ankimime AK-sčka/ka; APPñsčka/ka; KPP-sčka/ka	12. Përgjigje Ankesësnga AK Nr. __scka__ / __prot, date __.__.20 Nr.__scka__ / __prot, date __.__.20	13.PërgjigjeAnkesësnga APP nr. Prot __scka, date __.__.20__ apo KKP nr. prot, date __scka__, date __.__.20__

Qëndrimi i subjektit të audituar: Me shkresën nr. 266/7, datë 11.10.2021, administruar nga KLSH me nr. 539/4, datë 11.10.2021, ka paraqitur kundështimet për secilën procedurë prokurimi dhe konkretisht:

-Për procedurën e prokurimit me objekt óMbikëqyrje punimesh óHapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimitô, dërguar me shkresën nr. 266/1, datë 11.10.2021, nga KVO e përbërë nga D. A. , A. Rr. dhe T. P. , duke kundështuar si vijon:

1.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) lidhur me OE te shpallur fitues.....Operatori Ekonomik “ER.-G” shpk nuk e ka plotësuar sakte shtojcen*

(Deklarate per paraqitje oferte te pavarur) pasi nuk ka bere chech, duke mos klikuar asnje nga alternativat respective te sajë ë ë sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi referuar Shtojces qe OE ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik, vertetohet se shtojca eshte plotesuar ne rregull nga OE (Per me shume informacion bashkelidhur keni shtojcen 1/1).

2.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi i Xhos nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.....nuk permban vulen elektronikeë .. sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE ka paraqitur Vertetim Per Xhiron e Tre viteve te Fundit Nr.T0..55612 date 14.09.2020, vertetim i cili eshte me vule elektronike dhe i gjeneruar nga sistemi. (Vertetim te cilin e keni bashkelidhur).

3.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi Nr.T03002497 date 15.10.2020 i paraqitur nga OE "ER.-G"SHPK eshte i parregullt sepse nuk e permban vulen elektronikeëë ë ..ë .. sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE óER.-Gô shpk ka paraqitur listepagesat te cilat jane me vule elektronike si dhe Vertetim Nr.T0..02497 date 15.10.2020. (Bashkelidhur keni listepagesat me vula elektronike dhe vertetimin).

Shenim: *Nese mendoni se vertetimet qe OE ka paraqitur nuk jane me vula te rregullta elektronike, mund ti drejtoheni Drejtorise Rajonale te Tatimeve per konfirmimin e tyre. Sqarojme se ne kemi komunikuar me DRT dhe na i ka konfirmuar te rregullt keto vertetime.*

Referuar sa më sipër rezulton se ne si KVO kemi berë vlerësimin e tenderit bazuar në nenin 55 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 óPër Prokurimin Publikô të ndryshuar, si dhe të nenit 66, Kreu VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 óPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pikës 1 kundështimi nuk merret në konsideratë, për të njëjtin argument të cilësuar në aktkonstatimi dhe Projektraport, ndërsa për pikën 2 dhe 3 kundështimi është marrë në konsideratë duke bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Kundërshtimet merren pjesërisht në konsideratë.

-Për procedurën e prokurimit me objekt óHartim projekti për ujësjellësin Mamurrasô, dërguar me shkresën nr. 266/2, datë 11.10.2021, nga KVO e përbërë nga D. A. , A. Rr. dhe T. P. , duke kundështuar si vijon:

1.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) lidhur me OE te shpallur fitues.....Operatori Ekonomik "ER.-G" shpk nuk e ka plotesuar sakte shtojcen (Deklarate per paraqitje oferte te pavarur) pasi nuk ka bere chech, duke mos klikuar asnje nga alternativat respektive te sajë ë ë sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi referuar Shtojces qe OE ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik, vertetohet se shtojca eshte plotesuar ne rregull nga OE (Per me shume informacion bashkelidhur keni shtojcen 1/1).

2.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi i Xhos nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.....nuk permban vulen elektronikeë .. sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE ka paraqitur Vertetim Per Xhiron e Tre viteve te Fundit Nr.T0..55612 date 14.09.2020, vertetim i cili eshte me vule elektronike dhe i gjeneruar nga sistemi. (Vertetim te cilin e keni bashkelidhur).

3.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi Nr.T0..02497 date 15.10.2020 i paraqitur nga OE “ER.-G”SHPK është i parregullt sepse nuk e permban vulen elektronike*ôë ë ..ë .. sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE óER.-Gô shpk ka paraqitur listepagesat te cilat jane me vule elektronike si dhe Vertetim Nr.T03002497 date 15.10.2020. (Bashkelidhur keni listepagesat me vula elektronike dhe vertetimin).

Shenim: *Nese mendoni se vertetimet qe OE ka paraqitur nuk jane me vula te rregullta elektronike, mund ti drejtoheni Drejtorise Rajonale te Tatimeve per konfirmimin e tyre. Sqarojme se ne kemi komunikuar me DRT dhe na i ka konfirmuar te rregullt keto vertetime.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pikës 1 kundështimi nuk merret në konsideratë, për të njëjtin argument të cilësuar në aktkonstatimi dhe Projektraport, ndërsa për pikën 2 dhe 3 kundështimi është marrë në konsideratë duke bërë ndyshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Kundërshtimet merren pjesërisht në konsideratë.

-Për procedurën e prokurimit me objekt óMbikëqyrje punimesh óNdërtimi i Rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitô, dërguar me shkresën nr. 266/3, datë 11.10.2021, nga KVO e përbërë nga D. A. , A. Rr. dhe T. P. , duke kundështuar si vijon:

1.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) lidhur me OE te shpallur fitues.....Operatori Ekonomik “EGL.” shpk nuk e ka plotësuar sakte shtojcen (Deklarate per paraqitje oferte te pavarur) pasi nuk ka bere chech, duke mos klikuar asnje nga alternativat respective te sajë ë ë sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi referuar Shtojces qe OE ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik, vertetohet se shtojca eshte plotësuar ne rregull nga OE (Per me shume informacion bashkelidhur keni shtojcen 1/1).

2.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi i Xhos nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.....nuk permban vulen elektronike*ë .. sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE ka paraqitur Vertetim Per Xhiron e Tre viteve te Fundit Nr.T023...49 date 27.05.2020, vertetim i cili eshte me vule elektronike dhe i gjeneruar nga sistemi. (Vertetim te cilin e keni bashkelidhur).

3. Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óVertetimi Nr.T02329941 date 27.05.2020 i paraqitur nga OE “E.”SHPK është i parregullt sepse nuk e permban vulen elektronike*ôë ë ..ë .. sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE óE.ô shpk ka paraqitur listepagesat te cilat jane me vule elektronike si dhe Vertetim Nr.T02329941 date 27.05.2020. (Bashkelidhur keni listepagesat me vula elektronike dhe vertetimin).

Shenim: *Nese mendoni se vertetimet qe OE ka paraqitur nuk jane me vula te rregullta elektronike, mund ti drejtoheni Drejtorise Rajonale te Tatimeve per konfirmimin e tyre. Sqarojme se ne kemi komunikuar me DRT dhe na i ka konfirmuar te rregullt keto vertetime.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pikës 1 kundështimi nuk merret në konsideratë, për të njëjtin argument të cilësuar në aktkonstatimi dhe Projektraport, ndërsa për pikën 2 dhe 3 kundështimi është marrë në konsideratë duke bërë ndyshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Kundërshtimet merren pjesërisht në konsideratë.

-Për procedurën e prokurimit me objekt óNdërtimi i Rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitô, dërguar me shkresën nr. 266/4, datë 11.10.2021, nga NJP e përbarë nga B. N. , J.E. dhe G. M. dhe KVO e përbërë nga D.A. , A.Rr. dhe T.P. , duke kundështuar si vijon:

NJËSIA PROKURIMIT

Per sa i perket pjeses ku ju citoni se: 1. *Licensa profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates:*

- *License lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL Kodi III.2.A*
- *License lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL Kodi III.2.B*
- *License lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL Kodi III.7.Aë ë ë ju sqarojme si me poshte vijon:*

Ky kriter eshte vendosur bazuar ne nenin 46 óKualifikimi i ofertuesveô, pika 1, gërma óaô e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, i ndryshuar, ku përcaktohet: óOperatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;”

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve për të cilën është e domosdoshme licenca me kategori III.2.B dhe III.2.A. Pas konstatimit të mbetjeve urbane kontraktori duhet të kryejë transportin e tyre në vendet e asgjësimit, në pika e grumbullimit të mbetjeve urbane. Në vendosjen e këtij kriteri është patur parasysh edhe fakti i trajtimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve, pasi objekt i këtij prokurimi janë germimet, mbushjet, transportim mbeturinave etj, në të cilën kërkohet evitimi i reziqeve për jetën për të cilën është e domosdoshme licenca lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL. Kodi III.2.B dhe III.2.A. Ndersa licenca III.7.A është kërkuar për sigurimin mjedisor pasi bëhet fjalë për pusët e ujit të pijshëm i cili do të furnizojë një qytet të tere.

Per sa i perket pjeses ku ju citoni se: 2. *Operatori ekonomik duhet te kete pjese te stafit te punesuar – Teknik Ndertimi – Teknik elektrikist – Teknik mekanik – Teknik Hidraulik si dhe Elektracist – Hidraulik – Mekaniketj, ju sqarojme si me poshte vijon:*

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kontratës në mbështetje të Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 óPër prokurimin publikô, Neni 46, pika 1, si dhe në mbështetje të germës (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar).

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të gërmes óbô, të pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për óProkurimin publikô, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën”si dhe në VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô (e ndryshuar), Neni 26, pika 8, gërma óbôku citohet se: ódëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/oseë ô

Numri i punonjësve/specialistëve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi si dhe grafikut të punimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Është vendosur ky numër punonjësish/specialistësh referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit dhe si dhe

afatit të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2015
ôPer miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre janë mbledhur të gjithë orët e punës të puntorisë për të gjithë zërat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numurin e punonjësve/specialistëve.

Gjithashtu numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojat e ngashme, gjë që i shërben Autoritetit Kontraktor përtë njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Per sa i përket pjesës ku ju citoni se: *OE ofertues duhet të ketë në stafin e tij gjithashtu të pakten: 1 (një) Ekspert të auditimit të energjisë (me certificate perkatese).....* ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr.124/2015 ôPër eficientësinë e energjisëô i cili përcakton se Auditimet energjitike të detyrueshme kryhen: b) çdo herë përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objekte të tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm. operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë një auditues energjie me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për konsumin e energjisë në objektin që do rikonstruktohet, identifikimin dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të eficientësisë së energjisë etj.

Gjithashtu sqarojmë se linjat e ujesjellesit do kalojnë neper rrugë, trotuare dhe do futen në hyrjet e pallateve, ku gjatë kësaj rrugë duke qenë se Laci nuk ka një instalim të ri, gjatë punës mund të preken kabolla elektrik etj gjë që është e nevojshme që OE të ketë *1 (një) Ekspert të auditimit të energjisë*.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE:

Lidhur me tenderin me objekt: ôNdërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitô viti 2020, ju sqaron si më poshtë vijon:

1.Në lidhje me pikën b. ku ju shpehëni se: *Operatori Ekonomik “SE.” shpk & “E.” shpk nuk e ka plotësuar saktë shtojcën (Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur) pasi nuk ka bërë check, duke mos klikuar asnjë nga alternativat respektive të sajë* ë ë sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qëndron, pasi referuar Shtojcave që të dy OE kanë paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, vërtetohet se pika 6 e shtojcës është plotësuar në rregull nga OE duke zgjedhur vetëm njerën alternativë. (Për më shumë informacion bashkëlidhur keni shtojcat e plotësuarat nga të dy operatorët ekonomik).

2.Në lidhje me pikën ku ndër të tjera ju shpehëni se: ôOperatori ekonomik “SE. dhe “GP.” SHPK kanë paraqitur listepagesa për vule elektronikeôë ë .. sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qëndron, pasi në sistemin e prokurimit elektronik OE ôSE.ô shpk ka paraqitur Vërtetimin Nr.T01...1, datë 28.03.2020, vërtetim i cili është me vule elektronike dhe i njerre nga sistemi. Gjithashtu ka paraqitur edhe listepagesat të cilat janë me vule elektronike. Po kështu edhe OE ôGPGô shpk ka paraqitur Vërtetimin Nr.T02...9, datë 01.05.2020, vërtetim i cili është me vule elektronike dhe i njerre nga sistemi si dhe ka paraqitur listepagesat të cilat janë me vule elektronike. Për ta vërtetuar vërtetimet dhe listepagesat me vula elektronike i keni bashkëlidhur.

3.Në lidhje me pikën ku ju shpehëni se: ôOperatori ekonomik nuk duhet të ishte kualifikuar pasi AK ka kërkuar që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi profesional, nderkohe që e ka kualifikuar OE edhe pse i ka paraqitur punonjësit vetëm me dëshmi sigurimi teknik, 25 nga të cilët nuk përmbajnë vulën e leshuesitôë ë ë ë ë sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi së pari sqarojmë se në DST Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që punonjesit të kenë deshmë kualifikimi, kontratë pune dhe të figurojnë në listepagesa. Ku sqarojmë se OE për punonjesit ka sjellë Kontratën e punës të vlefshme, Deshmë Kualifikimi si dhe listepagesat në të cilën figurojnë punonjesit.

Së dyti sqarojmë se në sistemin e prokurimit elektronik BOE ka paraqitur Deshmë Kualifikimi të vlefshme për punonjesit, deshmë të cilat i keni bashkelidhur.

4. Në lidhje me pikën ku ju shpehni se: “*Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për Inxhinier Menaxhim Projektshë*” ë ë ë ë .sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi OE ka paraqitur për Inxhinier Menaxhim Projektshë Zj E. S. , për të cilën ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Kontratë Punë, Diplome dhe CV të cilat i keni bashkelidhur.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pikës të kundështimeve të bëra nga NJP ato nuk merren në konsideratë, për të njëjtat argumente të cilësuar në aktkonstatimi dhe Projektraport, ndërsa për kundështimet e bëra nga KVO pikën 2 dhe 3 kundështimi është marrë në konsideratë duke bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ndërsa nuk është marrë në konsideratë për pika 1 dhe 4, për të njëjtat argumente të cilësuar në aktkonstatim dhe Projektraport.

Kundështimet merren pjesërisht në konsideratë.

-Për procedurën e prokurimit me objekt 0Hapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimit, dërguar me shkresën nr. 266/5, datë 11.10.2021, nga NJP e përbarë nga B.N. , J. E. dhe G. M. dhe KVO e përbërë nga D. A. , A.Rr. dhe T. P. , duke kundështuar si vijon:

NJËSIA PROKURIMIT

Për sa i përket pjesës ku ju citoni se: 1. *Licensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

- *Licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL Kodi III.2.A*
- *Licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL Kodi III.2.B*
- *Licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL Kodi III.7.Aë ë ë* ju sqarojmë si me poshtë vijon:

Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 46 0Kualifikimi i ofertuesve, pika 1, gërma 0a 0e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 0Për prokurimin publik, i ndryshuar, ku përcaktohet: 0Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) *kualifikimi profesional: çdo operator ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*”

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve për të cilën është e domosdoshme licenca me kategori III.2.B dhe III.2.A. Pas konstatimit të mbetjeve urbane kontraktori duhet të kryejë transportin e tyre në vendet e asgjësimit, në pika e grumbullimit të mbetjeve urbane. Në vendosjen e këtij kriteri është patur parasysh edhe fakti i trajtimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve, pasi objekt i këtij prokurimi janë gërmimet, mbushjet, transportim mbeturinave etj, në të cilën kërkohet evitimi i rreziqeve për jetën për të cilën është e domosdoshme licenca lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL. Kodi III.2.B dhe III.2.A. Ndërsa licenca III.7.A është kërkuar për sigurimin mjedisor pasi bëhet fjalë për pusët e

ujit te pijshem i cili do te furnizoje nje qytet te tere.

Per sa i perket pjeses ku ju citoni se: 2. *Operatori ekonomik duhet te kete pjese te stafit te punesuar – Teknik Ndertimi – Teknik elektrikist – Teknik mekanik – Teknik Hidraulik*, ju sqarojme si me poshte vijon:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për realizimin e kontratës në mbështetje të Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 për prokurimin publik, Neni 46, pika 1, si dhe në mbështetje të germës (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar),

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të germës ob, të pikës 1 të nenit 46 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publik, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën*” si dhe në VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar), Neni 26, pika 8, gërma oboku citohet se: *“dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose .o*

Numri i punonjësve/specialistëve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi si dhe grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Është vendosur ky numër punonjësish/specialistësh referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit dhe si dhe afatit të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2015 për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre janë mbedhur të gjithë orët e punës të puntorisë për të gjithë zerrat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numurin e punonjësve/specialistëve.

Gjithashtu numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojat e ngashme, gjë që i shërben Autoritetit Kontraktor përtu njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Per sa i perket pjeses ku ju citoni se: *OE ofertues duhet te kete ne stafin e tij gjithashtu te pakten: 1 (një) Ekspert te auditimit te energjise (me certificate perkatese).....* ju sqarojme si me poshte vijon:

Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr.124/2015 për efikasitetin e energjisë i cili përcakton se Auditimet energjitike të detyrueshme kryhen: b) çdo herë përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objekte të tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm. operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë një auditues energjie me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për konsumin e energjisë në objektin që do rikonstruktohet, identifikimin dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë etj.

Gjithashtu sqarojme se linjat e ujesjellesit do kalojnë neper rruge, trotuare dhe do futen ne hyrjet e pallateve, ku gjate kesaj rruge duke qene se Laci nuk ka nje instalim te ri, gjate punes mund te preken kabolla elektrik etj gjë që është e nevojshme që OE të ketë 1 (një) Ekspert të auditimit të energjisë.

Per sa më sipër observacioni i bërë nga Njësia e Prokurimit kërkojmë të merret parasysh.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE:

Lidhur me tenderin me objekt: *óHapja e pus-shpimeve bashke me linjat transnetuese per furnizimin me ujë te qytetit te Lacit si dhe ndertimi i stacionit te pompimitô, ju sqaron si më poshtë vijon:*

1.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *Operatori Ekonomik ka deklaruar pune ne process ne Bashkine Kurbin, Tirane dhe Shijak por nuk ka paraqitur vertetim te taksave vendore*”
ë ë ë sqarojmë se:

Ky konstatim nuk qendron, pasi referuar DST dhe Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për óProkurimin publikô, i ndryshuar ne si KVO kemi verifikuar dokumentacionin ne sistemin e prokurimit elektronik bazuar ne ekstraktin Historik qe OE ka paraqitur. Sqarojme se OE per adresat qe ka te pasqyruara ne Ekstraktin Historik ka paraqitur vertetim per taksat vendore sipas kerkesave te percaktuara ne DST.

2.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óOperatori ekonomik per Teknik Mekanik i mungon IQTôë ë .. sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE óSE.ô shpk ka paraqitur per Teknik Mekaniz Z. R. M. , per te cilin ka paraqitur dokumentacion si Kontrate, Deshmi Kualifikimi IQT, CV, Libreze Pune, Certificate Trajnimi (Dokumentacion te cilin e keni bashkelidhur).

3.Në lidhje me piken ku nder të tjera ju shpeheni se: *óOperatori ekonomik “SE. dhe “GP.” SHPK kane paraqitur listepagesa pa vule elektronikeôë ë .. sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi ne sistemin e prokurimit elektronik OE óSE.ô shpk ka paraqitur listepagesat te cilat jane me vule elektronike. Per ta vertetuar listepagesat me vula elektronike i keni bashkelidhur.

4.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *óOperatrori ekonomik nuk duhet te ishte kualifikuar pasi AK ka kerkuar qe punonjesit te jene me deshmi kualifikimi profesionale, nderkohe qe e ka kualifikuar OE edhe pse i ka paraqitur punonjesit vetem me deshmi sigurimi teknik, 14 nga te cilet nuk permbajne vulen e leshuesitôë ë ë ë ë sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi së pari sqarojmë se në DST Autoriteti Kontraktor ka kërkuar qe punonjesit te kene deshmi kualifikimi, kontrate pune dhe te figurojne ne listepagesa. Ku sqarojme se OE per punonjesit ka sjelle Kontratat e punes te vlefshme, Deshmi Kualifikimi si dhe listepagesat ne te cilen figurojne punonjesit.

Së dyti sqarojmë se në sistemin e prokurimit elektronik BOE ka paraqitur Deshmi Kualifikimi te vlefshme per punonjesit, (deshmi te cilat i keni bashkelidhur).

5.Në lidhje me pikën ku ju shpeheni se: *“Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion provues per Inxhinier Menaxhim Projekteshë ë ë ë ë .sqarojmë se:*

Ky konstatim nuk qendron, pasi OE ka paraqitur per Inxhinier Menaxhim Projektesh Zj E. S., per te cilen ka paraqitur ne sistemin e prokurimit elektroinik Kontrate Pune, Diplome dhe cv te cilat i keni bashkelidhur.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pikës të kundështimeve të bëra nga NJP ato nuk merren në konsideratë, për të njëjtat argumente të cilësuar në aktkonstatimi dhe Projektraport, ndërsa për kundështimet e bëra nga KVO pikën 3 dhe 4 kundështimi është marrë në konsideratë duke bërë ndryshimet përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ndërsa nuk është marrë në

konsideratë për pikat 1, 2 dhe 5, për të njëjtat argumente të cilësuar në aktkonstatim dhe Projektraport.

Kundërshtimet merren pjesërisht në konsideratë.

- ***Mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në objektin: “Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të Brendshëm të qytetit Laç, Faza II”, Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Kurbin.***

Kontratat.

- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 101/13 Prot, datë 23.06.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor UK Sh.A. Kurbin, të përfaqësuar nga Titullari Z. A.P. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë óSe.ô SHPK & óEg.ô SHPK & óGP. Companyô SHPK , të përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë i këtij BOE, Z. E. S. i OE óSe.ô SHPK, me licencë NZ....22z. R. D. i OE óEg.ô SHPK dhe P. B. i OE óGPG Companyô SHPK. Vlera e kontratës është 436,431,509 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 730 ditë, nga data e fillimit të punimeve.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata me nr. 158/14 prot, datë 03.07.2020 me OE óEr.-Gô SHPK, përfaqësuar nga z. G. I. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1015/12. Vlera e kontratës për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar në shumën prej 4,125,474 lekë me TVSH.

Projektpreventivi

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria óE.ô Shpk në vitin 2019 dhe projekti i zbatimit i administruar në dosje nuk është nënshkruar, vulosur nga Titullari i AK.

Në dosje administrohet leje infrastrukture nr. 6, datë 03.03.2020, dhënë nga Bashkia Kurbin për objektin óNdërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të Brendshëm të qytetit Laç, Loti Iô, i cili i përket të gjithë projektit në tërësi, si dhe shkresa e UKK nr. 205, datë 14.7.2021, drejtuar grupit të auditimit, nga ku sqarohet se me vendimin nr. 35, datë 08.10.2019 të Këshillit Teknik të AKUM, është miratuar i tërë projekti në vlerën prej 938,836,986 lekë, ku përfshihen pusët, stacionet e pompimit, depot, rrjeti shpërndarës dhe vetëm realizimi është ndarë në dy pjesë nga ku 500 milion janë deleguar bashkisë dhe 438,836,986 lekë UKK. Për këtë fazë të zbatimit të projektit UKK duhet të kishte kërkuar nga Bashkia Kurbin, rishikimin e lejes nr. 06, datë 03.03.2020,.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Aktdorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë bërë më datë 03.07.2020.

Në aktdorëzimin e sheshit të ndërtimit, citohet që sheshi i ndërtimit është i lirë dhe shoqëria sipërmarrëse e merr në dorëzim, për realizimin e punimeve.

Në dosjen teknike administrohen 4 kërkesa për pagesë për 4 situacione, urdhër shpenzimet:

1. Situacioni 1, datë 20.07.2020, me vlerë 73,162,560 lekë me TVSH, USH nr. 2, datë 20.07.2020
2. Situacioni 2, datë 05.10.2020, me vlerë 18,060,228 lekë me TVSH, USH nr. 57, datë 06.10.2020
3. Situacioni 3, datë 24.12.2020, me vlerë 36,544,609 lekë me TVSH, USH nr. 67, datë 28.12.2020
4. Situacioni 4, datë 08.03.2021, me vlerë 20,000,100 lekë me TVSH, USH nr. 1, datë 11.03.2021.

Nga sa sipër, janë situacionuar 147,767,868 lekë me TVSH, ose 33.8 % e vlerës së plotë të kontratës.

Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë librezë masash, në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, Kapitulli I, pika 3.3 Situationet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Përsa sipër, mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. G. I. dhe përgjegjësi i Financës z. G. M.*

Në dosjen teknike, grafiku i punimeve të ofertës fituese, është i paqartë, pasi nuk janë shënuar periudhat kur do të realizohen zërat e ndryshëm të punimeve. Nisur nga sa sipër, nga ana e grupit të auditimit nuk mund të jepet një vlerësim i saktë i realizimit të punimeve sipas grafikut.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivit bazë,
2. Situationet pjesore,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve me objekt: <i>“Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laç, Faza II”, UK Kurbin</i>				
14. Lidhja e kontratës Nr. 101/13 Prot, datë 23.06.2020	15. Vlera e kontratës 436,431,509 lekë me Tvsh BOE fitues së ShPK & Egl. ShPK & GP. Comp. ShPK		16. Likuiduar: 147,767,868 lekë me tvsh në 5% garanci bankare	
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 730 ditë. Në proces.		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve Er.-G ShPK	Licenca Nr: MK. 1015/12	Kontrata nr. 158/14 prot, datë 03.07.2020		

Punimet në këtë objekt janë në proces dhe grupi i auditimit nuk mund të shprehet për diferenca në volume. Për pasojë, auditimi i zbatimit të punimeve do të bëhet në një fazë të mëvonshme.
Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 1 datë 16/07/2021 dhe për këtë çështje subjekti nuk ka paraqitur observacion.

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

1. Titulli i Gjetjes:	Problematika të konstatuara në sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit në UK Kurbin.
Situata	Nga verifikimi i iniciativave të ndërmarrja nga UK Kurbin për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, u konstatuan mangësi të konsiderueshme mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si në aspekt të perceptimit të përgjegjësive menaxheriale sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,</i> i ndryshuar dhe Manualit të MFK, ashtu edhe në drejtim të hartimit dhe miratimit të dokumentacioneve të nevojshme. Shkak për këtë, është edhe mos përfshirja nën monitorim të shoqërive aksionare nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, problematikë kjo e

	përcjellë për disa vite radhazi nga KLSH nëpërmjet rekomandimeve përkatëse në auditimet e zhvilluar pranë kësaj drejtorie . Më hollësisht: -nukrezulton të jetë hartuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE Pyetësoi i Vetëvlerësimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Deklarata e Cilësisë dhe Raporti përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshëm. - nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskeve për përcaktimin e planit të punës dhe strategjisë që do të ndiqet për adresimin e risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave institucional dhe as regjistri i risqeve apo grupe për menaxhimin e riskut. -nuk rezulton të jetë ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), apo koordinatori i riskut dhe MFK -rregullorja aktuale e UK Kurbin, edhe pse në aktet vendimmarrëse për miratimin e saj citohet si një rregullore e brendshme, faktikisht ajo ka për qëllim sigurimin e marrëdhënieve mes konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtij shërbimi, pra nuk është një rregullore e brendshme e funksionimit të UK Kurbin; -nuk rezulton të jetë hartuar dhe miratuar Kodi Etik dhe nuk janë përfshirë çështje të etikës në aktet të tjera rregullatore të institucionit; -nuk rezulton të jetë hartuar plani i aktivitetit për të detajuar objektivat strategjik, vjetor, prioritetet dhe planet e veprimit; -nuk rezulton të ketë kryer asnjë trajnimpër periudhën nën auditim, si dhe nuk disponohet asnjë plan dhe regjister për kryerjen e trajnimeve të stafit. Si rezultat, nuk janë hartuar module trajnimi edhe mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rëndësinë e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm; -nuk rezulton të jetë kryer monitorim të veprimtarisë institucionale për periudhën objekt auditimi, në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj; konstatohet mungesa e raporteve periodike për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete për adresimin e tyre.; -nuk janë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK; -nuk janë hartuar gjurmët e auditimit me qëllim identifikimin e proceseve kyçeve të njësive dhe dobësive; -nuk janë parashikuar nga Administratori i shoqërisë rregulla për delegimin e detyrës ; -nuk disponohet një ëeb faqe zyrtare e shoqërisë për publikimin e informacioneve të aksesueshme për publikun; -nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, për detajimin e proceseve në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre; -evidentohet mungesa e një arkive për ruajtjen e dokumentacioneve të shoqërisë; -nuk janë implementuar strategji apo sisteme óback upô për ruajtjen e informacionit dhe dokumentacioneve.
--	---

Kriteri:	Ligji nr.110/2015 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, Manuali i MFK miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 óPër Arkivató si të óNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë për përcaktimin e rregullave për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivoró
Ndikimi/Efekti:	Mangësitë në sistemet e MFK ndikojnë në arritjen e objektivave institucional, vendimmarrjen e përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive në zbatimin e tyre. Cënohet marrja e masave në kohë për përmirësimin e problematikave në sistemet e kontroleve të brendshëm. Nuk garantohet monitorimi i zbatimit të rregullave sipas shtyllave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Shkaku:	Mangësi në hartimin e dokumentacioneve dhe implementimin e kërkesave në përputhje me manualin dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga ana e strukturave drejtuese të shoqërisë.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandime:	1. Administratori i UK Kurbin, në bashkëpunim me strukturat e tjera drejtuese të shoqërisë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar më sipër për të përmbushur detyrimet në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke hartuar aktet e brendshme administrative të nevojshme dhe implementimin e tyre në përputhje me politikave për monitorimin e objektivave dhe përmirësimin e situatës, sipas çështjeve të ngritura më sipër. 2. Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshijë në planet vjetore të vlerësimeve mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, edhe shoqëritë aksionare si Ujësjiellës Kanalizime Kurbin, me qëllim asistimin dhe trajnimin e stafit për kërkesat e ligjit dhe manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Më hollësisht rezultatet e auditimit në lidhje me këtë pikë të programit paraqiten si më poshtë:

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtuan si më poshtë:

- Aktet ligjore dhe rregullatore sipas së cilave funksionon Ujësjiellës Kanalizime Kurbin;
- Struktura organizative;
- Raportet periodike të hartuara nga shoqëria lidhur me veprimtarinë e saj;
- Dokumentacione të tjera sipas shtyllave të kontrollit të brendshëm përcaktuar në Ligjin për MFK dhe Manualin përkatës.

Nga analizimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK) konsiston në hartimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, me qëllim asistimin e menaxherëve në përmbushjen e objektivave, vendimmarrjen e duhur dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre, në fushën e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, prokurimin, kontraktimin dhe organizimin e njësisë. Neni 8 i ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, i

ndryshuar lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale të titullarit të institucionit, përcakton detyrimet dhe kompetencat për:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;

ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;

d) miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre;

dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;

e) futjen e procedurave antikorruption, bazuar në legjislacionin në fuqi;

ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Për sa më sipër grupi i auditimit kreu verifikim mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të ngritura nga Ujësja e Kanalizimeve të Kurbin, sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga ana e subjektit të audituar u vendos në dispozicion vetëm statuti i institucionit, akti themelimi, struktura organizative dhe rregullorja e brendshme e funksionimit të UK Kurbin ku konstatohet se nga subjekti i audituar kishte mangësi të konsiderueshme mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si në aspekt të perceptimit të përgjegjësisë menaxheriale sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar dhe Manualit të MFK, ashtu edhe në drejtim të hartimit dhe miratimit të dokumentacioneve të nevojshme. Shkak për këtë, është edhe mos përfshirja në monitorim të shoqërive aksionare nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, problematikë kjo e përcjellë për disa vite rradhazi nga KLSH nëpërmjet rekomandimeve përkatëse në auditimet e zhvilluar pranë kësaj drejtorie .

-Më hollësisht, për periudhën nën auditim nuk rezultoi të jetë hartuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE Pyetësori i Vetëvlerësimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Deklarata e Cilësisë dhe Raporti përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshëm duke mos zbatuar kërkesat e Nenit 18, i këtij ligji, pika 1 ku citohet se *“Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë vetë vlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i pare autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji;”*. Deklarata e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Raporti për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm duhet të përgatiten në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, *“Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitet publike”*, pika 16 dhe Shtojca 2 e udhëzimit, në të cilat përcaktohet se *“...Raporti duhet*

te strukturohet sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbehet nga: (a) Përmbledhja ekzekutive; (b) Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë; (c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm; Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimin për të ardhmen; (d) Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.”.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu II, neni 8 óPërgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit, pika 2 dhe 8.b dhe neni 9 óPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, germa óçó, nuk rezultojnë të jetë ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), apo koordinatori i riskut dhe MFK sikundër parashikon nenin 21 të ligjit óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreut III, pika 4.2.9 të Manualit óPër MFK, ku përcaktohet se: “Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të veprojë si një komitet, ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut. Ai duhet të këshillojë Nëpunësin Autorizues mbi përmbajtjen e raportit vjetor për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.”.... “Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë....Grupi për Menaxhimin Strategjik përbehet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.”

Mjedisi i Kontrollit

Rregullorja që disponon shoqëria vendosur në dispozicion të grupit të auditimit óRregullorja për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimetó është miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.05.2018 të Këshillit të Administrimit të shoqërisë dhe Vendimin nr.1, datë 28.05.2018 të Asamblesë Aksionere të SH.A Ujësjetës Kanalizime Kurbin, mbështetur në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareó, VKM nr.1304, datë 11.12.2009, dhe statutin e shoqërisë miratuar datë 12.05.2016, neni 14 pika 4. Në vijim, në zbatim të statuti është rishikuar me vendimin nr. 2, datë 13.05.2019 të Asamblesë Aksionare në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 óPër vetëqeverisjen vendoreó, të ligjit nr.115/2014 óPër ndarjen administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisëó, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareó, të ligjit nr. 7926 datë 20.04.1995 óPër transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtareó, i ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016 óPër riorganizim e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaó. Ky dokument ka përcaktuar objektin e shoqërisë dhe kompetencat e përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit, Administratorit, Drejtorit Teknik, Drejtorit Tregtar, në një kohë ku detyrat dhe përgjegjësitë e pjesës tjetër së stafit mbeten të pa rregulluara, në kushtet kur nuk rezultojnë të hartuara dhe miratuara përshkrimet e pozicioneve të punës së tyre.

Sipas manualit të MFK, rregullorja e brendshme e funksionimit duhet të reflektojë të gjithë aspektet e organizimit dhe funksionimit administrativ në institucion, në një kohë ku kjo rregullore, edhe pse në aktet vendimmarrëse për miratimin e saj citohet si një rregullore e brendshme, faktikisht ajo ka për qëllim sigurimin e marrëdhënieve mes konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtij shërbimi, pra nuk është një rregullore e brendshme e funksionimit të UK Kurbin.

Për sa i përket angazhimit të Ujësjetllës Kanalizime Kurbin në hartimin e mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike, në institucion nuk rezulton të jetë hartuar dhe miratuar Kodi Etik, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 20 óMjedisi i kontrollit, pika 2, germa óa dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pika 2.5.1 óMjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësise)ó, si dhe nuk janë përfshirë këto çështje në statutin e shoqërisë. Nga ana e shoqërisë nuk rezulton të jetë hartuar plani i aktivitetit për të detajuar objektivat strategjik, vjetor, prioritetet dhe planet e veprimit në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i ndryshuar, neni 8 óPërgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit, germa óa, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli IV, pika, 4.2.8 óPërgjegjësitë e titullarëve të njësive të sektorit publik, germa óa.

Ujësjetllës Kanalizime Kurbin nuk rezulton të ketë kryer asnjë trajnimpër periudhën nën auditim në kundërshtim me kërkesat e pikës nr. 3/1, nënçështja óPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe nuk disponohet asnjë plan dhe regjistër për kryerjen e trajnimeve të stafit. Si rezultat, nuk janë hartuar module trajnimi edhe mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rëndësinë e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

Raportimi

Nga auditimi konstatohet se Ujësjetllës Kanalizime Kurbin nuk rezulton të ketë kryer monitorim të veprimtarisë institucionale për periudhën objekt auditimi, në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj. Konstatohet mungesa e raporteve periodike për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete për adresimin e tyre. Disa prej raporteve të hartuara mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve; apo mbi shitjen e ujit, nuk rezultojnë të kryejnë analiza krahasimore me periudhat e mëparshme apo me nivelet e planifikimit për të konkluduar kështu mbi arsyet e mos realizimit, apo mbi çështje të tjera sipas rastit. Gjithashtu, evidentohet nevoja për përcaktimin e mënyrës së raportimit, formatet, periodicitetin e raportimit, treguesit e performancës, si dhe mënyrën se si informacioni duhet të shpërndahet në të gjitha nivelet shoqërisë.

Menaxhimi i Riskut

Ujësjetllës Kanalizime Kurbin nuk ka hartuar Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve në kundërshtim me nenet 8, pika 8.a, 10 dhe 21, pika 2, të ligjit nr. 10296 dhe kreun III, pika 3.2 të Manualit të MFK, për përcaktimin e planit të punës dhe strategjisë që do të ndiqet për adresimin e risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave institucional. Gjithashtu, shoqëria rezulton të mos ketë hartuar regjistrin e risqeve për periudhën auditim duke mos zbatuar kërkesat e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar. Nuk rezultojnë të jenë krijuar grupet e menaxhimit të riskut.

Aktivitetet e Kontrollit

Aktivitetet e kontrollit konsistojnë në politikat, procedurat dhe përgjegjësitë që duhet të përcaktuar për minimizimin e riskut të mosrealizimit të objektivave institucional. Nuk rezultojnë të jenë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK si kërkesë e pikës 3.3, të manualit të MFK. Harta e proceseve të punës dhe manuali i procedurave

të brendshme, ka si objektiv përcaktimin e qartë të detyrave, ndarjen e tyre, si dhe përshkrimin e pozicionit të punës, në përputhje me Ligjin nr. nr.10 296, datë 8.7.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar , në funksion të realizimit të aktivitetit të Ujësjiellës Kanalizime Kurbin në përputhje me objektivat dhe misionin e saj. Nga auditimi konstatohet se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit me qëllim identifikimin e proceseve kyçe të njësive dhe dobësive, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III. Nuk janë parashikuar nga Administratori i shoqërisë rregulla për delegimin e detyrës në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Kapitulli III óDelegimi i detyrave, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Informim Komunikimi

Informim komunikimi konsiston në vlerësimin se njësia publike disponon informacion të duhur, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm. Konstatohet se në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar linjat e brendshme të komunikimit, parimet bazë dhe procedurat e komunikimit. Në rregulloren e brendshme nuk rezulton të jetë reflektuar gjurma që do të ndiqet për informimin që përgjegjësit e drejtorive i bëjnë Administratorit me anë të takimeve, relacioneve apo raportimeve të ndryshme. Konstatohet gjithashtu mungesë transparence si rezultat i mos publikimit të dhënave pasi nuk disponohet një ëeb faqe zyrtare e shoqërisë. Komunikimi në institucion kryhet në adresat personale, pasi nuk disponohet adresa e-mail-i zyrtar i shoqërisë.

Monitorimi

Procesi i monitorimit të njësisë konsiston në vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm sipas nevojës, me qëllim mirëfunksionimin e tyre. Konstatohet se nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, për detajimin e proceseve në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre. Nuk është përcaktuar detyrimi për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet një dokumenti të mirëfilltë duke cënuar performancën e këtyre sistemeve, ku si shembull mund të përdoret metodologjia e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 117, datë 01.04.2019. Në raportet e kryera të raportimit mbi situatën ekonomike financiare të shoqërisë nuk rezultojnë të jenë përgatitur relacione shpjeguese që tregojnë mospërputhjen e treguesve të realizuar me planin, shpjegimet për rialokimet e kryera nëpërmjet zërave, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës.

Në Ujësjiellës Kanalizime Kurbin evidentohet mungesa e një arkive për ruajtjen e dokumentacioneve, duke rezultuar në kundërshtim me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 óPër Arkivat si të óNormave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë për përcaktimin e rregullave për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivorë. Të gjitha të dhënat në bazën e të dhënave duhet të ruhen në një ambient të dytë në mënyrë që të garantohet rikthimi i të dhënave në gjendjen e mëparshme në rast humbjeje ose shkatërrimi.

Lidhur me procedurat për ruajtjen e informacionit, nuk janë implementuar strategji apo sisteme back up.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Për sa më sipër konstatojmë mangësi të konsiderueshme në sistemet e kontrollit të brendshëm të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga ana e shoqërisë për përmirësimin sipas shtyllave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Këto dobësi ndikojnë në arritjen e objektivave institucional, vendimmarrjen e përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive në zbatimin e tyre. Si rezultat, cënohet marrja e masave në kohë për përmirësimin e problematikave në sistemet e kontrolleve të brendshëm dhe nuk garantohet monitorimi i zbatimit të rregullave sipas shtyllave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e juristit të institucionit, Drejtorit Teknik, tre faturistë të fshatrave; dhe gjashtë punëtorë, ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 punëtorë kolektori, 1 sanitare, 1 punëtor mirëmbajtje, 3 manovratorë saraçineskash, 2 elektropompist 1 Laç dhe 1 në Mamurras.

-Për vitin 2019, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e Drejtorit Teknik; 3 faturistëve; 1 Përgjegjës Stacioni Pompe Laç, si dhe 7 punëtorëve, ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar, 1 hidraulik, 1 saldator, 1 sanitare, 1 punëtorë Kolektori, 4 Manovratorë dhe Klorifikues (nga 26 që duhet të jenë në fakt janë 31), 1 Elektropompist.

-Për vitin 2020, pavarësisht se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në total, vërehen mangësi dhe devijime nga struktura dhe konkretisht janë evidentuar mungesa e Drejtorit Teknik, 1 Inxhinieri; 4 faturist; 1 përgjegjës stacion; 1 përgjegjës depo; 1 hidraulik dhe 1 elektropompist; ka rezultuar se janë emëruar jashtë strukturës së miratuar 4 punëtorë, 1 sanitare dhe 1 manovrator glorifikues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administratori i UK Kurbin të marrë masa për ri shqyrtimin e nevojave për pozicionet e shtuara në strukturë dhe propozimin e tyre për miratim pranë Këshillit Administrativ, duke shmangur emërimet e punonjësve në pozicione pune të pa miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhjen 2 të nivelit të pagave të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 3, datë 23.01.2018 óPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Sh.a Ujësjellës Kanalizime Kurbinô, nuk pasqyrohet niveli i pagave për pozicionet arkiviste dhe arkëtare, pavarësisht se këto pozicione janë të miratuara në strukturë. PAGESA për këto 2 pozicione është bërë në nivelin e pagës së krye-arkëtares. Po kështu edhe për pozicionin e punëtorit të kolektorit nuk është përcaktuar niveli i pagës dhe pagesa për këtë pozicion është bërë në pagën minimale në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 óPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveô dhe neni 13, pika 1, e

Statutit të Ujësjetllës Kanalizime SHA Kurbin miratuar me Vendim nr. 2, datë 12.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Administrativ i UK të marrin masa për shqyrtimin dhe miratimin e qartë të nivelit të pagave për çdo pozicion specifik në strukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Administratori i UKK ka lidhur Kontratë Pune me nr. 513, datë 03.10.2019, me znj. Sh.G., në pozicionin Mjeke e Përgjithshme, emërim i kryer pa procedurë rekrutimi dhe pa miratim të Këshillit Administrativ për përcaktimin e nivelit të pagës, veprime në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve dhe neni 13, pika 1, të Statutit të UKK miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 2, datë 12.05.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Administratori i UK Kurbin të marrë masa për propozimin për miratim pranë Këshillit Administrativ të nevojës së punësimit të mjekut të ndërmarrjes dhe përcaktimin e nivelit të pagës, duke ndjekur të gjitha hapat e duhura për njoftimin dhe rekrutimin për këtë pozicion.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në listë-pagesat dhe listë-prezencat e UKK, merret gjithmonë si referencë 21 ditë pune në muaj dhe jo 22 ditë. Ky veprim nuk ka efekt financiar gjatë përlllogaritjes së pagës mujore me përjashtim kur pagesa për një punonjës nuk bëhet për ditët e plota të muajit (p.sh. punonjësi merr raport mjekësor, fillon punë në një ditë të caktuar të muajit, etj.) dhe si pasojë përpjesëtimi i ditëve të punës nuk bëhet i saktë, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore i ndryshuar, kreu I, neni pikat 1-3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa që në përlllogaritjen e pagave në rastet e mos pagesës së plotë mujore, të zbatojë përcaktimet ligjore për numrin mesatar të ditëve të punës prej 22 ditë. Ky përcaktim të zbatohet edhe nga personat përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e listë-prezencave pranë Sektorit të Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që vjetërsia në punë është paguar vetëm për punonjësit të cilët janë me arsim të lartë në UKK, ndërsa punonjësit e tjerë nuk e kanë përfituar këtë të drejtë, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, të Kodit të Punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për përfshirjen e vjetërsisë për secilin punonjës në përlllogaritjen e pagave.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Ngjarjet dhe veprimet ekonomike, si regjistrimet kontabël, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen manualisht, pasi institucioni nuk ka të instaluar një program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e

dokumentit elektronik, për ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të saj, në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 óPër dokumentin elektronikó, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të ruhet dhe garantohet siguria e informacioneve të saj, UKK të marrë masa për përdorimin e programeve financiare në mbajtjen dhe regjistrimin e veprimeve kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e pasqyrave financiare nuk përfshihet óFormati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagaveó, duke mos paraqitur zyrtarisht informacionet mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave si numri mesatar i punonjësve, ndryshimin e këtij numri gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblimet e tjera, ndihmat shoqërore, kontributet për sigurimet dhe tatimet mbi të ardhurat personale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Sektori i financave të marrë masa që në vijimësi pasqyrat financiare të hartohen në mënyrë të plotë, duke pasqyruar informacion mbi çdo element të aktivitetit të shoqërisë siç kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Përgjatë të gjithë periudhës objekt auditimi rezulton se në grupet e punës të ngritura për inventarin e magazinës dhe aseteve të shoqërisë në fund të vitit, është pjesë edhe magazinieri i shoqërisë, në kundërshtim me paragrafin 99 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në NJSPó, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Administratori i UK të marrë masa që në të ardhmen të mos përfshijë në grupin e punës për procesin inventarizues magazinierin e shoqërisë i cili ka në ngarkim mallrat.

Në çdo proces inventarizues

9. Gjetje nga auditimi: Për të tre vitet, nuk janë pasqyruar saktë vlerat sa i takon klientëve debitorë nga furnizimi me ujë dhe të ardhurat e arkëtuara si vijon:

Për vitin 2018

Zëri óTë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimitó (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 135.351.480 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjó paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 169.820.541 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 44.588.799 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimit rezulton se vlera e të ardhurave është 57.464.730 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Për vitin 2019

Zëri óTë drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimitó (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 142.247.887 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë óKlientë debitor, familjar, privat, etjó paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 181.310.336 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 42.396.568 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimit rezulton se vlera e të ardhurave është 45.650.151 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Për vitin 2020

Zëri 6Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit (debitorë nga shërbimi i furnizimit me ujë) paraqitet në vlerën 149.428.475 lekë, ndërkohë që rezulton se në evidencën përmbledhëse të llogarisë 6Klientë debitor, familjar, privat, etj paraqitur nga ekonomisti i shërbimit ndaj klientit, është në vlerën 192.779.329 lekë.

UKK ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 38.809.129 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimit rezulton se vlera e të ardhurave është 40.445.970 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, 6Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Sektori i financës të marrë masa që në të ardhmen të rakordojë dhe pasqyrojë me vërtetësi dhe saktësi vlerat sipas të dhënave të gjeneruara nga sektorët dhe regjistrimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, në zërin 6Toka dhe ndërtesa në vlerën 27.240.574 lekë pasqyrohet vetëm vlera e ndërtesës, pasi UKK nuk ka të regjistruar në regjistrin e aseteve tokat në të cilat ushtron veprimtarinë e saj. Kjo situatë është trashëguar edhe në vitet në vijim. Në vitin 2018, UKK ka kryer me topografin e Bashkisë Kurbin matjet për stacionet e pompimit dhe rezervuarët, nga të cilat në ZVRPP përkatëse kanë rezultuar në pronë shtetërore. Në vijim janë ndjekur procedurat përkatëse për regjistrimin e tyre në pronësi të UKK, por deri në momentin e përfundimit të auditimit nuk është finalizuar ende ky proces, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018, 6Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit të shoqërisë të marrin masa për nxitjen e përshpejtimit të procesit të regjistrimit të pronave të UK Kurbin. Për këtë qëllim të kërkohet edhe angazhimi i aksionarit të vetëm të shoqërisë, Bashkisë Kurbin.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në zërin detyrime afatshkurtra, UKK pasqyron edhe detyrimet e prapambetura që ka akumuluar nga mos likuidimi i energjisë elektrike që nga viti 2015, të cilat me përjashtim të atyre të periudhës ushtrimore duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata, veprim në kundërshtim me SNK 1, paragrafi 69.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Në hartimin e pasqyrave financiare, sektori i financës të marrë masa për sistemimin e llogarive të detyrimeve sipas periudhave të akumulimit të tyre dhe pasqyrimin e saktë të këtyre zërave në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga organet drejtuese të UKK nuk është kryer asnjëherë analizë në lidhje me llogaritë debitoare-kreditore, për të cilat rezulton se gjendja, evidentimi, ndjekja dhe

arkëtimi paraqitet problematike, pasi nuk janë konsumuar të gjitha rrugët për vjeljen e tyre deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. UKK nuk ka marrë masa as për analizimin dhe veçimin e vlerave të debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe zgjidhjen e kësaj situatë. Në fund të vitit 2019, UKK nuk ka marrë masa për likuidimin e një pjese të detyrimeve edhe pse ka patur gjendje monetare në vlerën 7.277.546 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, óPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtareô, i ndryshuar dhe neni 8 dhe 9 të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinô, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKK të merret në analizë të vazhdueshme situata lidhur me gjendjen debitorë dhe kreditorë, të realizohet një plan konkret masash për të përmirësuar treguesit financiarë të shoqërisë, si dhe të merren masa për përcaktimin e kriterëve të qarta në përzgjedhjen e debitorëve për dërgim në përmbarrim për arkëtim të detyrueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 Administratori nuk ka marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit dhe kryerjen e këtij procesi për aktivet e shoqërisë, në kundërshtim me pikën 80-101 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 59-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e plotë të procesit të inventarizimit për çdo vit për të gjitha aktivet që ka dispozicion duke krijuar komisionet përkatës për realizimin e këtij procesi.

Në mbyllje të çdo viti ushtrimor

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 dhe 2021 UKK, nuk ka hartuar apo miratuar programet ekonomiko-financiare vjetore dhe nuk ka reflektuar ndryshimet e tyre (sipas rasteve kur ka patur ndryshime), duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareô, të shkronjave óaô e óbô, të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, óPër organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendoreô, të ndryshuar, për zbatimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit. Shoqëria është mjaftuar vetëm me plan biznesin 5 vjeçar 2019-2024, dokument ky që nuk ka përfshirë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit, por vetëm për vitin 2019. Për këtë periudhë konstatohet se nga ana e Administratorit nuk është hartuar urdhri për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektprogrameve si dhe nuk janë dërguar, pranë Këshillit të Administrimit të UK Kurbin dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

- Në programin ekonomiko financiar të vitit 2018 dhe plan biznesin 2019-2024 nuk janë përfshirë në këtë plan investimet e realizuara faktikisht, ku përmendim këtu projektin óNdërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Laçô, për shkak se këto dokumentacione nuk janë rishikuar në vijim për të shoqëruar ato me relacione shpjegues të faktorëve që nuk kanë mundësuar parashikimin e tyre në program sipas rastit, në mënyrë që të pasqyrohet domosdoshmëria e kryerjes investimeve të paparashikuara; tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve në raport me shpenzimet e tjera.

Udhëzimi nr. 15, datë 02.05.2018 ôMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorô në kapitullin I të tij parashikon procesin e hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik, detyrim ky i të gjitha shoqërive publike me kapital shtetëror për periudha 1 vjeçare, afatmesme dhe afatgjata. Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të mbështetet në objektivat e caktuara nga organet drejtuese dhe Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2019-2030 dhe 2020-2030 dhe të miratohen nga Asambleja Aksionare dhe Këshilli i Administrimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Administratori i UKK të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt programeve për çdo vit, dhe për t'ja dërguar ato Këshillit të Administrimit të UKK dhe Asamblesë Aksionare për miratim.

Në vijimësi

14.2. Rekomandimi:Grupet e punës për hartimin e planeve ekonomiko-financiare, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në planin e biznesit 5 vjeçar të përfshijnë planifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo vit me qëllim përmirësimin e performancës dhe objektivave strategjik dhe vjetor të shoqërisë në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës ã Kanalizime.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi:Raportimi tek organet drejtuese mbi realizimin e treguesve të programit vjetor të zhvillimit ekonomik dhe financiar nuk është kryer në të gjitha rastet sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 ôPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaô, neni 18 pika 7. Në ato raportime të kryera nga ana e Administratorit, jo në të gjitha rastet janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe në asnjë rast nuk rezulton të jenë përfshirë analiza krahasimore me planin financiar për periudhën respektive, shoqëruar me analiza për motivet e mos realizimit. Për vitin 2018 konstatohet se është kryer një raportim vetëm për vlerën totale të tyre, duke mos evidentuar realizimin sipas zërave. Gjithashtu, në raportimet e kryera, informacioni është bazuar vetëm në shpenzimet e kryera bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga vetë shoqëria, duke mos përfshirë në to informacion mbi subvencionet e përfituara, apo detyrimet e pa shlyera të njësisë. Në këto kushte nuk mundësohet monitorimi i realizimit të planit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi:Administratori i UKK të marrë masa për kryerjen e raportimeve mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar mujor dhe vjetor pranë Këshillit Administrativ me informacione të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, për të mundësuar analizimin e të dhënave historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë sipas planit dhe periudhave të mëparshme.

Brenda vitit 2021

16. Gjetje nga auditimi: Financimi nga buxheti i shtetit, nga ana e UKK nuk rezulton të jenë përcjellë pranë institucioneve eprorë projekt propozime për financim të investimeve, apo raportime të kryera si për detyrimet e prapambetura, si dhe për evidencat e shpenzimeve (rakordime periodike me thesarin) për pjesën e financimit nga buxheti i shtetit (kryesisht për investime).

-Drejtoria e Thesarit pranë MFE ka raportuar pagesa për detyrime të prapambetura nga UKK në vlerën 17,846 mijë lekë bazuar në të dhënat e raportuara nga njësitë si shuma të deklaruara që paguara gjatë vitit 2020, në zbatim të strategjisë në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtë, kur nga ana e shoqërisë nuk rezulton të jetë kryer asnjë raportim lidhur me detyrimet e prapambetura pranë Bashkisë apo MIE; dhe në regjistrin e pagesave në SIFQ pagesat për detyrime të prapambetura nga UKK paraqiten në vlerën (zero). Për sa i përket stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit në MFE, dhe raportit vjetor për stokun e detyrimeve të prapambetura të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, UKK në vitin 2019 rezulton ndër institucionet që deklarojnë detyrime të prapambetura, të cilat konkretisht konsistojnë në vlerën 13,986,204 lekë kur sipas pasqyrave financiare ato rezultojnë në vlerën 435,508,393 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 31,832,357 lekë në një kohë ku sipas pasqyrave financiare janë në vlerë 612,388,769 lekë, shifra këto të konsiderueshme krahasuar me buxhetin në dispozicion të kësaj shoqërie, të cilat sikundër vërehet paraqiten në rritje dhe nuk rezultojnë të bëhen pjesë e raportimeve periodike pranë KA, Asamblesë së Përgjithshme apo strukturave të tjera drejtuese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të UK Kurbin, duke përfshirë Administratorin, Këshillin e Administrimit, Asamblenë e Përgjithshme, etj të ngrenë grupe punë për analizimin e detyrimeve të prapambetura; përcjelljen e një informacioni të plotë të vlerës së tyre me qëllim raportimin real të tyre në raportin vjetor të hartuar nga MSHMS për stokun e detyrimeve të prapambetura, dhe hartimin e një plani veprimi dhe shlyerjeje për reduktimin e tyre.

Brenda vitit 2021

17. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit me përfitues UKK konstatohet se përgjatë vitit 2020 ka patur disa rishikime të fondeve buxhetore, konkretisht 4 rishikime për projekte që prekin investimet kapitale me një rritje të fondeve të këtyre projekteve me vlerë prej 52,776 mijë lekë. Sipas Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, pika 79: *Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit*, dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve, referuar edhe vlerës totale të shpenzimeve të kryera në kuadër të investimeve kapitale të UKK, mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime reflektuar edhe nga mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionin epror përgjatë procesit të planifikimit të buxhetit. Gjithashtu, nga kryqëzimi i të dhënave të kontratave të lidhura me përfitues UKK për vitin 2020, me PBA-në e institucioneve qendrore publikuara në jeb-in e MFE, u konstatuan 2 projekte me vlerë totale 12,276 mijë lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, pra plani i pagesave të kontratave për projekte investimesh në PBA e periudhës 2020-2022 për vitin 2020 nuk cilat kanë të përfshirë plan pagesash për këto projekte por përgjatë vitit janë rishikuar fondet për financimin e këtyre kontratave, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020, pika 19. e) e tij. Për rishikimet e kryera më sipër, nga ana e UK Kurbin nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë kërkesë zyrtare pranë institucioneve epre për kryerjen e këtyre ndryshimeve në buxhetet në dispozicion.

- Kontrata e investimit óNdërtimi i rrjetit të jashtëm e të brendshëm ujës-jellës të qytetit Laç faza IIó ka planifikuar kryerjen e shpenzimeve financuar nga buxheti i shtetit në kontratë (pa TVSH), si më poshtë:

Viti 2020 - 87 767 397 lekë; Viti 2021 - 70 000 000 lekë; Viti 2022 - 30 000 000 lekë

Pra në total sipas kontratës në vlerën 438,836 mijë lekë, në harkun 3 vjeçar janë planifikuar për tóu kryer pagesa në vlerë 187,767 mijë lekë (ose 42%); dhe shuma e mbetur e financimit është përcaktuar në vitet në vazhdim. Në kushtet kur faktikisht kontrata parashikon përfundimin e punimeve në harkun kohor 2 vjeçar, ky nivel planifikimi i fondeve i cili po kështu paraqitet edhe në planin buxhetor afatmesëm 3 vjeçar mund të bëhet shkak për krijimin në të ardhmen të detyrimeve të prapambetura. Për këtë projekt, me aktin normativ nr. 34, në datën 23 dhjetor është shtuar niveli i financimit edhe me 40,000,000 lekë, pra rreth 57% të planit të buxhetit që sipas PBA 2020-2022 ishte parashikuar për këtë kontratë në vitin 2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse për hartimin e projekt buxhetit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, në bashkëpunim me AKUK, të marrin masat për rritjen e bashkëpunimit gjatë procesit të planifikimit, dhe ekzekutimit të buxhetit duke bërë palë të këtij procesi edhe njësitë e varësisë përfituese të fondeve publike, në këtë rast UK Kurbin, me qëllim përmirësimin e performancës buxhetore në drejtim të përfshirjes në projektbuxhet të investimeve dhe shmangien e rishikimeve përgjatë vitit me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit, dhe që mund të bëhen shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Gjithashtu, këto struktura, të marrin masat për shmangien në të ardhmen të fenomenit ku planifikimi i fondeve për investime nuk garanton mbulimin e pagesave të pritshme që rrjedhin nga zbatimi i kontratave, referuar edhe periudhës kohore të implementimit të projektit.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Iniciativat e ndërmarrja nga UKK për krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, u konstatuan me mangësi të konsiderueshme mbi sistemet e kontrollit të brendshëm si në aspekt të perceptimit të përgjegjësisë menaxheriale sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, i ndryshuar dhe Manualit të MFK, ashtu edhe në drejtim të hartimit dhe miratimit të dokumentacioneve të nevojshme. Shkak për këtë, është edhe mos përfshirja nën monitorim të shoqërive aksionare nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Më hollësisht:

-Nuk është hartuar dhe përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë MFE Pyetësori i Vetëvlerësimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Deklarata e Cilësisë dhe Raporti përkatës mbi sistemet e kontrollit të brendshëm.

-Nuk është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për përcaktimin e planit të punës dhe strategjisë që do të ndiqet për adresimin e risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave institucional dhe as regjistri i risqeve apo grupe për menaxhimin e riskut.

-Nuk është ngritur dhe të ketë funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), apo koordinatori i riskut dhe MFK

-Rregullorja aktuale e UK Kurbin, edhe pse në aktet vendimmarrëse për miratimin e saj citohet si një rregullore e brendshme, faktikisht ajo ka për qëllim sigurimin e marrëdhënieve mes konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtij shërbimi, pra nuk është një rregullore e brendshme e funksionimit të UK Kurbin;

-Nuk është hartuar dhe miratuar Kodi Etik dhe nuk janë përfshirë çështje të etikës në aktet të

tjera rregullatore të institucionit;

-Nuk është hartuar plani i aktivitetit për të detajuar objektivat strategjik, vjetor, prioritetet dhe planet e veprimit;

-Nuk është kryer asnjë trajnim për periudhën nën auditim, si dhe nuk disponohet asnjë plan dhe regjistër për kryerjen e trajnimeve të stafit. Si rezultat, nuk janë hartuar module trajnimi edhe mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rëndësinë e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm;

-Nuk është kryer monitorim të veprimtarisë institucionale për periudhën objekt auditimi, në përmbushje të misionit dhe detyrave të saj; konstatohet mungesa e raporteve periodike për identifikimin e çështjeve që kërkojnë ndërmarjen e masave konkrete për adresimin e tyre.;

-Nuk janë përgatitur hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK;

-Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit me qëllim identifikimin e proceseve kyçe të njësive dhe dobësive;

-Nuk janë parashikuar nga Administratori i shoqërisë rregulla për delegimin e detyrës;

-Nuk disponohet një zëb faqe zyrtare e shoqërisë për publikimin e informacioneve të aksesueshme për publikun;

-Nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, për detajimin e proceseve në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre;

-Evidentohet mungesa e një arkive për ruajtjen e dokumentacioneve të shoqërisë;

-Nuk janë implementuar strategji apo sisteme backup për ruajtjen e informacionit dhe dokumentacioneve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 109-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Administratori i UKK, në bashkëpunim me strukturat e tjera drejtuese të shoqërisë, të marrë masat për trajtimin e menjëhershëm të problematikave trajtuar më sipër për të përmbushur detyrimet në kuadër të forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke hartuar aktet e brendshme administrative të nevojshme dhe implementimin e tyre në përputhje me politikave për monitorimin e objektivave dhe përmirësimin e situatës, sipas çështjeve të ngritura më sipër.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në zbatim të Vendimeve të Gjykatës së Apelit për periudhën objekt auditimi për punonjës të cilët janë larguar pa shkaqe të përligjura, duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore dhe kanë paditur UKK në Gjykatë. Nga paditë e punonjësve kanë përfunduar me vendim të formës së prerë duke e detyruar UKK të paguajë shumën 5,292,924 lekë, për të cilat nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar edhe detyrimet përmbartimore. Për veprime të tilla UKK ka dëmshpërblyer për periudhën objekt auditimi, konkretisht:

9 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2018 në shumën 2,990,097 lekë;

7 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2019 në shumën 2,027,527 lekë,

4 punonjës dhe zyrat përmbartimore për vitin 2020 në shumën 225,300 lekë;

4 punonjës dhe zyrat përmbartimore deri në 01.04.2021 në shumën 50,000 lekë

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 50-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nga Administratori i UKK të merren masa që në vazhdimësi, për marrëdhëniet me punonjësit e shoqërisë të zbatohen kushtet e vendosura në kontratat individuale

dhe kolektive, largimet të jenë për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara, duke zbatuar afatet kohore përkatëse të njoftimit, gjithashtu të merren në konsideratë shmangia e shpenzimeve për detyrimet përmbartimore.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi:Mungon Rregullorja e Ujit nënshkruar nga Asambleja e Aksionareve e Ujësjetës Kanalizimeve Kurbin" SH.A dhe nga Administratori i UKK. Në këtë mënyrë nuk sigurohet një marrëdhënie ligjore e drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UKK që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, në zonën e shërbimit, nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetës-kanalizimeve SHA".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 69-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi:Nga Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Administrimit, Administratori i Shoqërisë, për secilën periudhë përkatëse në funksion të ushtrimit të detyrës, të hartohet/miratohet Rregullorja e Ujit.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi:Në UKK raportimi i ujit të prodhuar është i pasaktë, pasi pusët e prodhimit të ujit dhe kaptazhe operojnë pa matës, ndërkohë që çdo vendburim e pus uji duhet të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit. Në UKK, nuk ka asnjë mundësi teknike (për gjendjen në të cilin gjendet linja e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit), të jepet shifra e saktë e prodhimit të ujit në burime, hyrje/daljet në depot apo uji që shkon tek konsumatorët. Saktësia e prodhimit të ujit të deklaruar nuk mund të merret e mirëqenë. Si e tillë, UKK ka anashkaluar matjen dhe udhëzimet e ERRU për metodologjinë e matjes, duke mos dhënë informacion të verifikueshëm si për shoqërinë dhe për organet e kontrollit, që prodhimi i ujit dhe detyrimet rrjedhëse për buxhetin e shtetit nga ky prodhim janë të sakta si deklarohen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 69-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masa që për çdo vendburim e pus uji të pajiset me matës ujit, që leximi të jetë i verifikueshëm, për shoqërinë dhe organet e kontrollit.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi:Nga UKK nuk janë kryer kontrole sistematike për konstatimet dhe prerjen e lidhjet të paligjshme, gjithashtu nuk është marrë asnjë masë për konstatimin e përdorimit nga ana e subjekteve private të puseve të prodhimit të ujit me/pa leje. Kjo ka sjellë mos funksionim të grupeve të inspektimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kurbin pa planifikime dhe shtrirje kohore në vijueshmëri, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, Kodi i ujit, pjesa e dytë "Sistemi i furnizimit me ujë".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 69-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Nga Administratori i UKK dhe strukturat përgjegjëse, të kryhen në mënyrë të vazhdueshme inspektime për identifikimin e lidhjeve të paligjshme dhe të zbatohet kuadri ligjor për subjekte/konsumatorët që shfrytëzojnë puse për uji.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në UKK efienca e stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje. Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UKK ka arritur në 120 punonjës dhe 7127 lidhje, kjo sipas raportime të ERRU. Treguesi i performancës së Efiençës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 16.8 staf/1000 lidhje UK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 69-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Nga UKK të vlerësohet mundësia e zvogëlimi të numrit të punonjësve në strukturën e UKK, duke menaxhuar më mirë burimet njerëzore, shfrytëzuar rritjen e efiençës në punë dhe rritjen e performancës së shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

24. Gjetje nga auditimi: Numri i konsumatorëve që janë të pajisur me matës në Bashkinë Kurbin në raport me numrin total të konsumatorëve të ujit të pijshëm është relativisht i ulët (afërsisht 40%). Në vitin 2018 sasitë e ujit të faturuara me matës në Bashkinë Kurbin janë 182,163 m³ në raport me numrin total të faturimeve që ishte 1,199,934 m³. Si e tillë faturimi afrofe llogaritet në sasinë 1,017,771 m³ ujë. ERRU ka vënë objektiv për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecurisë ndër vite, mbetet ende shumë punë për arritjen e këtij treguesi. Është detyrë e UKK të instalojë matës edhe në konsumatorët e tjerë në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve që faturohen dhe ti afrohet mesatares së nivelit të matjes.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 69-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: UKK të instalojë matësit e ujit të pijshëm për konsumatorët në mënyrë që të rritet numri i konsumatorëve të pajisur me matës ti afrohet mesatares së nivelit të matjes. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë e treguesit óUji pa të Ardhura. Të planifikohen/realizohen investime për vendosjen e matësve në UKK në mënyrë që të rritet niveli i matjes.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese rezultoi se mungonin regjistrat e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme (AP), në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135, pika 4 si dhe Statuti i shoqërisë i miratuar me Vendimin nr. 2, datë 13.05.2019, neni 10 pika 1, në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 161, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme e përfaqësuar nga Aksionari i vetëm Bashkia Kurbin, nëpërmjet Sekretarit të Këshillit të marrë masa për të mbajtur regjistrin e posaçëm të vendimeve të AP me qëllim shmangien e deklarimit të tyre si akte të pavlefshme. Gjithashtu, Këshilli i Administrimit (KA) dhe Administratori të marrin masat për plotësimin e regjistrit të pjesëmarrjes nga Sekretari i KA gjatë mbledhjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

26. Gjetje nga auditimi: Asambleja e Aksionarëve (AA) të UKK, rezulton të jetë mbledhur vetëm 4 herë për vitin 2019, dhe nuk është mbledhur as edhe një herë në vitin 2018 dhe 2020. AA nuk ka plotësuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë dhe konkretisht nenit 6 óAsambleja e përgjithshëm, pika 3, sipas të cilës óAsambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, detyrim i cili sipas pikës nr. 2 thirret nga Kryetari i AP (Kryetarja e Bashkisë); Këshilli i Administrimit; Administratori i Shoqërisë, por mund të thirret edhe nga Eksperti Kontabël i Autorizuar; nga një mandat mbajtës i caktuar nga gjykata për raste emergjente, në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 óPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar dhe Statuti i Shoqërisë, neni 6 óAsambleja e përgjithshëm, pika 3, sipas të cilës óAsambleja e përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: UKK të marrë masa për realizimin e mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve të paktën 1 (një) herë në vit, sipas përcaktimeve statutores.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti UKK SHA rezultoi se nga Drejtoria Tregtare, Zyra e Financës dhe Dega Teknike nuk ka evidentuar kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të çdo të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për zërin e karburantit. Nga dokumentacioni i daljeve të karburantit nga magazina e Shoqërisë rezultoi se:

Për vitin 2018 janë përdorur 15,206 litra naftë me vlerë 2,587,257 lekë;

Për vitin 2019 janë përdorur 16,063 litra naftë me vlerë 2,663,264 lekë;

Për vitin 2020 janë përdorur 16,270 litra naftë me vlerë 2,116,947 lekë;

për të cilat për grupin e auditimit nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion argumentues dhe justifikues si Urdhri i Administratorit për miratimin e programeve të punës, Programet individuale të punës në të cilat të përshkruhet itinerari i lëvizjeve të automjetit, motivacioni i lëvizjes. Mungonin të dhënat e kilometrazhit në fillim dhe në fund të aktivitetit, normativa e konsumit të automjeteve dhe konsumi specifik sipas itinerarit shoqëruar me nënshkrimet përkatëse të shoferit. Nga ana e administrimit të shoqërisë (Administratori, Drejtoria Tregtare) si dhe nga inxhinieri i Drejtorisë Teknike, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë. Këto veprime vlerësuar në konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues në sasinë e 47,539 litra naftë vlerësuar me **7,367,468 lekë janë veprime që kanë sjellë përdorim të fondeve pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 50-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Administratori i UKK dhe Drejtori Tregtar të merren masat që të rregullohet me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit, që në vijimësi të hartohen

kartelat përkatëse të secilit automjet, të caktohen personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e shpenzimeve për automjetet, të kryhen kontrollet përkatëse periodike për monitorimin e shpenzimeve për karburantin dhe riparimin e automjeteve dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës në vazhdimësi.

Brenda 6-muajve nga marrja e Raporti Përfundimtar

2. Gjetje nga auditimi: Për arsye të vështirësisë financiare të UK Kurbin, pagesat dhe deklaratimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe e tatimit për të ardhurat e punonjësve janë kryer vazhdimisht me vonesë. Si pasojë UK Kurbin ka gjeneruar gjoba për vitin 2015-2017 në vlerën 1.352.928 lekë, nga të cilat në vitin 2018 janë trashëguar pa likuiduar 393.660 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për këtë vit. Situata ka vazhduar dhe për periudhën vijuese objekt auditimi (2019-2020) nga ku rezulton se për vitin 2019 janë gjeneruar gjoba në vlerën 304.545 lekë, dhe për vitin 2020 janë gjeneruar gjoba në vlerën 912.029 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, dhe nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 óPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: UKK të marrë masa për kryerjen me prioritet të pagesave nga transaksione që gjenerojnë gjoba për shkak të vonesave, si dhe të planifikojë saktë në buxhete apo nevoja për subvencione vlerat sa i takon këtyre transaksioneve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka pasur 6 procese gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës me punonjësit. Nga këto procese gjyqësore janë gjeneruar detyrime në vlerën **1.601.527 lekë** nga të cilat 1.240.727 lekë janë për pagesat e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi i gjykatës dhe 360.800 lekë shpenzime gjyqësore dhe shpenzime për shërbim përmbarimor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 dhe nr. 9, datë 20.03.2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 40-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: UKK të marrë masa që largimet nga puna të jenë konform Kodit të punës dhe Kontratës dy palëshe të punës dhe të mos shkelet asnjë e drejtë e punonjësit për asnjë rast. Gjithashtu, të ketë një planifikim buxheti të saktë që vendimet gjyqësore të ekzekutohen pa lindur nevoja e shpenzimeve për shërbimin përmbarimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-30.04.2021, materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit, grupi auditoi 8 nga 8 procedura me vlerë të prokuruar mbi 800,000 lekë, dhe vlerë të fondit limit prej **429,369,999lekë**.

Nga 8 procedura të audituara, konstatohet se në 3 procedura me vlerë kontrate 424,973,516, ose 98% e vlerës së kontratave të audituara, janë në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 1 óObjekti dhe qëllimi pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 óParimet e përzgjedhjes germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, óPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, pasi OE

të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të}) në vlerën 420,941,416 lekë. Procedura e audituar dhe konstatuara me problematikë janë:

1-Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçit", me vlerë të prokuruar 365,697,488 lekë dhe vlerë kontrate 363,692,924 lekë, ose më pak se fondi limit prej 2,004,563 lekë dhe BOE fitues "S...", óE.ó & óG...M.ó SHPK.

2-Procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "*Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të Qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimit*", me vlerë të prokuruar 50,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 49,299,952 lekë, ose më pak se fondi limit prej 700,048 lekë dhe OE fitues "SE.ó SHPK.

3-Procedura e prokurimit "Kërkesë për Propozim" me objekt "*Mbikëqyrje Punimesh "Hapja e pus-shpimeve bashke me linjat transmetuese për furnizimin me ujë te qytetit te Laçit "*", me vlerë të prokuruar 1,151,000 lekë dhe vlerë kontrate 1,019,625 lekë, ose më pak se fondi limit prej 131,375 lekë dhe OE fitues "E...G" SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 78-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: UK Kurbin, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në vlerën **420,941,416 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 óKodi i Punësó, i ndryshuar dhe kontratës kolektive të punës, neni 8 si dhe kontratave individuale dhe rregullores së brendshme të institucionit, Administratori i Ujësjiellës Kanalizime SHA Kurbin, të marrë masat disiplinore "**Vërejtje**", sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për personat e mëposhtëm për:

1. Z. D.A. ,në cilësinë e Drejtorit Tregtar të UKK, pasi:

-Janë kryer shpenzime nëpërmjet arkës (llog.531) më tepër se limiti i vendosur prej 1,000 lekë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publikó, pika 64

-Nuk ka kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë, me pasojë konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues të sasisë prej 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë veprime që kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E^{të} për buxhetin e shoqërisë, dhe në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-

2. Z. G. M. ,në cilësinë e Përgjegjësit të Financës dhe anëtarit të NJP, pasi:

-Janë kryer shpenzime nëpërmjet arkës (llog.531) më tepër se limiti i vendosur prej 1,000 lekë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publikó, pika 64

-Nuk ka kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë, me pasojë konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues të sasisë prej 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë veprime që kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E^{-të} për buxhetin e shoqërisë, dhe në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-

-Në realizimin e procedurave të prokurimit óBlerje të Voglaó, për vitin 2019-2020 UKK për 26 raste nga 111 procedura realizuar për vitin 2019 dhe 11 raste nga 61 për vitin 2020, është bërë copëtimi i fondeve edhe pse objekti i prokurimit është i njëjtë, apo i të njëjtës natyrë, veprime në kundërshtim me nenin 8, 9 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó i ndryshuar.

-Në kriteret e vendosura nga NJHDT në DST për procedurat e prokurimit, ka rezultuar se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, *veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta".*

3. Znj. J. E. , në cilësinë eInxhinierit të Degës Teknike dhe anëtarit të NJP, pasi:

-Nuk ka kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë, me pasojë konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues të sasisë prej 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë veprime që kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E^{-të} për buxhetin e shoqërisë, dhe në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-10.

-Në realizimin e procedurave të prokurimit óBlerje të Voglaó, për vitin 2019-2020 UKK për 26 raste nga 111 procedura realizuar për vitin 2019 dhe 11 raste nga 61 për vitin 2020, është bërë copëtimi i fondeve edhe pse objekti i prokurimit është i njëjtë, apo i të njëjtës natyrë, veprime në kundërshtim me nenin 8, 9 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó i ndryshuar.

-Në kriteret e vendosura nga NJHDT në DST për procedurat e prokurimit, ka rezultuar se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si

pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, *veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta".*

4. Z. J. K. , në cilësinë e Përgjegjësit të karburantit, pasi:

-Nuk ka kryer kontrolle për llogaritjen e konsumit real të karburantit, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të shoqërisë, me pasojë konsumin pa dokumentacion justifikues dhe argumentues të sasisë prej 47,539 litra naftë vlerësuar me 7,367,468 lekë veprime që kanë sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E^{-të} për buxhetin e shoqërisë, dhe në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó, i ndryshuar, neni 8, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 5-10.

5. Znj. B. N. , në cilësinë e Juristes të UKK dhe anëtarit të NJP, pasi:

-Në realizimin e procedurave të prokurimit óBlerje të Voglaó, për vitin 2019-2020 UKK për 26 raste nga 111 procedura realizuar për vitin 2019 dhe 11 raste nga 61 për vitin 2020, është bërë copëtimi i fondeve edhe pse objekti i prokurimit është i njëjtë, apo i të njëjtës natyrë, veprime në kundërshtim me nenin 8, 9 dhe 57 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó i ndryshuar.

-Në kriteret e vendosura nga NJHDT në DST për procedurat e prokurimit, ka rezultuar se vendosja e tyre nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

Kriteret e vendosura nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, *veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, gërma (c, ç, d), neni 2 gërma (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta".*

6. Z. D. A. , në cilësinë e Kryetarit të KVO

7. Znj. A. Rr. , në cilësinë e anëtarit të KVO

8. Z. T. P. , në cilësinë e anëtarit të KVO, pasi

-Për procedurën e prokurimit me objekt óNdërtimi i Rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit të Laçitó;

-Për procedurën e prokurimit me objekt óHapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të pompimitó; dhe

-Për procedurën e prokurimit me objekt óMbikëqyrje punimesh óHapja e pus-shpimeve bashkë me linjat transmetuese për furnizimin me ujë të qytetit të Laçit si dhe ndërtimi i stacionit të

pompimitô, me vlerë të prokuruar 424,973,516, pasi OE të shpallur fitues nga KVO, nuk plotësojë të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime të cilat kanë çuar në *prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E^{te})* në vlerën 420,941,416 lekë, në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, óPër prokurimin publikô, i ndryshuar, neni 1 ó*Objekti dhe qëllimi* pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ó*Parimet e për zgjedhjes* germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô, i ndryshuar.

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Aksionare
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë

UKK	Ujësjetllës Kanalizime Kurbin
OE	Operator Ekonomik
KA	Këshilli Administrativ
KKRR	Këshilli Kombëtar Rregullator
AP	Asambleja e Përgjithshëm

GRUPI I AUDITIMIT

R. XH. (Përgjegjës Grupi)

A. Z.

M. B.

J. T.

R. K.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

R. XH.